



MARRËVESHJE KONCESIONI

LIDHUR ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË,
SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË NJË
HIDROCENTRALI TË RI NË ASHTË, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE ÖSTERREICHISCHE
ELEKTRIZITÄTSÉIRTSCHAFTS -AKTIENGESELLSCHAFT

30 shtator 2008

KJO MARRËVESHJE KONÇESIONI në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një hidrocentrali të ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë ("Marrëveshja"), lidhet më 30 Shtator 2008, ndërmjet:

(1) MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS së Republikës së Shqipërisë, që vepron në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 27, datë 19 Janar 2007, "Mbi Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien e Koncesioneve" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 7, datë 4 Janar 2008, "Mbi Përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për Dhënien me Koncession Projekti të Hidrocentralit "Ashta" ("METE" ose "Autoriteti Kontraktues"); dhe

(2) ÖSTERREICHISCHE ELEKTRIZITÄTSÉIRTSCHAFTS - AKTIENGESELLSCHAFT, një shoqëri aksionere e krijuar sipas ligjeve të Austrisë e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Gjykatës Tregtare të Vjenës me nr. FN 76023z, me seli në Vjenë dhe me adresë në Am

Hof 6A, 1011 Vienna, Austria (“Koncessionari”).

Secili prej tyre, si Autoriteti Kontraktues dhe Koncessionari, do të referohen individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”.

DEKLARATA HYRËSE

DUKE QENË SE:

(A) Në përputhje me Ligjin nr. 9663, datë 18 Dhjetor 2006, “Për Koncessionet”, Vendimin nr. 27, datë 19 Janar 2007, të Këshillit të Ministrave dhe Kërkësen për Propozim dhe Udhëzimet për Ofertuesit (me ndryshimet përkatëse) datë 10 Maj 2008, METE ka ftuar ofertuesit të paraqesin ofertat e tyre për projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një hidrocentrali të ri me derivacion me një kapacitet nga 40-70 MW në Ashtë;

(B) Österreichische Elektrizitätséirtschafts – Aktiengesellschaft paraqiti një ofertë detyruese për Projektin më 13 Qershori 2008, me numër protokolli 2295/19 (“**Oferta e Koncessionarit**”);

(C) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e vlerësoi Österreichische Elektrizitätséirtschafts – Aktiengesellschaft si ofertuesin fitues për Projektin, për të cilën Koncessionari u njoftua më 16 Korrik 2008.

(D) Kjo Marrëveshje Koncessioni do të hyjë plotësisht në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (“**Data e Hyrjes në Fuqi**”).

Duke aprovuar këtë Marrëveshje, Këshilli i Ministrave, në emër të Republikës së Shqipërisë, pranon të përbushë detyrimet financiare që i ngarkohen Autoritetit Kontraktues me këtë Marrëveshje, në rast se Autoriteti Kontraktues nuk i përbush këto detyrime. Për heqjen e çdo dyshimi, ky paragraf nuk do të interpretohet në mënyrë të tillë që Republika e Shqipërisë të bëhet pale në këtë Marrëveshje, përvèç se për qëllimet e përbushjes së detyrimeve sipas fjalisë së mësipërme.

PRANDAJ, duke pasur parasysh zotimet detyruese të parashikuara këtu dhe të cilat konsiderohen të mjaftueshme në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTEPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Kurdoherë që fjalët me gjermanë e para të mëdha do të përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe Shtojcat e saj), këto fjalë, përvèç kur konteksti e kërkon ndryshe ose kur nuk janë përcaktuar në këtë Marrëveshje, do të kenë kuptimet e mëposhtme ose kuptimet që u jepen atyre në Marrëveshjen e Shitjes së Energjisë.:

“**Data Faktike e Përfundimit të Punimeve**” do të thotë data e lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final sipas Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

“**Filial**” do të thotë një entitet juridik i Kontrolluar, drejtëpërdrejt ose të tërthorazi, nga një entitet tjeter juridik, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësave.

“**Marrëveshje**” do të thotë kjo Marrëveshje Koncessioni (dhe të gjitha Shtojcat e saj, të cilat do të konsiderohen se janë pjesë përbërëse e saj).

“**Autorizimet**” do të thotë çdo miratim, leje, licencë (duke përfshirë Licencat), autorizim, aprovim ose çertifikatë, nxjerra ose ripërtëritja e secilës është në përgjegjësinë e çdo Entiteti Shtetëror dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

“**Pjesëmarrja Mesatare e Aksionerëve**”, në lidhje me çdo periudhë financiare, do të thotë shuma e Pjesëmarrjes së Aksionerëve në fillim të një periudhe financiare dhe Pjesëmarrja e Aksionerëve në përfundim të kësaj periudhe, shumë kjo që atëherë do të pjesëtohet me dy. Pjesëmarrja e Aksionerëve do të llogaritet në përputhje me IFRS.

“**Çmimi i Ofertës**” ka kuptimin siç përcaktohet në pikën 3.5 të Udhëzimeve për Ofertuesit.

“**Data e Paraqitjes së Ofertës**” do të thotë data në të cilën ofertuesit kanë paraqitur ofertat e tyre për Projektin në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesit datë 10 Maj 2008.

“**Ditë Punkte**” do të thotë çdo ditë e javës përvèç të ditës Shtunë, të Dielë dhe pushimeve të tjera zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

“**Pretendime**”, në lidhje me çdo Palë, do të thotë secila dhe të gjitha paditë, sankzionet, procedimet ligjore, pretendimet, vlerësimet, gjykimet, dëmet, gjobat, detyrimet, kërkësat, kostot, shpenzimet operative të arsyeshme (cash) çfarëdo qoftë (duke përfshirë tarifa të arsyeshme ligjore)

dhe humbjet e pësuara ose të mbështetura kundër ose nga kjo Palë, por duke përjashtuar çdo fitim të humbur ose dëm tjetër specifik, aksidental, të tërthortë, ndëshkues ose që vjen si pasojë e një veprimi.

“Kompleks” do të thotë Hidrocentrali dhe të gjitha Objektet Ekzistuese.

“Projekt-Ideja” do të thotë projekti i përgatitur nga Koncessionari dhe i paraqitur si pjesë e seksionit teknik të Ofertës së Koncessionarit, e cila përfshin vizatimet zbatuese, raportet, dokumentet, programet, përllogaritjet.

“Tarifa e Koncessionit” ka kuptimin e parashikuar këtu në Nenin 4.1.

“Të drejtat Koncessionare” do të thotë të drejtat e Koncessionarit që nga Data e Hyrjes në Fuqi, siç parashikohet më tej në Nenin 2.1 (*Të drejtat Koncessionare*).

“Koncessionari” do të thotë Österreichische Elektrizitäts-irtschafts-Aktiengesellschaft.

“Oferta e Koncessionarit” ka kuptimin e parashikuar në Nenin (B) të Deklaratës Hyrëse të kësaj Marrëveshjeje.

“Rasti i Mospërbushjes nga Koncessionari” do të thotë rastet e mospërbushjes të specifikuara këtu në Nenin 11.1.

“Marrëveshje Ndërtimi” do të thotë marrëveshja e ndërtimit që do të lidhet ndërmjet një ose më shumë kontraktorëve dhe Shoqërisë së Projektit.

“Tavani i Dëmeve të Likujdueshme në Ndërtim” do të thotë tavani i dëmeve likujduese në ndërtim siç referohet këtu në Nenin 7.2.12(a)(iv).

“Faza e Ndërtimit” do të thotë periudha e kohës që zgjat nga data e fillimit të Fazës së Ndërtimit deri në Datën Faktike të Përfundimit të Punimeve, gjatë së cilës Koncessionari do të ndërtojë dhe përfundojë Punimet e Ndërtimit në përputhje me afatet e kësaj Marrëveshjeje.

“Garancia e Ndërtimit” do të thotë Garancia e Ndërtimit që siguron përbushjen e duhur dhe në kohë të detyrimeve të Koncessionarit gjatë Fazës së Ndërtimit.

“Punimet e Ndërtimit”, në lidhje me Kompleksin dhe Sheshin, do të thotë Punimet që nevojiten dhe që janë ndihmëse për ndërtimin dhe përfundimin e Hidrocentralit, duke përfshirë të gjitha punimet e domosdoshme civile dhe instalimet elektro-mekanike, duke përfshirë, por pa u kufizuar me turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse për ndërtesën e centralit, transformatorë, pajisjet e nënstacionit, dhe linja e transmetimi deri në Pikën e miratuar të Lëvrimit të energjisë elektrike në sistemin elektro-energitik shqiptar.

“Garancia e Kontratës”, në lidhje me Garancinë e Ndërtimit, Garancinë e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes dhe me Garancinë e Dorëzimit, do të thotë një garanci bankare e radhës së parë e lëshuar nga një bankë drejtuese ndërkombëtare dhe me reputacion që vepron në Shqipëri (nëpërmjet një filiali ose dege), të rregulluar nga Ligji shqiptar dhe që siguron përbushjen e detyrimeve nga Koncessionari, siç detajohet më tej në këtë Marrëveshje, duke përfshirë Nenin 7.2.15 (*Garancia e Kontratës*).

“Autoriteti Kontraktues” do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë.

“Rasti i Mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktues” do të thotë rastet e mospërbushjes të specifikuara këtu në Nenin 11.1.2.

“Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues” do të thotë çdo përfaqësues që mund të caltohet herë pas here nga Autoriteti Kontraktues për ta përfaqësuar në lidhje me kryerjen e ndonjë tjetër të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë përsa i përket ndërtimit, Teste e të Funksionit) dhe të pranimit të Punimeve Ndërtuese), me kusht që, më tej, Autoriteti Kontraktues të njoftojë më së shumicë Koncessionarin për çdo mbarim mandati, zëvendësim ose ndërrim përfaqësuesi.

“Kontrolli” i përdorur si emër ose si folje do të thotë pushteti për të zgjedhur shumicën e bordit të drejtoreve (ose të ndonjë organi tjetër të ngjashëm të krijuar) ose ndryshe për të drejtuar menaxhimin e politikat e Shoqërisë së Projektit, drejtperdrejtë ose tërthorazi, qoftë nëpër tjetrit prorësë. Me të drejtë vote, qoftë me anë marrëveshjesh ose në formë të tjera.

“Korrupsione” do të thotë akti i premitimit, i dhënies, i marrjes ose i marrjeve, i përmarrjeve para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korruptimi ose që perceptohen si korruptim, për të ndihuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore, siç është gjithashu, aqësi që përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.

“Dhoma e të Dhënavë” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 7.2.3 të kësaj Marrëveshjeje.

“Defektet në Objektet Ekzistuese” do të thotë çdo defekt i fshehtë (*latent*) që ka lidhje me projektimin dhe/ose ndërtimin, si dhe/ose çdo defekt *patent* në lidhje me Objektet Ekzistuese siç specifikohet në inspektimin e përbashkët të kryer në përputhje me Nenin 2.1.1.

“Pika e Lëvrimit” gjendet në pikën e miratuar nga Koncessionari dhe OST në anën e tensionit të lartë të transformatorit rritës ose të nënstacionit në pronësi të Koncessionarit dhe të pajisjeve të rrjetit të transmetimit në pronësi (ose që do të jenë në pronësi) të OST në përputhje me Ligjin “Mbi Sektorin e Energjisë”, dhe nëpërmjet të cilës Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike kalon nga kontrolli dhe risku i Koncessionarit tek rrjeti i transmetimit.

“Projekt i Detajuar” do të thotë propozimi i projektit të detajuar përsa i përket Hidrocentralit dhe Objekteve Ekzistuese (për aq sa është e aplikueshme), i cili do të paraqitet nga Koncessionari në aplikimin e tij për Leje ndërtimi.

“Data e Hyrjes në Fuqi” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin (D) të Deklaratës Hyrëse të kësaj Marrëveshjeje.

“Pajisjet Elektromekanike” do të thotë pajisjet elektromekanike të secilit prej centraleve hidroelektrike të Hidrocentralit Ashta 1 dhe Hidrocentralit Ashta 2.

“Të Drejtat Mjedisore” do të thotë të gjitha të drejtat, përfitimet, titujt ose interesat të tashme ose të ardhshme të njohura me çdo instrument shtetëror ose autoritet legjislativ të shoqëruara pjesërisht ose në tërësinë e tyre me uljen ose shmangjen e emetimit të gazzrave me efekt serë ose të ndonjë ndotësi tjeter ose nëpërmjet burimeve të rinovaleshme ose të gjelbra të prodhimit të energjisë së Projektit dhe në lidhje me energjinë elektrike ose të avullit të prodhuar nëpërmjet saj. Për heqjen e çdo dyshimi, të Drejtat Mjedisore do të përfshijnë të gjitha të drejtat për të kërkuar certifikatën CER (ulja e certifikuar e emetimit) të shoqëruar me projektin e gazit, çdo VER (ulja e verifikuar e emetimit) dhe të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në Projektin CER që gjenerohen prej tyre ose që shoqërohen me to.

“Ligji Mjedisor” do të thotë Ligji që lidhet me mjedisin, duke përfshirë Ligjet që lidhen me përdorimin e tokës, urbanistikën, vlerësimin mjedisor, trashëgiminë mjedisore, ujin, ujëmbledhësat, lumenjtë, detin, shratin e detit, bregdetin, plazhet, ajrin, dheun, ujrat tokësore ose ujin, zhurmën, tokën, elementët kimikë, pesticidet, substancat e rrezikshme, shtresën e ozonit, mbetjet, mallrat e rrezikshme, rregulloret e ndërtimit, vendet e zëna nga ndërtuesat, shëndetin publik, shëndetin dhe sigurinë profesionale, rrezikun mjedisor, çdo aspekt të mbrojtjes së mjedisit, ose të zbatimit apo administrimit të çdo Ligji të tillë.

“Pjesëmarrja e Aksionerëve” në Shoqërinë e Projektit do të thotë kapitali (duke përfshirë, rezervat ligjore dhe vullnetare) i Shoqërisë së Projektit që i përket aksionerëve sipas investimit të tyre në Shoqërinë e Projektit, me kusht që “Pjesëmarrja e Aksionerëve” nuk do të përfshijë ndonjë shumë që zotërohet sipas Projektit të Huasë së Aksionerëve, me përjashtim të rastit të Objekteve të Huasë së Aksionerëve që llogariten në Investimin Minimal të Pjesëmarrjes së Aksionerëve sipas Nenit 5.2, që do të konsiderohet të jetë Pjesëmarrje e Aksionerëve.

“Objektet Ekzistuese” do të thotë diga e Spatharës, struktura e veprës së marrjes në Spatharë, toka dhe argjinatura mbrojtëse përgjatë lumit Drin (ndërmjet digës së Spatharës dhe veprës së marrjes), diga në rrjedhën e sipërme të veprës së marrjes si dhe argjinatura e Mjedës që rrëthon hyrjen në kanal, argjinatura në rrjedhën e poshtme të Spatharës, si dhe struktura e veprës së marrjes për Vaditje, e gjitha siç ilustrohet në Shtojcën E (*Harta e Sheshit me Objektet Ekzistuese të Evidentuara*). Për largimin e çdo dyshimi, Objektet Ekzistuese nuk përfshijnë Strukturën e Sipërme të Urës, e cila mbetet nën përgjegjësinë e Entiteteve Shtetërore që e kanë atë në pronësi.

“Njoftimi për Mospërmbushje” do të thotë një njoftim i Autoritetit Kontraktues që përshkruan një mospërmbushje nga Koncessionari për të kryer (i) Përfundimin Mekanik, (ii) Përfundimin Thelbësor ose (iii) Përfundimin Final, në përputhje me Shtojcën G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

“Përfundimi Final” do të thotë data në të cilën:

- (i) éshtë kryer Përfundimi thelbësor;
- (ii) Hidrocentrali ka arritur ose tejkaluar Kërkesat Teknike Minimale
- (iii) ka mbaruar periudha e testit të qëndrueshmërisë të parashikuar në Nenin 4.1 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*); dhe
- (iv) të gjitha Zërat e Listës së Anomalive janë riparuar, përfunduar ose Konçesionari i ka paguar Autoritetit Kontraktues koston e vlerësuar të Zërave të Listës së Anomalive të papërfunduar në përputhje me Nenin 4.2 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

“Mbyllje Financiare” do të thotë data kur nënskruhen Dokumentet Financuese që mbulojnë koston totale kapitale të Projektit, përvèç përqindjes për t'u financuar nga Pjesëmarrja e Aksionerëve, dhe ato hyjnë plotësisht në fuqi dhe bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar (ose data e hyrjes së tyre në fuqi kushtëzohet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje).

“Dokumente Financuese” do të thotë çdo marrëveshje huaje, bono, obligacione, kontrata, instrumente, marrëveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, marrëveshje varësie (duke përfshirë, në varësi të kërkesave të parashikuara në Nenin 5.2 këtu, Projektet e Huasë së Aksionerëve), hipoteka, akte përfaqësimi e administrimi, marrëveshje kredie, marrëveshje për blerje bonosh ose obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe dokumente të tjera që lidhen nga Shoqëria e Projektit dhe/o se Konçesionari dhe/o se një Filial i tij në lidhje me financimin e një projektimi, prokurimi, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtjeje të Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave Konçisionare, duke përfshirë modifikimet, plotësimet, shtesat, zgjatjet, ripërtëritjet dhe zëvendësimet e çdo financimi të tillë.

“Palë financuese” do të thotë çdo person ose persona që japid borxhe financuese ose rifinancuese sipas Dokumenteve Financuese të Shoqërisë së Projektit në lidhje me projektimin, prokurimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Kompleksit dhe për ushtrimin e të Drejtave Konçisionare, si dhe zëvendësuesit dhe të ngarkuarit e lejuar të këtyre personave, duke përfshirë çdo agjent ose përfaqësues për një person ose persona të tillë dhe duke përfshirë një Aksioner ose një filial të një Aksioneri.

“Rasti i Forcës Madhore” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 10.1 (*Forca Madhore*).

“Praktika e Industrisë së Mirë” do të thotë praktikat, metodat, standaret, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në industrinë e prodhimit të energjisë hidroelektrike përsa i përket projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së energjisë hidroelektrike, e cila pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë, inxhinier ose operator, sipas rastit, në rrethana të njëjtë ose të ngjashme; praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standaret Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin më të larta, nga një periudhë kohore në tjetrën).

“Entitet Shtetëror” do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departamenti ose nënndarje politike a ushtarake e saj; dhe (ii) çdo gjykatë ose instance gjyqësore ose çdo entitet tjeter qeveritar, instrument, agjenci ose autoritet nën kontrollin e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament ose nënndarje politike e saj, si dhe çdo komunë ose bashki, dhe që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Konçesorarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator (duke përfshirë Rregulatorin), në çdo rast brenda Republikës së Shqipërisë.

“Garancia e Dorëzimit” do të thotë Garancia e Kontratës që siguron përbushjen e duhur që përkohë të detyrimeve të Konçesonarit për dorëzimin, siç parashikohet këtu.

“Kapacitet i Instaluar” do të thotë fuqia neto elektrike në dalje, e matur në MW, në mënyrë të ulët të transformatorëve rritës siç përcaktohet në Shtojcën G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

“KESH” do të thotë Korporata Elektroenergjite Shqiptare, korporata shqiptare e privatizimit të energjisë, si dhe zëvendësuesit dhe të ngarkuarit e saj.

“Ligj” do të thotë çdo ligj i zbatueshëm kombëtar ose lokal, urdhëresë, dekret ose ligj tjetër (duke përfshirë Ligjin Mjedisor), rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim, miratim, leje, autorizim ose aprovim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose i çdo entiteti ose nëndarjeje të saj, ose të ndonjë Entiteti Shtetëror ose të një personi ligjor (i pavarrur ose jo), që ka juridikSIONIN e duhur, në masën e publikuar dhe që disponohet publikisht, dhe që është subjekt zbatimi i vendimeve të gjykatave të ndryshme dhe të trupave gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, të vendimeve dhe urdhreve ekzekutive, të udhëzimeve a qarkoreve të departamenteve, si dhe prononcimet dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që kanë juridikSION mbi çështjen në fjalë; siç mund të ndryshohen kohë pas kohe gjatë Afatit të Marrëveshjes së Koncessionit.

“Liçencat” do të thotë të gjitha lejet, autorizimet, licencat dhe miratimet e mara nga ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike) për ndërtimin, instalimin dhe/ose mirëmbajtjen e kërkuar për zbatimin, kalimin dhe përbushjen e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë.

“Dëme të Likuidushme” do të thotë dëmet e likuidueshme të pagueshme nga Koncessionari në përputhje me Nenet 7.2.12 dhe 8.2 këtu.

“Punime Mirëmbajtjeje” në lidhje me Objektet Ekzistuese, do të thotë detyrimi i Koncessionarit, sipas Nenit 2.1.1, për të kryer punime të tillë që janë të nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur dhe ruajtjen e Objekteve Ekzistuese, duke përashtuar gjithsesi, (i) çdo punim rinoxues ose rindërtues (përveç kur shkaktohet nga moskryerja e Punimeve Mirëmbajtëse nga ana e Koncessionarit të parashikuar në Nenin 2.1.1), ose (ii) për largimin e çdo dyshimi, çdo punim mirëmbajtjeje që ka të bëjë me Strukturën e Sipërme të Urës.

“Pasojë Thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen” do të thotë çdo pasojë thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen për (i) aftësinë e Shoqërisë së Projektit për t’iu përbajtur e ushtruar cilëndo prej të drejtave dhe detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes në kushte normale, dhe/ose mbi (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën shtrënguese ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes.

“Veprim Shtetëror Thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen” ka kuptimin që parashikohet në Nenin 10.2 (*Veprim Shtetëror Thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen*)

“Përfundimi Mekanik” në lidhje me çdo Pajisje Elektromekanike, do të thotë, përveç disa zërave të vegjël të Punimeve që nuk do të ndikonin në sigurinë, funksionimin dhe përdorimin e Mjeteve të tillë Elektromekanike, siç janë bojatisja, mjedisi përreth e kështu me radhë, data në të cilën do të plotësohen kushtet që vijojnë:

(i) të gjitha materialet dhe pajisjet për këto Mjete Elektromekanike të janë instaluar, të janë vënë në shfrytëzim dhe testuar në mënyrë të suksesshme në përputhje me planet që parashikohen në Nenin 2 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*) Testet Fillestare dhe Përfundimi Mekanik, si dhe

(ii) këto Mjete Elektromekanike të janë gati për të filluar Testin e Funksionimit.

“Kërkësat Minimale Teknikë” do të thotë kërkësat minimale teknike siç specifikohen në Shtojcën B (*Kërkësat Minimale Teknikë*);

“Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike” do të thotë e gjithë energjia elektrike neto e shprehur në kWh e lëvruar nga Koncessionari në Pikën e Lëvrimit në çdo kohë deri sa të përfundojë Afati sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë (duke përfshirë Prodhimin e Përkohshëm Neto të Energjisë Elektrike).

“Njoftimi i Gatishmërisë” ka kuptimin që parashikohet në Nenin 3.1 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

“Njoftimi i Përfundimit Final” do të thotë njoftimi i Autoritetit Kontraktues nga Koncessionari, që tregon se Koncessionari ka arritur Përfundimin Final në përputhje me Nenin 4.1 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedura Testuese*).

“Njoftimi i Përfundimit Mekanik” do të thotë njoftimi i Autoriteti Kontraktues nga Koncessionari, që tregon se Koncessionari ka arritur Përfundimin Mekanik në përputhje me Nenin 2.3 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedura Testuese*).

“Njoftimi i Përfundimit Thelbësor” do të thotë njoftimi i Autoriteti Kontraktues nga Koncessionari, që tregon se Koncessionari ka arritur Përfundimin Thelbësor në përputhje me Nenin 3.7 të Shtojcës G (*Komisionimi dhe Procedura Testuese*).

“Marrëveshja SH & M” do të thotë marrëveshja e shfrytëzimit dhe e menaxhimit që do të lidhet ndërmjet një ose më shumë kontraktorëve dhe Shoqërisë së Projektit, nëse ka.

“Marrëveshja e Shitjes së Energjisë” do të thotë marrëveshja merr-ose-pagauj për shitjen e energjisë, e të njëjtës datë siç parashikohet këtu, e lidhur ndërmjet Koncessionarit dhe marrësit (KESH), një kopje e së cilës është bashkëlidhur si Shtojca A (*Marrëveshja e Shitjes së Energjisë*).

“Tavani i Dëmeve të Likuidueshme për Shfrytëzim e Mirëmbajtje” do të thotë tavani i dëmeve të likuidueshme të shfrytëzim mirëmbajtjes referuar këtu në Nenin 8.2 (*Dëmet e Likijdueshme - Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja*).

“Garancia për Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen” do të thotë Garancia e Kontratës që siguron përbushjen e duhur dhe në kohë të detyrimeve të Koncessionarit, që parashikohen këtu për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen.

“Faza e Shfrytëzimit” do të thotë periudha e kohës që zgjat nga Data Faktike e Përfundimit Final deri në mbarimin e Afatit.

“OST” do të thotë shoqëria OST Sh.A., e cila është operatori i autorizuar i sistemit të transmetimit për sistemin elektroenergetik kombëtar të Shqipërisë.

“Testet e Funksionimit” do të thotë testet e specifikuara në Shtojcën G (*Komisionimi dhe Procedura Testuese*).

“Hidrocentral” do të thotë Hidrocentrali Ashta 1 dhe Hidrocentrali Ashta 2.

“Hidrocentrali Ashta 1” do të thotë hidrocentrali i ri me derivacion Ashta 1, i cili është i aftë të arrijë një kapacitet deri në 19.7 MW, që së bashku me Hidrocentralin Ashta 2, është i aftë të arrijë Kapacitetin e Propozuar dhe që përfshin të gjitha punimet civile dhe instalimet elektromekanike të nevojshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse të ndërtesës së centralit, transformatorët, pajisjet e nënstacionit dhe linjën e transmetimit deri në Pikën e miratuar të Lëvrimit të energjisë elektrike tek sistemi elektroenergetik shqiptar.

“Hidrocentrali Ashta 2” do të thotë hidrocentrali i ri me derivacion Ashta 2, i cili është i aftë të arrijë një kapacitet deri në 28.5 MW, që së bashku me Hidrocentralin Ashta 1, është i aftë të arrijë Kapacitetin e Propozuar dhe që përfshin të gjitha punimet civile dhe instalimet elektromekanike të nevojshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse të ndërtesës së centralit, transformatorët, pajisjet e nënstacionit dhe linjën e transmetimit deri në Pikën e miratuar të Lëvrimit të energjisë elektrike tek sistemi elektroenergetik shqiptar.

“Detyrimet Pas Përfundimit” do të thotë detyrimet pas përfundimit referuar në Nenin 7.2.11 këtu më poshtë.

“Ndotja e Mëparshme Mjedisore” do të thotë ndotja e mjedisit në Shesh ose në Objektet Ekzistuese, që është e pranishme në Shesh ose në Objektet Ekzistuese në ose para datës, në të cilën rreziku në Shesh ose në Objektet Ekzistuese, sipas rastit, ka kaluar nga Autoriteti Kontraktues (ose nga ndonjë Entitet tjeter Shtetëror i lidhur me të) tek Koncessionari, pavarësisht nëse rreziku ishte identifikuar ose jo para kësaj date.

“Projekt” do të thotë (i) projektimi, financimi, ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i pronësisë së Hidrocentralit Ashta tek Autoriteti Kontraktues, dhe (ii) zgjedhja i Objekteve Ekzistuese, nëse bëhet, pronësia e pjesëve të Objekteve Ekzistuese të shtuar, ose zgjerohen, dhe mirëmbajtja e të gjitha Objekteve Ekzistuese në përputhje me Nenin 2.1.1.

“Shoqëria e Projektit” do të thotë një shoqëri e caktuar që do të ngrihet e formohet sipas ligjeve të Shqipërisë dhe e mbështetur me fonde nga Koncessionari në përputhje me këtë ligjshje.

“Rasti i Forcës Madhore të Tejzgjatur” do të thotë Rasti i Forcës Madhorë që (i) zbulohet se dyqind e dyzetë (240) ditë të njëpasnjëshme që nga data e ndodhjes së saj, ose (ii) që të bëhet e qartë që në ditën e ndodhjes së saj se do të zgjasë më shumë se dyqind e dyzetë (240) të njëpasnjëshme.

“Kapaciteti i Propozuar” do të thotë kapaciteti i Hidrocentralit për të prodhuar 48.2 MW siç është paraqitur në Ofertën e Koncessionarit.

“Blerësi” do të thotë KESH.

“Sistemi i Garantimit të Cilësisë” do të thotë sistemi i garantimit të cilësisë referuar në Nenin 7.2.5.

“Gëzim i qetë” do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gjëzuar Kompleksin, Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.

“Rifinancimi” do të thotë çdo rifinancim i Projektit pas Mbylljes Financiare (duke përfshirë ristrukturimin e borxhit dhe rishikimin e afateve të tij), të siguruar nga çdo Palë Financuese, duke përfshirë çdo rinovim ose zëvendësim për çdo financim ose rifinancim të tillë.

“Rregulator” do të thotë ERE (Enti Rregulator i Sektorit të Energjisë Elektrike) (Albanian Electricity Regulatory Authority) ose ndonjë rregulator tjetër i industriës elektrike ose departament tjetër rregulator, organ, agjenci ose autoritet i Republikës së Shqipërisë ose të ndonjë prej nënndarjeve të tyre të krijuar mbi bazën e Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Mbi Sektorin e Energjisë”, ose çdo akt tjetër ligjor që vesh organin e krijuar nëpërmjet këtij akti me autoritet për të miratuar tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, për të monitoruar aktivitetet e licencuara, dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve, si dhe ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve.

“Plan Përbushës” do të thotë raporti i njoftuar METE-s nga Koncessionari që pason një Rast Mospërbushjeje të Koncessionarit në përputhje me Nenin 11.2.1, i cili do të detajojë në mënyrë të arsyeshme (i) përsë një Rast i caktuar i Mospërbushjes nga Koncessionari nuk mund të përbushet brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh siç specifikohet në Nenin e cituar 11.2.1; (ii) çfarë mase planifikon Koncessionari të ndërmarrë për të ndreçur Rastin e Mospërbushjes; dhe sa kohë kërkohet përtëj periudhës së përmendur prej tridhjetë (30) ditësh për të zbatuar e përfunduar një plan të tillë përbushës.

“Shesh Zëvendësues” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 14.12.4 këtu.

“E Ardhur në Pjesëmarrjen e Aksionerëve” do të thotë e ardhura neto e Shoqërisë së Projektit pjesëtar me Pjesëmarrjen Mesatare të Aksionerëve, me kusht që (i) e ardhura neto të llogaritet në përputhje me IFRS, dhe (ii) duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në fund të vitit të tretë (3) të Fazës së Shfrytëzimit, e Ardhura në Pjesëmarrjen e Aksionerëve do të konsiderohet se është dymbëdhjetë përqind (12%).

“E Drejta për Kalim” do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, Kompleks dhe në çdo pjese të tyre, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në to, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

“Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut” do të thotë 40 muaj nga fillimi i Fazës së Ndërtimit.

“Aksioner” do të thotë çdo person që ka një Pjesëmarrje financiare a pasurore në Shoqërinë e Projektit.

“Aksionerët Huadhënës” do të thotë çdo Aksioner ose Filial i tij që hyn në një Projekt për Dhënie Huaje të Aksionerëve.

“Projekte për Dhënie Huaje të Aksionerëve” do të thotë çdo borxh financues i dhënë Shoqërisë së Projektit nga Aksionerët.

“Shesh” do të thotë sheshi që gjendet rrith pjesës më të ulët të lumit Drin siç specifikohet më tej në Shtojcën D (*Harta e Sheshit*).

“Lista e Anomalive” do të thotë lista e zërave të papërfunduar dhe e të metave të pazgjdhura, për të cilat do të vendoset dhe do të bihet dakord bashkarisht ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncessionarit përpëra se të bëhet Përfundimi Mekanik. Lista e Anomalive do të përfshijë të gjitha zërat për t'u bërë, përfunduar a zgjidhur përpëra Përfundimit Final. Lista e Anomalive mund të ndryshohet në çdo kohë përpëra Përfundimit Thelbësor në formë të shkruar dhe të nënshkruehet nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncessionari.

“Zërat e Listës së Anomalive” do të thotë zërat e Punimeve të renditura në Listën e Anomalive.

“Përfundimi Thelbësor” do të thotë data kur:

- (a) është kryer Përfundimi Mekanik;
- (b) janë përfunduar Testet e Funksionimit; dhe

(c) të jenë dërguar nga Koncessionari (në masën që është e mundur për Koncessionarin)

(i) specifikimet dhe vizatimet e përgjithshme rregulluese (në formë të printuar) të kërkua nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të arsyeshme, (ii) të dhënët për Testet e Funksionimit, dhe (iii) dokumentet garantuese të programit të administrimit.

“Taksë” do të thotë çdo taksë, detyrim, tatim, tarifë, pagesë, taksë doganore ose tarifë e çdo lloji, e ngarkuar, e vënë, e vendosur, e kërkuar, ose mbledhur, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga çdo Entitet Shtetëror sipas Ligjit, duke përfshirë çdo taksë malli dhe shërbimi, taksë shitjeje, tarifë pullash a vulash, tarifë importi, taksë mbi të ardhurat (qoftë mbi të ardhurat, dividentët, pagesat e interesit, tarifat, mbi qiratë e pajisjeve ose të tjera), taksë mbi huat në monedhë të huaj ose transaksione këmbimi me jashtë, taksë akcize, taksë mbi pronësinë, tarifë regjistrimi ose licence, duke përfshirë çdo interes, sanksion ose shtesa të tjera mbi to.

“Eksperti Teknik dhe Ekonomik” do të thotë eksperti i caktuar bashkërisht nga Palët për qëllime pajtimi në zbatim të Nenit 13.2 (*Eksperti Teknik dhe Ekonomik*).

“Afat” do të thotë një periudhë prej tridhjetë e pesë (35) vjetësh që nga Data e Hyrjes në Fuqi, përvèç kur Marrëveshja zgjidhet më parë ose zgjatet në përputhje me kushtet përkatëse.

“Njoftimi për Zgjidhje” në lidhje me Autoritetin Kontraktues ose Koncessionarin, sipas rastit, do të thotë një njoftim nga njëra Palë te Pala tjetër që deklaron se kjo Marrëveshje do të zgjidhet në vijim (i) të një Rasti Mospërbmbushje nga Koncessionari ose të një Rasti Mospërbmbushje nga Autoriteti Kontraktues, sipas rastit, i cili nuk është përbushur brenda kuadrit kohor përcaktuar të parashikuar në këtë Marrëveshje (në masën e aplikueshme), (ii) të një Rasti të Forcës Madhore së Tejzgjatur, ose (iii) të çdo rasti tjetër të parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje, i cili do të specifikojë shkakun e zgjidhjes dhe datën e zgjidhjes faktike të kësaj Marrëveshje, e cila do të jetë jo më parë se tridhjetë (30) ditë pas këtij njoftimi.

“Pagesa A e Zgjidhjes” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 11.3.

“Pagesa B e Zgjidhjes” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 11.3.

“Pagesa C e Zgjidhjes” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 11.3.

“Rasti i Forcës Madhore të Pasiguruar” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 10.1.3.

“Struktura e Sipérme e Urës” do të thotë (i) sipérfaqja (duke përfshirë strukturat e rrugës dhe të hekurudhës), (ii) bazamenti dhe (iii) strukturat mbajtëse të urës së digës të Spatharës, siç ilustrohen në Shtojcën E (*Harta e Sheshit me Objektet Ekzistuese të Evidencuara*).

“Punimet” do të thotë çdo përgatitje e tokës, ndërtim dhe punim sistemues dhe rikthim i vendit në gjendjen e mëparshme (në masën që është e mundur), që kryhen në Shesh.

1.2 Interpretimi

Përvèç kur nuk kërkohet ndryshe në këtë Marrëveshje:

(i) fjalët në secilën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;

(ii) fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës përfshijnë gjithashtu respektivisht numrin shumës ose njëjës;

(iii) termat “të kësaj”, “këtu”, “nëpërmjet kësaj ose nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të njashme i referohen Marrëveshjes në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Tabele, Bashkëlidhje ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Marrëveshje;

(iv) Deklarata Hyrëse dhe Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet të kësaj Marrëveshjeje do të bëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje dhe referencat në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet të jenë referenca në Shtojcat, Tabelat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Marrëveshjeje, përvèç kur Palët e shtojshin ndryshe.

(v) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referencat në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rinxjerrë a ribërë;

(vi) fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë” do të konsiderohet se pasohen nga [fjalët] “pa kufizim” ose “duke mos u kufizuar në”, edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

(vii) referencat në “këtë Marrëveshje” ose “kjo Marrëveshje Koncessioni” ose çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë marrëveshje ose dokument, siç ndryshohet, modifikohet ose shtohet, dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërrë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;

(viii) sa herë që kjo Marrëveshje i referohet një numri “ditësh” ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike përvèç kur specifikohen si Ditë Pune;

(ix) çdo referencë në një “muaj” ose “vit” do të interpretohet si referenca në një muaj kalendarik ose vit kalendarik;

(x) çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifisht në ndonjë Shtojcë, Bashkëlidhje a Dokument tjetër Bashkangjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Shtojcë ose Bashkëlidhje, sipas rastit;

(xi) në rast mospërputhjeje midis çdo fjale me germë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtimi të parashikuara në Nenin 1.1 dhe një dispozite, fjale me germë të madhe, termi, fraze ose shkurtimi parashikuar gjetkë në këtë Marrëveshje, Shtojcë, Bashkëlidhje ose në një Dokument tjetër Bashkangjitur tek çdo Bashkëlidhje, kuptimi i dhënë në Nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo Shtojcë, Bashkëlidhje a një Dokument tjetër Bashkangjitur çdo Bashkëlidhje, përvèç kur konteksti i kësaj Marrëveshjeje e kërkon ndryshe;

(xii) në rast papajtueshmërie ndërmjet têrësisë së kësaj Marrëveshjeje me Shtojcat dhe Bashkëlidhjet, Palët do të përpiken, që fillimi shtë zgjidhin papajtueshmërinë nëpërmjet leximit të kësaj Marrëveshjeje në têrësi, ndërsa do të zbatohet dispozita që e trajton në mënyrë më specifike këtë çështjeje. Nëse papajtueshmëria vazhdon të ekzistojë megjithë përpjekjet të Palëve për ta zgjidhur me mirëbesim atë siç parashikohet në fjalinë paraardhëse, për zgjidhjen e saj do të zbatohen dispozitat e têrë kësaj Marrëveshjeje së bashku me Shtojcën e saj “Kërkесат Minimale Teknike”; dhe

(xiii) titujt e Neneve, Kapitujve dhe të Neneve në këtë Marrëveshje dhe Tabela e Përbajtjes janë bërrë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. TË DREJTAT KONÇESIONARE - SHESHI

2.1 Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncessionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Afatin:

(i) të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin;

(ii) t'i zgjerojë e shtojet Objektet Ekzistuese, të ketë në pronësi pjesët e Objekteve Ekzistuese të zgjeruara a shtuara, kur është e mundur të bëjë veçimin e këtyre pjesëve në përputhje me Ligjin, dhe të shfrytëzojë dhe mirëmbajë Objektet Ekzistuese sipas Nenit 2.1.1 më poshtë;

(iii) në varësi të Nenit 2.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;

(iv) në varësi të Neneve 2.1.2 dhe 2.2 këtu më poshtë, të ketë akses dhe të përdorë ujin në pjesën më të ulët të lumit Drin (brenda Sheshit);

(v) të furnizojë KESH me Prodhim Neto të Përkohshëm të Energjisë Elektrike dhe me Prodhim Neto të Energjisë Elektrik dhe të mbledhë Pagesat e Blerësit në lidhje me to në përputhje me afatet dhe kushtet e Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë (afate siç parashikohen në atë Marrëveshje) dhe t'i shesë palëve të treta Prodhimin Neto të Energjisë Elektrike në treg të hapur në përputhje me Nenet 2.1.2, 8.1.2 dhe 8.4 të Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë;

(vi) t'i kthejë sërisht Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të Objekteve Ekzistuese të shtuara, kur është e mundur, me mbarimin e Afatit, si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë të pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, "të Drejtat Koncessionare"); dhe

(vii) Koncessionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat CER,

Kjo Marrëveshje Koncessioni përbën një Marrëveshje të tipit BOOT (Build-Own-Operate-Transfer) (Ndërtim-Pronësim-Shfrytëzim-Transferim)

2.1.1 Mirëmbajtja e Objekteve Ekzistuese dhe e Strukturës së Sipërme

Në lidhje me Objektet Ekzistuese, Koncessionari do të kryejë Punimet e Mirëmbajtjes.

Me qëllim që të vlerësohet ndonjë defekt në Objektet Ekzistuese, pas Datës së Hyrjes në Fuqi, do të organizohet menjëherë sa po të jetë e mundur një inspektim i përbashkët për Objektet Ekzistuese nga METE dhe Koncessionari, me pjesëmarrjen e një eksperti të pavarur të një pale të tretë të përgjegjdhur prej tyre së bashku. Shpenzimet e ekspertit të palës së tretë që lidhen me një inspektim të tillë do të përballohen nga Koncessionari.

Nëse në raportin e inspektimit të përpiluar nga eksperti i pavarur i palës së tretë evidentohet ndonjë Defekt në Objektet Ekzistuese,

(i) Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që çdo Defekt në Objektet Ekzistuese do të riparohet dhe rregullohet në një masë të kënaqshme të arsyeshme për Koncessionarin në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë me qëllim që të sigurojë që ushtrimi nga Koncessionari i të Drejtave Koncessionare përgjatë Afatit të Projektit të mos cënohen në kundërshtim me këtë Marrëveshje, dhe Autoriteti Kontraktues do ta zhëmtojë plotësisht Koncessionarin, si dhe nuk do ta bëjë këtë përgjegjë në lidhje me çdo mos-riparim ose mos-ndreqje të Defekteve të tilla në Objektet Ekzistuese; dhe

(ii) Koncessionari nuk do të ketë asnjë detyrim të ndërmarrë ndonjë Punicë Mirëmbajtjeje në lidhje me Objektet Ekzistuese të shkaktuar nga ndonjë Defekt në Objektet Ekzistuese derisa të gjitha këto Defekte në Objektet Ekzistuese të janë riparuar dhe rregulluar plotësisht, si dhe Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut dhe Afati do të zgjaten në masën që punimet riparuese ose rinovuese, ose mos-riparimi dhe mos-ndreqja e Defekteve do pengojnë ushtrimin e aktivitetit të Koncessionarit.

Në lidhje me Strukturën e Sipërme të Urës, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që Struktura e Sipërme e Urës të mirëmbahet gjatë gjithë kohës në masën që është e nevojshme përfunksionimin e duhur të Hidrocentralit në një masë të kënaqshme të arsyeshme për Koncessionarin, pa asnjë shpenzim nga Koncessionari, dhe në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe Autoriteti Kontraktues do të zhëmtojë plotësisht Koncessionarin, si dhe nuk do ta bëjë këtë përgjegjës për çdo mos-mirëmbajtjeje të Strukturës së Sipërme të Urës.

2.1.2 Uji Mbetës/Vaditja

Autoriteti Kontraktues do të zhëmtojë Koncessionarin dhe nuk do ta bëjë këtë përgjegjës për ndonjë Pretendim, humbje, dëm ose kosto që mund të vijë si pasojë e nxjerrjes ose ndryshimit të Ligjeve, që sjell si pasojë (i) rritjen e sasisë së ujit që duhet të lëshohet dhe që është i nevojshëm përdorim civil ose përvaditje mbi 20 metër kub në sekondë midis Qershoret dhe Gushtit dhe/ose (ii) rritjen e sasisë së nevojshme të ujit mbetës përvaditje mbi 10% të prurjes ditore të ujit në Hidrocentral, të sasisë që mbetet pas vaditjes dhe përdorimit civil dhe/oze (iii) uljen e nivelit të ujit në rezervuarin e Spatharës nën 21 metra, me kusht që çdo nxjerrje a ndryshim Ligji të ketë një Veprim Shtetëror thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen mbi Koncessionarin.

2.2 Dhënia e Sheshit

Pavaresisht nga sa parashikohet në Nenin 2.1 më sipër, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Çatë dhe e drejta për akses dhe përvaditor ujin në pjesën më të ulët të lumit Drin (brenda Sipërshtit), do : konsiderohen se i jepen Koncessionarit vetëm pasi Koncessionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të certifikatave siguruese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të lëndëve për Autoritetin Kontraktues), se Koncessionari është pajisur me pollicat e sigurimit dhe gjancë e kerkuara për këtë qëllim në përputhje me Nenin 9 (Siguracioni).

Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin si më sipër, Koncessionari e pranon Sheshin “siç është” që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim (as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim) përkundrejt (ose nga) Koncessionari në lidhje me gjendjen e Sheshit, me kusht që, sidoqoftë, Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës për koston e pastrimit të ndonjë Ndotjeje Mjedisore të Mëparshme për aq sa ky pastrim të kërkohet nga një ligj në fuqi ose të jetë i nevojshëm në lidhje me realizimin e Projektit, si dhe do të zhëdëmtojë Koncessionarin dhe nuk do ta bëjë këtë përgjegjës për ndonjë Pretendim, humbje, dëm ose kosto që mund të pësojë ose të ketë Koncessionari si rezultat i pranisë së kësaj Ndotjeje Mjedisore të Mëparshme.

2.3 Detyrimet dhe Garancitë e Autoritetit Kontraktues

a) Autoriteti Kontraktues siguron dhe garanton se as ai, as ndonjë Entitet tjeter Shtetëror nuk ka dhënë e as nuk do të japi ndonjë të drejtë (përveç të drejtave ekzistuese në masën që ato i janë dhënë ose ushtrohen faktikisht nga KESH përparrat datës së paraqitjes së Ofertës nga Koncessionari për Hidrocentralet vijues mbi lumin Drin: Hidrocentrali i Fierzës me një kapacitet të instaluar prej 500 MW, Hidrocentrali i Komanit me një kapacitet të instaluar prej 600 MW dhe Hidrocentrali i Vaut të Dejës me një kapacitet të instaluar prej 250 MW) të kontrollojë, të shfrytëzojë, devijojë ose të shkarkojë rezervat ujore në pjesën e sipërme të Sheshit ose të Objekteve Ekzistuese në qoftë se një veprim i tillë sjell si pasojë (i) zvogëlimin e prurjeve ditore që do të kishin ardhur në Hidrocentral nëse një veprim i tillë nuk do të ishte kryer nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet tjeter Shtetëror; (ii) rritjen maksimale të treguesve të prurjeve ditore, stinore ose vjetore në Shesh ose në Objektet Ekzistuese në një masë më të madhe se sa sasia e ujit që mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike në Hidrocentral; ose (iii) dëmton dhe cënon thelbësisht në kundërshtim me këtë Marrëveshje shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit në forma të tjera. Në rast se Autoriteti Kontraktues ndërmerr ndonjë veprim në kundërshtim me Nenin 2.3(a) që pasjell faktikisht pasojat e parashikuara sipas (i), (ii) ose (iii) më sipër, ose nuk ndërmerr ndonjë veprim që do të evitonë këto pasoja, Autoriteti Kontraktues do ta rivendosë Koncessionarin në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse ky veprim ose mosveprim të mos kishte ndodhur (duke përfshirë kompensimin për kostot dhe fitimet e munguara). Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin ta rivendosë Koncessionarin në gjendjen e mëparshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën Koncessionari njofton Autoritetin Kontraktues për këto pasoja, atëherë do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje dhe Koncessionari do t'i lind e drejta ta zgjidhë këtë Marrëveshje.

b) Në qoftë se Autoriteti Kontraktues kryen një veprim që, në varësi të shirave dhe kushteve normale metereologjike, rezulton në një sasi vjetore uji më të vogël të disponueshme në Shesh ose në Objektet Ekzistuese, që është nën prurjen ose volumin që është i domosdoshëm për të produhuar jo më pak se sa 165 GWh në vit, ose nuk e kryen një veprim që do ta parandalonte një pasojë të tillë, Autoriteti Kontraktues do ta rivendosë Koncessionarin në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse ky veprim ose mosveprim të mos kishte ndodhur (duke përfshirë kompensimin për kostot dhe fitimet e munguara). Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin ta rivendosë Koncessionarin në gjendjen e mëparshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën Koncessionari njofton Autoritetin Kontraktues për këto pasoja, atëherë do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje dhe Koncessionari do t'i lind e drejta ta zgjidhë këtë Marrëveshje.

c) Autoriteti Kontraktues do të mbështesë çdo aplikim për Mekanizmin e Zhvillimit të Pastrimit, që mund të paraqitet nga Koncessionari tek autoritetet përkatëse, veçanërisht për marjen e aprovimit nga Ministria e Mjedisit që është autoriteti kombëtar i caktuar shqiptar (“AKC”) (me kusht që Autoriteti Kontraktues të mos konsiderohet përgjegjës nëse nuk arrihet të merret ky aprovim.)

3. DETYRIMET (FAZA PARA NDËRTIMIT)

3.1 Detyrimet e Fazës Para Ndërtimit nën Përgjegjësinë e Koncessionarit

(a) Brenda një periudhe prej dy mbëdhjetë (12) muajsh pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Koncessionari do të sigurojë ose kujdeset të dërgojë tek Autoriteti Kontraktues:

(i) kopjet autentike të Statutit, Aktit të Themelimit dhe çertifikatën e Regjistrat Tregtar të Shoqërisë së Projektit;

(ii) një çertifikatë origjinale (ose të njëjtë me të) nga Palët Financuese që konfirmojnë se është bërë Mbyllja Financiare;

(iii) kopjet e çertifikatuara të çertifikatave siguruese që vërtetojnë (në mënyrë të arsyeshme të pranueshme për Autoritetin Kontraktues) se Koncessionari është pajisur me të gjitha policat e sigurimit dhe garancitë mbuluese por t'u marrë prej tij për të gjitha qëllimet e Fazës së Ndërtimit në përputhje me Nenin 9 (Siguracioni); dhe

(iv) projekt versionet finale të Marrëveshjes së Ndërtimit (nëse ka) dhe të Marrëveshjes së Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes (nëse ka), të cilat do të janë objekt i miratimit paraprak nga Autoriteti Kontraktues (që nuk duhet të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme) para nënshkrimit dhe dorëzimit.

(b) Brenda dy (2) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi, dhe në përputhje me Ligjin, Koncessionari do të fillojë procesin e shpronësimit në kohë të caktuara përsa i përket çdo parcele të Sheshit, që mund të konsiderohet i nevojshëm nga Koncessionari (dhe që është rënë dakord me Autoritetin Kontraktues siç parashikohet më poshtë), ashtu siç parashikohet ky proces në Aneksin F (*Procedura Treguese e Shpronësimit*), e cila nuk është detyruese dhe shërben vetëm për qëllime informuese, si dhe pa cenuar zbatimin e kërkësave të Ligjit, me kusht që:

(i) Koncessionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar për çdo procedurë shpronësimi në lidhje me Sheshin, duke përfshirë identifikimin e qartë të çdo parcele që do të shpronësohet;

(ii) Autoriteti Kontraktues do t'i miratojë këto shpronësime që propozohen dhe do të ndjekë procedurën përkatëse të shpronësimit në përputhje me Ligjin, me kusht që të gjitha kostot dhe shpenzimet e shoqëruara me të të mbahen nga Koncessionari;

(iii) në rast se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes së një kërkese për shpronësim nga Koncessionari, nuk arrin ta miratojë atë në përputhje me këtë Nen ose të ndjekë procedurat përkatëse në përputhje me Ligjin, Koncessionari do të ketë të drejtë (x) t'i japë Autoritetit Kontraktues një Njoftim për Zgjidhje dhe (y) të marrë kompensim nga Autoriteti Kontraktues në një shumë të barabartë me shpenzimet e arsyeshme dhe të justifikueshme të bëra nga Koncessionari në lidhje me ofertën e tij për Projektin dhe për zbatimin e Marrëveshjes së Koncessionit deri në datën e hyrjes në fuqi të Njoftimit për Zgjidhje (por ky kompensim nuk do të përfshijë ndonjë element të fitimit të munguar, të dëmeve të tërthorta ose të humbjeve të rezultuara); për të shmangur çdo dyshim, Koncessionari nuk do të marrë ndonjë kompensim nga Autoriteti Kontraktues në rast vonese në procesin e shpronësimit;

(iv) për të shmangur dyshimet, (x) çdo parcelë e shpronësuar në përputhje me sa më sipër do të konsiderohet se është e inkorporuar në Shesh (duke e përfshirë edhe për qëllim të Gëzimit të Qetë) që nga data e përfundimit të këtij shpronësimi, (y) data e paraqitur si datë e kërkësës nga Koncessionarit do të jetë data në të cilën Koncessionari ka paraqitur rregullisht të gjitha dokumentet e nevojshme për shpronësimin (siç kërkohet nga Ligji), dhe (z) Autoriteti Kontraktues ose Entiteti Shitetëror Përkatës do të marrë vendim lidhur me shpronësimin brenda kuadrit kohor të pacaktuar në përputhje me Ligjin.

Brenda dy (2) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi, si dhe në bazë të Ligjit, Koncessionari do t'i përfundovë procedurat për t'i siguruar Autoritetit Kontraktues dërgimin brenda afatit të një riport mjeti i cili, shëndetësor dhe përsigur, ashtu siç parashikohet për këtë proces në Sheshin I (*Tërheqja e referencës për Studimin e Vlerësimit të Ndikimit Social dhe Mjetit të Projektit Abita*), i cili nuk është detyrues dhe shërben vetëm për qëllime informuese, si dhe pa cenuar zbatimin e kërkësave të Ligjit.

(d) Brenda gjashtë (6) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi, si dhe në përputhje me Ligjin, Koncessionari do të aplikojë brenda afatit për t'u pajisur me të gjitha Autorizimet e këruara për qëllimet e Fazës së Ndërtimit (duke përfshirë Licensat) (dhe më pas t'i mbajë dhe t'i rinojë për aq sa është e aplikueshme), si dhe të kryejë apo të sigurojë dërgimin e kopjeve të çertifikuara tek Autoriteti Kontraktues pas kërkesës së parë me shkrim.

Në lidhje me Autorizimet (duke përfshirë Licensat) që kërkojnë kryerjen paraprake të Studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, periudha prej 6 muaj më sipër do të bëhet 12 muaj.

(e) Palët pranojnë dhe janë dakord se procesi dhe kuadri kohor për përbushjen nga Koncessionari të detyrimeve që jepen në nënparagrafët 3.1(a) deri në 3.1(d) më sipër, nuk mund të specifikohen me saktësi përsa i përket datës të parashikuar në to, ndërmjet të tjera, për shkak të mbivendosjeve të ndryshme ndërmjet këtyre proceseve (duke përfshirë pasojat që mund të ketë zgjatja e ndonjë prej këtyre proceseve, të parashikuar ose jo në Ligj, tek ndonjë proces tjetër) dhe, për këtë arsy, (x) përbushja e detyrimit nga Koncessionari për të filluar dhe/ose për të kryer, sipas rastit, çdo proces të tillë do të përcaktohet gjithmonë në bazë të rrethanave, dhe (y) në rast vonesë të ndonjë procesi të tillë, që nuk i atribuohet neglizhencës së Koncessionarit dhe që sjell si pasojë vonesë në fillimin ose zbatimin e Fazës së Ndërtimit, Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut do të konsiderohet automatikisht e zgjatur sa edhe kohëzgjatja e kësaj vonesë.

3.2 Detyrimi për Fazën Para Ndërtimit nën Përgjegjësinë e të Dyja Palëve

Brenda një periudhe prej njëqind e njëzetë (120) ditësh pas Datës së Hyrjes në Fuqi, (i) Autoriteti Kontraktues dhe Koncessionari do të lidhin marrëveshjeuzufruki, me kushte të arsyeshme dhe zakonore, duke vendosuruzufruktëmbi Sheshin dhe Objektet Ekzistuese (për aq sa është e aplikueshme) në favor të Koncessionarit dhe pa pagesë (kur Objektet Ekzistuese nuk administrohen nga METE, METE do të sigurojë që Entitetet Shtetërore përkatëse të lidhin po këto lloj marrëveshjesh), dhe (ii) Koncessionari do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar krijimin, vendosjen dhe regjistrimin e menjëhershëm tëuzufruktëmbi Sheshin dhe Objektet Ekzistuese (për aq sa është e aplikueshme), si dhe do të mbajë të gjitha koston që lidhet me të, me asistencën e arsyeshme të Autoritetit Kontraktues kur këtij i kërkohet, pa shmangur detyrimet e tij për të paguar koston e shpronësimit, tarifat e regjistrimit, etj.

3.3 Fillimi i Fazës së Ndërtimit

Fillimi i Fazës së Ndërtimit do të konsiderohet se ndodh në datën në të cilën Koncessionari dhe Autoriteti Kontraktues do të kenë pranuar me shkrim se janë përbushur detyrimet e parashikuara në Nenet 3.1 dhe 3.2 më sipër (ose është hequr dorë prej tyre nga Autoriteti Kontraktues në masën që lejohet nga Ligji).

3.4 Pasojat e Zgjidhjes mbi Garancinë e Kontratës

Në rast të një shkeljeje thelbësore nga secila Palë të ndonjë prej detyrimeve të veta të parashikuara në Nenet 3.1 dhe 3.2 më sipër, i cili nuk justifikohet si Rast Mospërbushjeje nga Autoriteti Kontraktues ose si një Veprim Shtetëror Thelbësishët në Kundërshtim me Marrëveshjen (në rast të një shkeljeje nga Koncessionari), si Rast i Forcës Madhore ose si një rast tjetër i justifikuar nga Ligji (në rast të ndonjë shkeljeje nga secila Palë), Pala që nuk është në shkelje ka të drejtë t'i japë Njoftim për Zgjidhje Palës tjetër.

Në rast se zgjidhja rezulton nga një shkelje e Koncessionarit siç parashikohet më sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë nga Garancia e Kontratës deri në atë shumë sa të mbulojë dëmet, pa i cenuar të drejtën Autoritetit Kontraktues për të kërkuar zhëmtimin e dëmeve përpjek shumave të marra nga Garancia e Kontratës.

3.5 Njësia e Zbatimit të Projektit

(a) Brenda një muaji nga Data e Hyrjes në Fuqi, Palët do të krijojnë njësinë e zbatimit të projektit për Fazën Para Ndërtimit, e cila do të përbëhet nga katër anëtarë që caktohen si më poshtë ("NjZP"):

- (i) dy anëtarë, funksionarë të lartë të shtetit të caktuar nga METE; dhe
 - (ii) dy anëtarë, përfaqësues të rangut të lartë të Koncessionarit.
- (b) Puna e NjZP do të përfundojë automatikisht me fillimin e Fazës së Ndërtimit, përvçe kur Palët bien dakord bashkërisht për zgjatjen e afatit të NjZP.

(c) Çdo anëtar i NjZP ka të drejtë të stojë persona të tjera si vëzhgues të ftuar, duke përfshirë përfaqësues të KESH-it, për të marrë pjesë në takimet e NjZP, kur ata e shikojnë të arsyeshme, me kusht që çdo Palë mund ta refuzojë në mënyrë të aryeshme praninë e këtyre personave.

(d) NjZP do të mbikëqyrë dhe koordinojë aktivisht përbushjen nga Palët të detyrimeve të tyre respektive të Fazës Para Ndërtimit, me synimin e përshejtimit për aq sa është praktikisht e arsyeshme, të fillimit të Fazës së Ndërtimit. Në veçanti ajo do të shqyrtojë çdo propozim për zgjatje të afateve dhe për ndryshime të Projektit, si dhe çdo çështje tjetër të cilën ajo dëshiron ta marri në shqyrtim në lidhje me Projektin, ose që i referohet asaj nga secila prej Palëve.

(e) Palët së bashku mund t'i bëjnë thirrje NjZP për t'i ndihmuar ato në përpjekjet e tyre në mirëbesim për të zgjidhur me pajtim një Mosmarrëveshje, siç parashikohet në Nenin 13.1 (*Zgjidhje me Pajtim*), me kusht që, megjithatë, vendimet e NjZP nuk do të jenë kurrë detyruese për Palët, përvèç kur Palët kanë rënë dakord shprehimi ndryshe me shkrim.

(f) NjZP do të mblidhet në Tiranë sa herë të jetë e nevojshme, por të paktën një herë në dy muaj. Ajo nuk do të jetë e detyruar të zbatojë rregulla proceduriale të caktuara.

4. TARIFAT

4.1 Tarifa e Koncessionit

Gjatë Fazës së Shfrytëzimit, Koncessionari detyrohet t'i japë Autoritetit Kontraktues pa pagesë dy përqind (2%) të Prodhimit Vjetor Neto të Energjisë Elektrike (“**Tarifa e Koncessionit**”), d.m.th. Koncessionari (në cilësinë e tij si Shitës sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë) do ta faturojë Blerësin për 100% të Prodhimit të Energjisë Elektrike minus 2%, e cila do të përbëjë Tarifën e Koncessionit dhe nuk do të jetë e pagueshme nga Blerësi.

Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike do të jepet nga Koncessionari dhe do të grumbullohet nga [KESH ose OST] në emër të Autoritetit Kontraktues tek Pika e Lëvrimit.

Tarifa e Koncessionit, me zgjidhjen e Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, pasi Koncessionari dhe KESH-i të mos kenë arritur të rinovojnë Marrëveshjen e Shitjes së Energjisë siç parashikohet në Nenin 8.12 të Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë, do të fiksohet për të reflektuar në mënyrë të arsyeshme pozitën ekonomik të përmirësuar të Koncessionarit (si Shitës) për të hyrë në marrëdhënie me palë të treta në treg të hapur, kur është e mundur.

4.2 Tarifa e Përdorimit të Ujit

Tarifa e përdorimit të ujit, në masën dhe për aq sa është në fuqi në përputhje me Ligjin e zbatueshëm shqiptar (“**Tarifa e Përdorimit të Ujit**”), është përfshirë në Tarifën e Koncessionit dhe përbën pjesë të saj dhe asnjë shumë e veçantë përsa i përket Tarifës së Përdorimit të Ujit nuk do të jetë e pagueshme nga Koncessionari. Pagesa e Tarifës së Koncessionit në përputhje me Nenin 4.1 do të përbëjë pagesën në tërësi të Tarifës së Përdorimit të Ujit, nëse ka. Çdo rritje ose rivendosje e mëvonshme e Tarifës së Përdorimit të Ujit ose ndonjë tarife të ngjashme nuk do t'i japë të drejtë Autoritetit Kontraktues për një rritje korresponduese të shumës së Tarifës së Koncessionit.

4.3 Tarifa e Suksesit

Koncessionari do të jetë i detyruar t'i paguajë IFC një tarifë suksesi prej një milion e njëqind mijë Dollarë Amerikanë (US\$ 1,100,000). Pagesa do të bëhet brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Koncessioni, pa asnjë lloj zbritje për taksa, tarifa, tatime, detyrime ose pagesa të tjera të mbajtura (të gjitha këto do të bëhen nga Koncessionari), në llogarinë e IFC's N°2000192003476, Swift Code PNBPUS3NNYC, ABA Number 026005092, në Wachovia Bank N.A., New York, 11 Penn Plaza, Floor 4, New York, NY 10038 ose në një llogari tjetër të IFC që mund të caktohet nga IFC.

5. KONTROLLI

5.1 Kontrolli

Brenda Afatit, Koncessionari do të Kontrollojë Shoqërinë e Projektit, me kusht që, gjithashtu, (i) çdo Aksioner (duke përfshirë edhe Koncessionarin) do të ketë të drejtë të transferojë lirisht, pjesërisht ose plotësisht, aksionet e Shoqërisë së Projektit te një Aksioner tjetër ose te ndonjë prej Filialave të tij në çdo kohë gjatë Afatit, në qoftë se një transfertë e tillë nuk do të çojë në transferimin e Kontrollit nga Koncessionari, si dhe (ii) çdo transfertë tjetër, e pështimë ose e plotë, e

aksioneve të Shoqërisë së Projekti (duke përfshirë transferimin e Kontrollit) do të jetë objekt i miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues, miratim i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme, me kusht që, më tej, në lidhje me ndonjë transferim të propozuar në përputhje me pikën (ii) më sipër (duke përfshirë transferimin e Kontrollit), Autoriteti Kontraktues do t'i kushtojë konsideratën e duhur eksperiencës, gjendjes financiare (e cila do të përfshijë mbështetjen kredituese nga palë të treta), stabilitetit dhe reputacionin të përfituesit të transferimit të propozuar.

5.2 Investimi Minimal i Pjesëmarrjes së Aksionerëve

Koncessionari do të kujdeset që Pjesëmarrja e Aksionarëve e paguar plotësisht në Shoqërinë e Projektit është dhe do të mbetet të paktën 20% e shumës së shpenzimeve kapitale të kerkuara nga Koncessionari në lidhje me zbatimin e Punimeve të Ndërtimit (“**Investimi Minimal i Pjesëmarrjes së Aksionerëve**”).

Në mënyrë që të arrihet Investimi Minimal i Pjesëmarrjes së Aksionerëve, çdo Projekt për Dhënie Huaje nga Aksionerët deri në shumën prej 20% të shumës së shpenzimeve të tillë kapitale do të llogariten si Pjesëmarrje Aksionerësh. Shuma e Projekteve për Dhënie Huaje të Aksionerëve që e kalon shumën e Investimit Minimal të Pjesëmarrjes së Aksionerëve do të merret në konsideratë për të përllogaritur shumën e Pagesës A të Zgjidhjes në përputhje me Nenin 11.3 të kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Shoqëria e Projektit – Detyrimet e Koncessionarit

Koncessionari merr përsipër se:

- (i) ai do të ruajë ekzistencën e Shoqërisë së Projektit si një shoqëri aksionere ose një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me Ligjin, dhe
- (ii) pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues (që do të jetë diskrecionar), Shoqëria e Projektit nuk do të angazhohet në asnje biznes tjetër përvëç Projektit.

6. AUTORIZIMET

Koncessionari do të pajisjet, ruajë dhe ripërtërijë në çdo kohë të gjitha Autorizimet e kerkuara për Projektin (me shpenzimet e tij por me ndihmën e arsyeshme të Autoritetit Kontraktues sa herë që t'i kerkohet), duke përfshirë Autorizimet e specifikuara në Shtojcën H (*Lista Treguese e Autorizimeve që Kerkohen për Ndërtimin e Hidrocentralit*), ashtu si mund të plotësohet ose ndryshohet, duke mos qenë kjo një listë gjithëpërfshirëse ose kufizuese.

7. NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT

7.1 Projekt-Ideja dhe Projekti i Detajuar

Koncessionari do të ndërtojë Hidrocentralin në përputhje të plotë me:

- (i) Kërkesat Teknike Minimale;
- (ii) Projekt-Idenë; dhe
- (iii) Projektin e Detajuar, ashtu siç është përshtatur dhe/ose përmirësuar sipas Nenit 7.2.1 dhe 7.2.3 më poshtë.

Për të hequr çdo dyshim, Projekti i Detajuar nuk duhet të vijë në kundërshtim me Projekt-Idenë, veçanërisht përsa i përket të qenurit në përputhje me Kushtet Teknike Minimale, përvëç kur mospërpulhet ndërmjet Projektit të Detajuar dhe Projekt-Idesë janë rezultat i negociatave ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncessionarit (Autoriteti Kontraktues do të pranojë të gjitha kërkesat e arsyeshme të Koncessionarit), ose nga kërkesat e ndonjë Entiteti Shtetëror (Koncessionari do të pranojë të gjitha kërkesat e arsyeshme të Autoritetit Kontraktues).

7.2 Kërkesat Teknike Minimale për Hidrocentralin

Kërkesat Teknike Minimale për Hidrocentralin janë paraqitur në Shtojcën B (*Kërkesat Teknike Minimale*).

Nëse, brenda dhjetë (10) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi, (i) ERE nuk i ka bërë Koncessionarit ose Shoqërisë së Projektit, sipas rastit, përjashtimet e nevojshme nga Kodi Shqiptar i Transmetimit, ose (ii) ERE nuk ka zbatuar amendamentet e nevojshme të Kodit Shqiptar të Transmetimit, në çdo rast me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria dhe përputhshmëria e Teknologjisë StrafloMatrix me Kodin Shqiptar të Transmetimit dhe me Ligjin në përgjithësi (pasi Koncessionari t'i japë ERE-s ose ndonjë Entiteti tjetër Shtetëror të gjithë informacionin e arsyeshëm për këtë qëllim), Koncessionari do të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje, rast në të cilin

Koncessionari ose Shoqëria e Projektit do të kompensohen nga METE me 50% (pesëdhjetë përqind) të kostos së arsyeshme dhe të justifikuar si duhet, të bërë nga Shoqëria e Projektit që nga data e nënshkrimit deri në datën e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, por në çdo rast jo më shumë se 5 milion Euro (pesë million Euro) (me kusht që nëse Koncessionari vendos që mos e zgjidhë këtë Marrëveshje, ai nuk do të ketë të drejtë për një kompensim të tillë).

7.2.1 Projektimi dhe Ndërtimi

Koncessionari, me koston dhe shpenzimet e tij, do të marrë përsipër projektet inxhinierike, prokurimin, ndërtimin dhe testet e funksionimit të Hidrocentralit në përputhje me:

- (i) Projektin e Detajuar;
- (ii) Datën e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut;
- (iii) specifikimet teknike të hollësishme dhe të detajuara që do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktues për shqyrtim tre (3) muaj para fillimit të Punimeve të Ndërtimit (*Specifikimet dhe Kërkesat Teknike*); dhe
- (iv) Praktikën e Industrisë së Mirë.

Koncessionari do të ndërtojë linjën e transmetimit të Hidrocentralit deri te linja e transmetimit të OST-së duke marrë përsipër rreziqet dhe shpenzimet dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha Punimet e Ndërtimit. Pas përfundimit të saj, linja e transmetimit do të jetë në pronësi të OST-së dhe të gjitha rreziqet dhe kostot do t'i transferohen prej atij momenti OST-së.

7.2.2 Përgjegjësia e Koncessionarit

Koncessionari do të jetë i vërtmi përgjegjës për ndonjë të metë në projektin e Hidrocentralit (duke përfshirë dhe Projekt-Idenë). Mos-kundërshtimi nga Autoriteti Kontraktues i ndonjë projekti, vizatimi ose specifikimi të projektit apo të ndonjë ndryshimi të tij, nuk do të interpretohet si heqje dorë e Autoritetit Kontraktues nga ndonjë e drejtë e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe as do ta çlironjë në ndonjë mënyrë Koncessionarin nga ndonjë prej detyrimeve të tij të parashikuara në këtë Marrëveshje. Në vijim të sa më sipër, Koncessionari:

- (i) pranon se asnjë rishikim i kryer nga Autoriteti Kontraktues përsa i përket projektit të Hidrocentralit (duke përfshirë Projekt-Idenë) nuk do ta çlironjë Koncessionarin nga ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe se Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi, si për cilësinë e projektit inxhinierik, ashtu edhe për ndërtimin e projektit të Hidrocentralit (duke përfshirë Projekt-Idenë), të Hidrocentralit ose të ndonjë përbërësi të tij;
- (ii) në asnjë mënyrë nuk do të deklarojë ose lerë të kuptohet te ndonjë palë e tretë, se, si rezultat i ndonjë rishikimi nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për projektin inxhinierik ose cilësinë e ndërtimit të projektit të Hidrocentralit (duke përfshirë Projekt-Idenë), të Hidrocentralit ose të ndonjë përbërësi të tij; dhe
- (iii) do të jetë përgjegjës i vetëm për aftësinë teknike, kapacitetin funksional, sigurinë e projektit të Hidrocentralit, të Hidrocentralit dhe të ndonjë përbërësi të tij.

7.2.3 Të dhënat Teknike

Informacioni dhe të dhënat e mëposhtme u bënë të mundura, ndër të tjera, nga Autoriteti Kontraktues dhe ndodhen në dhomën e të dhënavë për Projektin Ashta tek <ftp://worldbank.org> ("Dhoma e të Dhënavë"):

- (i) Memorandum Informativ lidhur me të dhënat teknike që gjenden në Nenet 3 deri në 5 (duke përfshirë të gjitha Shtojcat që gjenden në to);
- (ii) Raporti Lahmeyer mbi Projektin e Hidrocentralit Bushati;
- (iii) Dokumenti "05_HPP-Drin_River-Cascade.xls";
- (iv) Dokumenti "03_Vau_Dejes_flows.xls";
- (v) të gjitha hartat dhe vizatimet që ndodhen në Dhomën e të Dhënavë.

Nëse në çdo kohë para datës, që është gjashtë (6) muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Koncessionari arrin në mënyrë të arsyeshme në konkluzionin se ndonjë nga këto informacione është fals, i pasaktë, i paplotë ose çorrientues (në çdo rast të jetë thelbësisht i tillë), Koncessionari do të ketë të drejtë të ndryshojë Projekt-Idenë në masën ekzaktësisht të kërkuar si rezultat i këtij informacioni, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim për të kompensuar Koncessionarin për vlonjë kosto që do të lindë si pasojë e një informacioni të tillë. Autoriteti Kontraktues do të

informojë menjëherë Koncessionarin nëse ai vihet në dijeni të ndonjë informacioni fals, të pasaktë, të plotë ose çorientues (në çdo rast të jetë thelbësishë i tillë) në Dhomën e të Dhënavë dhe do t'i sigurojë menjëherë Koncessionarit informacionin e korriguar.

7.2.4 Programi i Ndërtimit

Nëse, përtej kontrollit të Koncessionarit, haset ndonjë pengesë që do të rezultonte në një vonesë në kryerjen e Punimeve ose në arritjen e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, Koncessionari duhet t'i dërgojë një raport Autoritetit Kontraktues brenda dhjetë (10) Ditës së Punimeve nga data e zbulimit të pengesës, duke pëershkuar arsyet që çuan ose që do të çojnë në një vonesë të tillë, si dhe masat që do të merren për të shmangur ose minimizuar vonesën përfundimin e Punimeve nga Data e Përfundimit sipas Grafikut. Ky Nen nuk do të cënojë të drejtën përfundimin e Punimeve nga Data e Përfundimit sipas Grafikut që i është dhënë Koncessionarit në përpunim me Nenin 7.2.7.

7.2.5 Sistemi i Garantimit të Cilësisë

a. Sistemi i Koncessionarit përfundimit të cilësisë: Para fillimit të çdo Punimi, Koncessionari do të krijojë Sistemin e Garantimit të Cilësisë, i cili do t'i vihet në dispozicion Autoritetit Kontraktues. Koncessionari do të zbatojë Sistemin e Garantimit të Cilësisë përgjatë gjithë kryerjes së Punimeve përkatëse.

b. E drejta e Autoritetit Kontraktues përfundimit të cilësisë: Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që brenda orarit të punës të jetë i pranishëm ose të vëzhgojë metodat dhe inspektimet e kontrollit të cilësisë përfundimit se çdo zë Punimesh përpunhet me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje. Koncessionari do të ndihmojë në kryerjen e këtyre kontolleve.

c. Mospërmbushja e kërkesave të cilësisë dhe të sigurisë: Nëse Punimet ose çdo zë i tyre nuk arrin të jetë në përpunim me ndonjë aspekt thelbësor të kërkesave të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë kërkesat përfundimit të cilësinë ose sigurinë), Autoriteti Kontraktues mund ta njoftojë Koncessionarin përfundimit të cilësisë. Koncessionari do ta korrigojë ose do të fillojë thelbësishë korrigjimin e të metës, të gabimeve në Projektin e Detajuar, të ometimeve, të gabimeve, të defekteve, etj., brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i Autoritetit Kontraktues.

7.2.6 Raportet mbi Progresin e Ndërtimit

Gjatë Fazës së Ndërtimit, në ditën e parë të çdo muaji (ose Ditën tjeter të Punës nëse kjo datë nuk është Ditës së Punimeve) në vijim të muajit të parë pas fillimit të Fazës së Ndërtimit, Koncessionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues një raport mbi progresin e ndërtimit, duke detauar (i) çdo zë të Punimeve, në përfundim ose në proces përfundimit të cilësisë (përveç muajin paraardhës (përveç muajit para fillimit të Fazës së Ndërtimit), (ii) punën që pritet të përfundohet gjatë muajit, (iii) periudhën e planifikuar deri në përfundimin e Punimeve, (iv) çdo ngjarje ose rrethanë që ka mundësi në mënyrë të arsyeshme të vështirësuar ose vonoje arritjen e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, dhe (v) çdo të dhënë tjeter që mund të kerkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

7.2.7 Rrethana të Veçanta Gjatë Fazës së Ndërtimit: Zgjatja e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut

Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut mund të zgjatet në këto raste:

(i) në Rastin e një Force Madhore (siç parashikohet në Nenin 10.1);

(ii) në Rastin e Veprimit Shtetëror Thelbësishë në Kundërshtim me Marrëveshjen (siç parashikohet në Nenin 10.2) që pengon përbushjen e detyrimeve nga Koncessionari;

(iii) në Rastin e Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues (siç parashikohet në Nenin 11.1.2);

(iv) zbulimi i relikeve kulturore arkeologjike, fosileve, tumave të varrezave dhe përmendoreve, mbetjeve të kaluara artistike dhe çdo Sendi tjeter me domethënë arkeologjike, gjeologjike dhe historike në Shesh, që rezulton në kryerjen e punëve publike që ndërhyn në ndërtimin e përfundimin e Punimeve nga Koncessionari, me kusht që zgjatja t'i korrespondojë kohëzgjatjes së rastit përkatës (dhe Palët të kenë të drejtë t'ia referojnë çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Nen mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeje të pëershkuar në Nenin 13); ose

(v) çdo rast tjeter që çon në një zgjatje të Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut siç parashikohet në Nenin 3.1(e).

Në rast se ndodh ndonjë prej ngjarjeve të sipërpërmendura, Koncessionari do të ketë favorin e shtyrjeve të Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, por nuk do të ketë në asnjë mënyrë të drejtën e kompensimit.

7.2.8 Monitorimi dhe Inspektimi i Ndërtimit të Hidrocentralit

a. Përveç monitorimit dhe inspektimit nga Entitetet përkatëse Shtetërore në përputhje me Ligjin Shqiptar, Autoriteti Kontraktues mund ta monitoroje dhe inspektojë ndërtimin gjatë Fazës së Ndërtimit në prani të Koncessionarit, pasi i jep një njoftim të mëparshëm të arsyeshëm Koncessionarit; me kusht që, gjithsesi, ky monitorim dhe inspektimi të mos shkaktojë ndonjë pengesë të paarsyeshme, të ndërhyjë në progresin e ndërtimit ose të ndërpresë ndërtimin padrejtësisht. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit do të përblidhen me shkrim dhe nënshkruhen menjëherë më pas nga të dyja Palët.

b. Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër kostot e monitorimit dhe inspektimit të ndërtimit të Hidrocentralit nga Autoriteti Kontraktues, përveç kur monitorimi dhe inspektimi nxjerr të meta thelbësore në ndërtim, materiale, pajisje ose makineri, rast në të cilin kostot i merr përsipër Koncessionari.

7.2.9 Detyrime të tjera

Koncessionari duhet:

a. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues të ketë të drejtë të hyjë në Hidrocentral, në Shesh, me kusht që kjo e drejtë të mos përdoret për të ndërhyrë në ndërtim ose për ndërprerjen e ndërtimit, si dhe të ushtrohet pasi t'i jetë bërë Koncessionarit një njoftim paraprak i arsyeshëm;

b. t'i sigurojë Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktues, me kërkesë të arsyeshme të këtij, kopje të çdo dokumenti, vizatimi dhe projektimi;

c. të parandalojë dhe/ose kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë Punim;

d. të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë lidhur me Sheshin;

e. të heqë mbetjet nga ndërtimi dhe mbeturinat e projektit në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Praktikën e Industrisë së Mirë;

f. të mos dëmtojë ndonjë tubacion, linjë kabllore ose kanal ekzistues Shesh, përveç kur bëhet me aprovim nga Autoriteti Kontraktues;

g. të merret me të gjitha problemet ose çështjet që dalin si rezultat i Projektit të Detajuar, projektit inxhinierik, prokurimit, ndërtimit dhe testeve të funksionimit të Hidrocentralit në mënyrën e parashikuara ose në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një informacion në lidhje me këto probleme.

7.2.10. Procedura e Komisionimit

Koncessionari do të kryejë komisionimet dhe testet e funksionimit të Hidrocentralit në përputhje me procedurat e parashikuara në Shtojcën G (*Komisionimi dhe Procedurat Testuese*).

7.2.11. Detyrimet Pas Përfundimit

(a) Dërgimi i vizatimeve dhe materialete teknike

Jo më vonë se katër (4) muaj pas Datës Faktike të Përfundimit të Punimeve, Koncessionari duhet t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues materialet e mëposhtme:

(i) të gjitha të dhënat teknike (duke përfshirë raportin e projektit, dokumentet e përllogaritjeve dhe projektit, si në formë të printuar, ashtu edhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e nevojshme të programit elektronik), që lidhen me projektimin e ndërtimit të Hidrocentralit (dy (2) kopje);

(ii) materialet teknike dhe vizatimet e pajisjeve, duke përfshirë skicat origjinalë (përfshirë vizatimet “e ndërtimit siç është realizuar”), dokumentet, udhëzimet dhe certifikatat e cilësisë, si dhe evidencave të instalimeve dhe të inspektiveve (dy (2) kopje); dhe

(iii) të gjitha dokumentat ose materialet teknike që lidhen me Hidrocentralin, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues (dy (2) kopje).

(b) Të drejtat e Pronësisë Intelektuale

Koncessionari e garanton Autoritetin Kontraktues se ai ka pronësinë ose licencën për të përdorur Projektin e Detajuar dhe çdo dokument tjeter të përdorur për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit, të cilat janë objekti i të drejtave të pronësisë intelektuale.

7.2.12 Vonesa për Përfundimin që i Atribuohen Koncessionarit

(a) Përveç ngjarjeve të renditura sipas Nenit 7.2.7 të kësaj Marrëveshjeje (*Rrethanat e veçanta - Zgjatja e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut*), nëse data e Përfundimit Thelbësor zgjatet përtej Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, ose nëse Koncessionari nuk arrin të përmbrushë ndonjë nga detyrimet e tij të parashikuara në Nenin 7.2.11 më sipër (“**Detyrimet Pas Përfundimit**”) brenda periudhës kohore të specifikuar atje pér këtë, Koncessionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues Dëmet e Likujdueshme në mënyrën si vijon:

(i) 1,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita 1-rë deri në ditën e 30-të të mospërbushjes;

(ii) 15,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita 31-të deri në ditën e 60-të të mospërbushjes;

(iii) 30,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita e 61-të deri në ditën e 85-të të periudhës së vonesës nga Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut (ose nga data e Detyrimit përkatës Pas-Përfundimit);

(iv) 60,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita e 86-të deri në ditën e 110-të të periudhës së vonesës nga Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut (ose nga data e Detyrimit përkatës Pas-Përfundimit);

(v) 90,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita e 111-të deri në ditën e 135-të të periudhës së vonesës nga Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut (ose nga data e Detyrimit përkatës Pas-Përfundimit).

(vi) 120,000 Euro pér çdo ditë vonese nga dita e 136-të deri në ditën e 160-të të periudhës së vonesës nga Data e Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut (ose nga data e Detyrimit përkatës Pas-Përfundimit).

Totali i Shumës së Dëmeve të Likujdueshme gjatë Fazës së Ndërtimit, pér të cilën Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë t’i paguhen në çdo kohë të dhënë nuk e kalon shumën 7,980,000 Euro (“**Tavani i Dëmeve të Likujdueshme në Ndërtim**”).

Me arrijeten e Tavanit të Dëmeve të Likujdueshme në Ndërtim, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të zgjidhë Marrëveshjen në bazë të Rastit të Mospërbushjes nga Koncessionari, rast i cili me gjithatë nuk i heq të drejtën Autoritetit Kontraktues pér të marrë çdo shumë nga Garancia e Konratës, e papaguar në atë kohë, deri në shumën e plotë të saj pér të mbuluar dëmet. Kjo e drejtë, më tej, nuk i heq Autoritetit Kontraktues të drejtën pér të kërkuar zhëdëmtimin e dëmeve përtej shumave që merren nga Garancia e Konratës. Çdo shumë e paguar si Dëm i Likujdueshëm do t’i kreditohet shuma të kérkuara pér dëme të tilla.

(b) Çdo pagesë e Dëmeve të Likujdueshme gjatë Fazës së Ndërtimit do të bëhet nga Koncessionari te Autoriteti Kontraktues brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e Njoftimit nga Autoriteti Kontraktues, ku jepen shumat e Dëmeve të Likujdueshme, të cilat pas Njoftimit bëhen të detyrueshme pér t’u paguar. Nëse Koncessionari nuk arrin të paguajë Dëme të tilla të Likujdueshme kur këto bëhen detyrueshme pér t’u paguar, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marri çdo shumë ose shuma nga Garancia e Konratës.

(c) Çdo shumë e paguar nga Koncessionari te Autoriteti Kontraktues si Dëm i Likujdueshëm do të përbëjë kompensim të vetëm dhe ekskulziv (duke përfshirë, pér të hequr çdo dyshim, rastin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje sipas Nenit 11.1.1(d)) pér Autoritetin Kontraktues pér raste të tilla dhe do të paguhet thjesht si një përllogaritje e humbjes së pësuar nga Autoriteti Kontraktues, si dhe nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë se përbën një sanksion.

7.2.13 Konsideruar e Braktisur

Ndërtimi i Hidrocentralit do të konsiderohet i braktisur nga Koncessionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, Koncessionari:

(a) njofton Autoritetin Kontraktues pér vendimin e tij pér të braktisur plotësisht ose pjesërisht Punimet;

(b) nuk rifillon plotësish ose pjesërisht ndërtimin e Punimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga mbarimi i Rastit të Forcës Madhore;

(c) ndërpret ndërtimin e të gjitha ose pothuaj të gjitha Punimeve për një periudhë në vazhdim prej gjashtëdhjetë (60) ditësh; ose

(d) tërheq drejtëpërdrejt ose nëpërmjet veprimit të kryer nga kontraktuesi i ndërtimit, të gjithë, ose pothuaj të gjithë, personelin nga Sheshi, para Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, me kusht që:

(i) kjo tërheqje të çojë në një ndërprerje të plotë të Punimeve; dhe

(ii) të mos jetë caktuar një kontraktues zëvendësues ndërtimi për të vazduar ndërtimin, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data në të cilën është ndërprerë ndërtimi.

Data e braktisjes ose e të konsideruarit të braktisur do t'i korrespondojë, (x) në rastin e parashikuar në paragrafin (a) më sipër, datës s njoftimit, dhe (y) në rastet e parashikuara në paragrafet (b) deri te (d) së bashku, ditës që vjen menjëherë pas datës, në të cilën kanë përfunduar afatet gjashtëdhjetë ditore të parashikuara në ato paragrafë.

7.2.14 Mos-zbatimi i Dëmeve të Likujdueshme për Braktisjet – E drejta për Zgjidhje e Autoritetit Kontraktues

Nëse Koncessionari braktis ose konsiderohet se ka braktisur ndërtimin në përputhje me Nenin 7.2.13, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i japë Koncessionarit një Njoftim për Zgjidhje, si dhe ka të drejtë të marrë çdo shumë nga shuma e mbetur nga Garancia e Konratës për të mbuluar dëmet. Kjo e drejtë, më tej, nuk i heq Autoritetit Kontraktues të drejtën për të kërkuar zhëmëtimin e dëmeve përtrej shumave që merren nga Garancia e Konratës. Çdo shumë e paguar si Dëm i Likujdueshëm do t'i kreditohet shumave që kërkohen për dëme të tilla.

7.2.15 Garancia e Konratës

(a) Garancia e Ndërtimit

Para ose në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Koncessionari paraqet një Garanci Ndërtimi, e cila është thelbësish në përputhje me formatin e paraqitur në Shtojcën C (*Format e Garancisë së Konratës*) (Kopje e së cilës i është bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje).

Garancia e Ndërtimit do të garantojë përbushjen siç duhet dhe në kohë të detyrimeve të Koncessionarit që nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në përfundimin e Fazës së Ndërtimit.

Koncessionari do të ripërtërijë çdo vit Garancinë e Ndërtimit gjatë Fazës së Ndërtimit dhe do t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues çdo kopje të ripërtëritjes së Garancisë së Ndërtimit jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë. Puna para mbarimit të afatit të Garancisë së Ndërtimit që ishte për t'u rinovuar.

Për të hequr çdo dyshim, nëse Koncessionari nuk i përcjell Autoritetit Kontraktues në vijueshmëri ndonjë nga Garancitë e Ndërtimit, siç u tha më sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë shuma nga Garancia e Ndërtimit në fuqi, si dhe do të konsiderohet se ka ndodhur Rasti i Mospërbushjes nga Koncessionari, me kusht që t'i jetë dhënë njoftimi Koncessionarit, siç parashikohet atje për këtë Rast (në përputhje me Nenin 14.11), si dhe të ketë mbaruar periudha prej pesembëdhjetë (15) ditësh për kryerjen e këtij rinovimi pa iu përcjellë Autoritetit Kontraktues Garancia e rinovuar e Ndërtimit.

Autoriteti Kontraktues do ta zhbllokojë plotësish Garancinë e Ndërtimit në Datën Faktike të Përmbanimit të Punimeve.

Shuma maksimale që Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Garancia e Ndërtimit do të jetë 16,000,000 Euro (gjashtëmbëdhjetë milion Euro).

(b) Garancia e Shfrytëzimit dhe e Mirëmbajtjes

Para fillimit të Fazës së Shfrytëzimit, Koncessionari do të paraqesë Garancinë e Shfrytëzimit e Mirëmbajtjes, e cila do të jetë thelbësish në përputhje me formatin e parashikuar në Shtojcën C (*Format i Garancisë së Konratës*).

Garancia e Shfrytëzimit dhe e Mirëmbajtjes do të garantojë përbushjen siç duhet dhe në kohë të detyrimit, nga Koncessionari për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen gjatë gjithë Afatit, duke ndëshkuar dhe pacasat e Dëmeve të Likujdueshme të Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes në përpunimë me Nenin 8.2 me poshtë (*Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja – Dëmet e Likujdueshme*).

Koncessionari do të rinovojoë Garancinë e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes çdo tre (3) vjet gjatë Fazës së Shfrytëzimit dhe do t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues çdo Garanci të rinovuar të Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë Pune para mbarimit të afatit të Garancisë së Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes që është për t'u rinovuar.

Për të hequr çdo dyshim, nëse Koncessionari nuk arrin t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues në vijueshmëri ndonjë nga Garancitë e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes, siç u tha më sipër, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të marri shuma nga Garancia e Shfrytëzimit dhe e Mirëmbajtjes në fuqi, si dhe do të konsiderohet se ka ndodhur Rasti Mospërbmbushjes nga Koncessionari, siç parashikohet atje për këtë Rast (në përputhje me Nenin 14.11), me kusht që t'i jetë dhënë njoftim Koncessionarit, si dhe të ketë mbaruar periudha prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për të kryer këtë rinovim pa iu përcjellë Autoritetit Kontraktues Garancia e rinovuar të Ndërtimit.

Shuma maksimale që Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Garancia e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes do të jetë si më poshtë:

- (i) Për 5 vitet e para të Fazës së Shfrytëzimit, 8,000,000 Euro (tetë milion);
- (ii) Nga viti i 6-të deri vitin e 10-të të Fazës së Shfrytëzimit, 6,400,000 Euro (gjashtë milion e katërqind mijë);
- (iii) Nga viti i 11-të deri vitin e 15-të të Fazës së Shfrytëzimit, 4,800,000 Euro (katër milion e tetëqind mijë);
- (iv) Nga viti i 16-të deri në mbarim të Afatit, 3,200,000 Euro (tre milion e dyqind mijë).

(c) *Garancia e Dorëzimit*

Përveç rastit të zgjidhjes së parakohshme të kësaj Marrëveshjeje, Koncessionari, jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë Pune para mbarimit të Afatit, do t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues Garancinë e Dorëzimit, e cila do të jetë thelbësishët në përputhje me formatin e parashikuar në Shtojcën C (*Format i Garancisë së Kontratës*), dhe që do të garantojë kryerjen siç duhet dhe në kohë të detyrimeve të Koncessionarit për dorëzimin sipas kësaj Marrëveshjeje, siç detajohet më tej në Nenin 12 më poshtë (*Dorëzimi*).

Shuma maksimale që Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Garancia e Dorëzimit do të jetë 3,200,000 Euro (tre milion e dyqind mijë).

Garancia e Dorëzimit do të mbetet e vlefshme për gjashtë (6) muaj pas mbarimit të Afatit.

7.3 Pajisjet dhe Furnizimi – Garancitë e Punimeve – Nxjerrja e Materialeve

7.3.1 Koncessionari garanton se të gjitha pajisjet e përdorura ose të përfshira në Punimet do të janë të reja dhe të papërdorura dhe në përputhje me të gjitha dispozitat e zbatueshme të Ligjit Shqiptar, duke përfshirë Ligjin për Mjedisin, si dhe standartet e zbatueshme përgjithësisht të pranuara të projekteve të energjisë hidroelektrike të një përmase dhe lloji të krahasueshëm me Hidrocentralin, në pajtueshmëri, sipas zgjedhjes së Koncessionarit, me (i) Standartet Gjermane ose (ii) Standartet e Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC), me kusht që çdonjëri nga këto standarde i përzgjedhur nga Koncessionari do të janë në pajtim me Praktikën e Industrisë së Mirë, përvèç kur Palët bien dakord ndryshe.

7.3.2 Pa rënë ndesh me ndonjë garanci sipas Ligjit Shqiptar, Punimet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë në masën që lidhet me Projekt-Idenë) do të mbulohen me një garanci dhjetë (10) vjeçare nga Koncessionari për punimet civile kundër defekteve të fshehta që nga Data Faktike e Përfundimit të Punimeve, si dhe gjithashtu me një detyrim një (1) vjeçar të Koncessionarit për të ndrejur çdo defekt *patente* ose të dukshëm ose çdo papajtueshmëri me të gjitha rrethanat e tjera, duke filluar gjithashtu që nga Data Faktike e Përfundimit të Punimeve.

7.3.3 Çdo material ndërtimi i nxjerrë në Shesh nga Koncessionari mund të përdoret nga Koncessionari pa pagesë. Megjithatë nëse Koncessionari ka nevojë të nxjerrë ndonjë material ndërtimi jashtë Sheshit për ta përdorur në Projekt, duhet ta bëjë këtë në përputhje me Ligjin dhe pasi të ketë marrë lejen e nevojshme. Për të hequr çdo dyshim, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër të sigurojë përdorimin falas të materialeve të ndërtimit të gërmuara jashtë kufijve të Sheshit.

8. SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E KOMPLEKSIT

8.1 Detyrimet e Konçesionarit

Që nga Data e Hyrjes në Fuqi, dhe pa përgashtuar detyrimet e Koncessionarit sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energiisë, Koncessionarit do t'i kërkohet:

(a) të ushtrojë të gjitha të Drejtat Koncesionare në përputhje me Praktikën e Industrisë së Mirë, si dhe në përputhje me Kërkesat Teknikë Minimale;

(b) tē përgatitë një manual inspektimi dhe mirëmbajtjeje dhe t'ia paraqesë atë për miratim Autoritetit Kontraktues brenda tre (3) muajive pas fillimit të Fazës së Shfrytëzimit; dbe

(c) t'i japë Autoritetit Kontraktues (i) një kopje të bilanceve financiare vjetore të audituara të Shoqërisë së Projektit, (ii) një raport vjetor për të gjitha punimet mirëmbajtëse të planifikuar ose të paplanifikuar, si dhe (iii) një njoftim për çdo ngjarje të rëndësishme emergjence në lidhje me Projektin, veçanërisht përsa i pérket shëndetit, mjedisit dhe çështjeve të sigurisë. Raporti sipas (i) dhe (ii) duhet të jepet në fund të çdo viti për vitin paraardhës, ndërsa njoftimi sipas (iii) duhet të jepet brenda 10 Ditësh Puna pas ngjarjes.

8.2 Shfrytëzimi dhe Mirëmbajtja – Dëme të Likujdueshme

(a) Përveç ngjarjeve të renditura sipas Nenit 7.2.7 të kësaj Marrëveshjeje (*Rrethana të veçanta - Zgjatja e Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut*), nëse Koncessionari nuk arrin (x) të përbushë ndonjë nga detyrimet e tij të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes, ose (y) të përgatitë manualin e inspektimit dhe të mirëmbajtjes ose t'i përmbahet detyrimi me të tij të parashikuara këtu, në secilin rast siç jepet në Nenin 8.1, Koncessionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues Dëmet e Likujdueshme si më poshtë:

(i) 1,000 Euro për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 1-rë deri në ditën e 25-të të mospërmbushjes;

(ii) 7,500 Euro për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 26-të deri në ditën e 50-të të mospërmbushjes;

(iii) 15,000 Euro për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 51-të deri në ditën e 75-të të mospërmbushjes;

(iv) 22,250 Euro për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 76-të deri në ditën e 100-të të mospërmbushjes;

(v) 30,000 Euro për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 101-të deri në ditën e 125-të të mospërmbushjes;

Për çdo shkelje të veçantë nga Koncessioni sipas Nenit 8.2, shuma totale e Dëmeve të Likujdueshme për Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen, të cilën ka të drejtë ta përfitojë Autoriteti Kontraktues gjatë Fazës së Shfrytëzimit, nuk do ta kalojë shumën prej 1,893,750 Euro (“Tavani Individual i Dëmeve të Likujdueshme për Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen”).

Në lidhje me më shumë se një shkelje të kryer nga Koncessionari sipas Nenit 8.2, shuma totale e Dëmeve të Likujdueshme gjatë Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes, shumë të cilën ka të drejtë ta përfitojë Autoriteti Kontraktues gjatë Fazës së Shfrytëzimit, nuk do ta kalojë 5,681,250 Euro ("Tavani Përbledhës i Dëmeve të Likujdueshme gjatë Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes").

(b) Marrja e Dëmeve të Likujdueshme nga Autoriteti Kontraktues nuk i heq të drejtën lëtij Autoriteti t'i (i) njoftojë Koncessionarit për ekzistencën e Rastit të Mospërmbushjes nga Koncessionari, dhe (ii) t'i japë një Njoftim për Zgjidhje Koncessionarit nëse nuk është përbushur ky Rast Mospërmbus, joje, siç parashikohet më tej në Nenin 11.2.1 (*Zgjidhja e Marrëveshjes së Koncessionit*).

(c) Çdo pagesë e Dëmeve të Likujdueshme gjatë Fazës së Shfrytëzimit do t'i bëhet Autoritetit Kontraktues nga Koncessionari brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njohimit të Autoritetit Kontrollues nga Koncessionari, ku jepen shumat e Dëmeve të Likujdueshme, të cilat bëhen më pas të c'z rueshme për t'u paguar. Nëse Koncessionari nuk arrin të paguajë Dëme të tula të Likujdueshme kurrë këto bëhen detyrueshme për t'u paguar, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të marr çdo shumë ose shuma nga Garancia e Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes. Për aq sa detyrimi i Koncessionarit për këto Dëme të Likujdueshme e kalon shumën e Garancië së Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes, Koncessionari do të jetë i detyruar t'i bëj pagesa në lidhje me to.

drejtpërdrejt Autoritetit Kontraktues sipas kërkesës së këtij.

(d) Pavarësisht nga Neni 11.1.1(d), por pa përjashtuar zbatimin e paragrafit (e) të këtij Neni, çdo shumë e paguar nga Koncessionari te Autoriteti Kontraktues si Dëm i Likujdueshëm do të përbëjë kompensim të vetëm dhe ekskulziv (duke përfshirë, për të hequr çdo dyshim, rastin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje sipas Nenit 11.1.1(d)) për Autoritetin Kontraktues për raste të tilla, dhe do të paguhet thjesht si një përllogaritje e humbjes së pësuar nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk do të konsiderohet se përbën në asnje mënyrë një sanksion.

(e) Nëse është arritur, si Tavani Individual i Dëmeve të Likujdueshme në Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje, ashtu dhe Tavani i Përmbledhur i Dëmeve të Likujdueshme në Shfrytëzim dhe Mirëmbajtje, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të zgjidhë Marrëveshjen në bazë të Rastit të Mospërmbushjes nga Koncessionari, e cili nuk e zhvesh Autoritetin Kontraktues nga drejta për të marrë çdo shumë nga Garancia e Shfrytëzimit dhe e Mirëmbajtjes, për t'u paguar deri në atë kohë, për të mbuluar dëmet. Kjo e drejtë nuk e zhvesh Autoritetin Kontraktues edhe nga e drejta për të kërkuar zhëdëmtimin e dëmeve përtjerë shumave që merren nga Garancia e Kontratës. Çdo shumë që paguhet si Dëm i Likujdueshëm do t'i kreditohet shumave që kërkohen për dëme të tilla.

8.3 Shërbimet Publike

Koncessionari do të marrë vetë masat përfundimtarë me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimin me energji elektrike, si dhe marrë përsipër dhe do të përballojë të gjitha kostot, shpenzimet dhe detyrimet në lidhje me to. Autoriteti Kontraktues do t'i japë Koncessionarit ndihmë të arsyeshme në lidhje me çdo marrëdhënie të tij me Entitetet Shtetërore përgjegjëse përfundimtarë me nevojshme në Projekt.

9. SIGURACIONI

Koncessionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkua e ushtrimit e Drejtave Koncessionare dhe përdorimin e Objekteve Ekzistuese në përpunim me Praktikën e Industrisë së Mirë, dhe do t'i përcjellë ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuarat e çdo certifikatë sigurimi pas marrjes së një njoftimi të arsyeshëm paraprak prej Autoritetit.

10. FORCA MADHORE DHE VEPRIMI SHTETËROR THELBËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME MARRËVESHJEN

10.1 Forca Madhore

10.1.1 “Rast i Forcës Madhore” do të thotë çdo rrethanë që nuk është në mënyrë të arsyeshme në kontroll, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së Cënuar (“Pala e Cënuar”) që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesëshme të Palës së Cënuar përfundimtarë e përbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

(i) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shkaktoj ose mënjanohet nga Pala e Cënuar;

(ii) Pala e Cënuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shkaktojë pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cënuar përfundimtarë e përbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe përfundimtarë e zbutur pasojat e saj;

(iii) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të një prej detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

(iv) Pala e Cënuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër (“Pala e Pacënuar”).

10.1.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më sipër:

(i) veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

(ii) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizmit;

(iii) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

(iv) epidemja ose murtaja; dhe

(v) çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (sidoqoftë duke përjashtuar punonjësit e Palës që e pretendon atë si Rast të Forcës Madhore ose punonjësit e ndonjë prej aksionerëve të kësaj Pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga shoqëria mëmë ose degë e ndonjë aksionari të kësaj Pale).

Pala e Cënuar do të përjashtohet nga përbushja e detyimeve, dhe nuk do të quhet se është në mospërbushje në lidhje Marrëveshjen e Koncessionit për aq kohë, dhe në atë masë, sa pamundësia për të përbushur detyrimet të varet nga Ngjarja e Forcës Madhore, si dhe Afati do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

10.1.3 Pasojat e Rasteve të Forcës Madhore

Pavarësisht nga detyrimet për mirëmbajtje të Koncessionarit, siç detajohen më tej në Nenin 2.1 (“*Dhënia e të Drejtave Koncessionare*”), rastet e mëposhtme do të zbatohen në masën që Koncessionari është Palë e Cënuar në një Rast të Forcës Madhore:

(i) Rastet e Forcës Madhore të Siguruar

Në masën që Pasojat e një Rasti të Forcës Madhore janë brenda kushteve që mbulohen nga garancitë siguruese që kërkohet të bëhet e të mbahet sipas Nenit 9 (*Siguracioni*) (“**Rast i Forcës Madhore të Siguruar**”), Koncessionari do të ngrejë pretendime e bazojë ato drejtpërdrejt tek ky Nen dhe do të zbatojë procedimet përkatëse.

Nëse një Rast i Forcës Madhore shkatërron të gjithë ose pjesërisht Hidrocentralin, Koncessionari, përvèç rastit të parshikuar në nënparagrafin (ii) këtu më poshtë, e riparon ose e rivendos Hidrocentralin në kushte pune me qëllim që të arrijë Kërkесat Teknikë Minimale.

(ii) Rastet e Forcës Madhore të Pasiguruar

Rastet që vijojnë të Forcës Madhore do të konsiderohen se përbëjnë “**Rastin e Forcës Madhore të Pasiguruar**”:

(x) çdo Forcë Madhore që nuk përbën Rast të Forcës Madhore të Siguruar; ose

(y) çdo Rast i Forcës Madhore të Siguruar, për të cilën garancitë siguruese janë materialisht të pamjaftueshme për të riparuar ose rivendosur Hidrocentralin në kushte pune me qëllim që të arrijë Kërkесat Teknikë Minimale.

Autoriteti Kontraktues do të zhđëmtojë dhe nuk do ta bëjë Koncessionarin përgjegjës në lidhje me çdo dëmtim, kosto, shpenzim ose detyrim që (i) lind ose rezulton nga fakti që Autoriteti Kontraktues nuk arrin të mirëmbajë siç duhet dhe në çdo kohë Strukturën e Sipërme të Urës, (ii) që lind ose rezulton nga pretendimet e një pale të tretë në lidhje me ose që buron nga Struktura e Sipërme e Urës, ose (iii) ose shkaktuar ndryshe nga Struktura e Sipërme e Urës ose në lidhje me të.

Pa kufizuar në përgjithësi sa më sipër, nëse në çdo kohë Koncessionari vendos, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, se Struktura e Sipërme e Urës nuk po mirëmbahet si duhet dhe se një mosmirëmbajtje e tillë në mënyrë thelbësore cenon Projektin (ose ka të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të cenojë në mënyrë thelbësore Projektin), Koncessionari njofton Autoritetin Kontraktues menjëherë për këtë dhe i jep detaje të arsyeshme në lidhje me këtë mirëmbajtje të papërshtatshme dhe efektin e saj thelbësisht cenes ndaj Projektit.

Me marrjen e njoftimit të Koncessionarit siç u përmend, Autoriteti Kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur sipas rrethanave, do të sigurojë ose do të marrë masat që të sigurojë mirëmbajtjen e kërkuar dhe/ose riparimet në Strukturën e Sipërme të Urës pa asnjë pagesë nga ana e Koncessionarit; në rast se kjo nuk realizohet nga Autoriteti Kontraktues, Koncessionari do të ketë të drejtë të procedojë me punimet përkatëse mirëmbajtëse dhe riparuese. Autoriteti Kontraktues do të rimbursojë Koncessionarin për të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera nga Koncessionari në lidhje me këtë mirëmbajtje dhe/ose riparime të tillë, duke përfshirë çdo pretendim nga palët e treta në lidhje me to (me përjashtim të rastit të neglizhencës së rëndë, një veprimi të papranueshëm të qëllimshëm, ose mashtrimi).

14.5 Shlyerjet dhe Kundërp pretendimet

Secila Palë ka të drejtë të shlyejë ose kompensojë çdo shumë të pagueshme, detyrim ose Pretendim sipas kësaj Marrëveshjeje me çdo shume të pagueshme, detyrim ose Pretendim të Palës tjetër.

Për heqjen e çdo dyshimi, Autoriteti Kontraktues mund të shlyejë ose kompensojë pagesat e zgjidhjes sipas Nenit 11.3 me çdo Pretendim kundër Koncessionarit.

14.6 Heqja dorë nga Imuniteti Shtetëror

Autoriteti Kontraktues, si një Entitet Shtetëror, heq dorë në mënyrë të parevokueshme, si përsa i përket vetes ashtu edhe pasurive të tij, nga të drejtat e tij për të pretenduar ndonjë imunitet shtetëror (në çfarëdo lloj juridikzioni), duke përfshirë por pa u kufizuar në imunitetin nga juridiksioni, zbatimi i detyrueshëm, vendimet gjyqësore, urdhrat për sigurimet e padive, ose nga masa të tjera parandaluese ose mbrojtëse (duke përfshirë por pa u kufizuar në ndonjë vendim të dhënë nga një gjykatë arbitrazhi) dhe nga të gjitha lehtësitë dhe Procedurat e tjera ligjore, si dhe nga çdo imunitet për ndonjë pronë të tij, nga ekzekutimi, si dhe jep pëlqimin për procedime dhe lehtësira të tillë.

14.7 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të lidhet dhe zbatohet në gjuhën angleze dhe Koncessionari do të sigurojë një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më shpejt të jetë e mundur pas nënshkrimit të saj. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni i gjuhës angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe. Çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë në Anglisht ose Shqip (së bashku me përkthimin në Anglisht, kur është e mundur).

14.8 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

14.9 Nënkontraktorët

Koncessionari ka të drejtë të lidhë kontrata me nënkontraktor(ë) për të ushtruar disa nga të Drejtat Koncessionare, me miratim të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues, i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme nëse nënkontraktori i propozuar zotëron aftësitë, reputacionin dhe burimet e mjta tueshme në rrethanat përmarrë përsipër këto detyrime (dhe çdo marrëveshje nënkontraktore e lidhur nga Koncessionari pa këtë miratim të Autoritetit Kontraktues do të konsiderohet se është një Rast Mospërbmbushjeje nga Koncessionari), me kusht që, sidoqoftë, miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues nuk do të kërkohet në lidhje (i) me çdo nënkontraktor të njohur ndërkombëtar me reputacion të mirë, dhe (ii) me çdo nënkontraktor, shuma e angazhuar për të cilin është më e vogël se 300.000 Euro (në baza individuale ose përbledhëse nëse disa nënkontraktorë janë të lidhur në thelb me të njëjtin transaksion).

14.10 Përgjegjësia e Koncessionarit – Palët e Lidhura me të

Koncessionari do të jetë përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për ndonjë veprim ose mosveprim të tij, si dhe për çdo veprim ose mosveprim sipas Marrëveshjes së Ndërtimit dhe Marrëveshjes së Shfrytëzimit dhe Mirëmbajtjes ose përmarrës prej palëve përkatëse në lidhje me përbushjen e kësaj Marrëveshjeje, si dhe në përputhje me Ligjin Shqiptar.

14.11 Pozita e Autoritetit Kontraktues si Autoritet Shtetëror

Për të hequr çdo dyshim, kjo Marrëveshje nuk kufizon ose nuk cenon në forma të tjera diskrecionin e Autoritetit Kontraktues për të përdorur kompetencat e tij ligjore dhe rregullatore, me kusht që, sidoqoftë, këto kompetenca të ushtrohen në përputhje me Ligjin Shqiptar.

14.12 Fosilet dhe Sendet Antike

14.12.1 Pa rënë ndesh me të drejtat e Koncessionarit për ndonjë zgjatje të Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut në përputhje me Nenin 7.2.7, Koncessionari, me zbulimin ose kur ekziston dyshimi i zbulimit të ndonjë fosili ose sendi antik (në Shesh dhe jashtë Sheshit), do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues se do të ndërpresë Punimet në Shesh.

14.12.2 Me marrjen e njoftimit të Koncessionarit, Autoriteti Kontraktues do të informojë Autoritetet Shqiptare për të koordinuar kërkimet në Shesh përmes fosile ose sende antike.

14.12.3 Në rast se raporti i Autoritetet Shqiptare shprehet përmundësinë e heqjes nga Sheshi të sendeve antike ose fosileve, Autoriteti Kontraktues do të paguajë të gjithë koston e zhvendosjes së fosileve ose të sendeve antike.

14.12.4 Në rast se raporti me shkrim i Autoritetet Shqiptare shprehet se ndërtimi në Shesh nuk mund të vazhdojë, Autoriteti Kontraktues mund të zgjedhë t'i sigurojë Koncessionarin një shesh tjetër gjëografikisht të krahasueshëm me sipërtaqe të ngashme ("Sheshi Zëvendësues") dhe Autoriteti Kontraktues do të paguajë koston e transferimit të Punimeve në Sheshin Zëvendësues, me kusht që, sidoqoftë, Koncessionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjithë ndihmën e nevojshme Autoritetit Kontraktues përmes minimizuar koston dhe vonesat përkatëse.

14.13 Njoftimet

14.13.1 Pa cenuar Nenin 13.3 (Arbitrazhi) më sipër, çdo njoftim ose komunikim tjetër nga Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitive të kësaj Marrëveshjeje do të: (i) bëhet me shkrim; (ii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagum ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, ose do të dërgohet me faks (ne fletën konfirmuese të dërgimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, i cili është

paraqitur më poshtë ose në një numër tjetër faksi siç mund ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër; dhe (iii) shënohet në vemandje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose te ai/ata person(a) që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.

14.13.2 Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër, nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë te adresa e palës tjetër më poshtë (siç mund të ndryshohet herë pas herë pas njoftimit të arsyeshëm nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër.

Autoriteti Kontraktues:

Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjistikës
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2

Tirana Albania
Attn: Shkëlqesisë së Tij, Ministrit

Koncessionari;
Österreichische Elektrizitätséirtschafts – Aktiengesellschaft
Am Hof 6a
1011 Vienna, Austria

14.14 Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje

Nëse ndonjë kusht ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, një gjë e tillë nuk do të ndikojë në dispozitat e tjera të Marrëveshjes.

14.15 Garanci të Mëtejshme

Palët në çdo kohë do të kryejnë të gjitha veprimet e mëtejshme dhe do të nënshkruajnë e dërgojnë këto akte dhe dokumente të mëtejshme, siç do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të zbatohen dhe përmbushen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

14.16 Marrëveshja e Plotë

Kjo Marrëveshje, përfshirë Deklaratën Hyrëse dhe Shtojcat bashkëngjitur kësaj, përfaqëson marrëveshjen e plotë të lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me Projektin e Hidrocentralit Ashta dhe zëvendëson secilën dhe të gjitha marrëveshjet ose rregullimet e mëparshme, qofshin verbale ose me shkrim, ndërmjet po këtyre Palëve në lidhje me këtë hidrocentral dhe me të gjithë përbajtjen e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë çdo marrëveshje ose shkëmbim informacioni në lidhje me tenderin e Projektit).

14.17 Mos-heqja Dorë

Nuk do të konsiderohet se është hequr dorë nga ndonjë Palë prej ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, përvèç kur një dorëheqje e tillë është bërë shprehimisht me shkrim. Mosbërtja e përpjekjeve nga secila Palë për të përbushur saktësisht secilën prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për të përfituar nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si dorëheqje nga një dispozitë e tillë ose nga këto drejta në të ardhmen.

Kjo Marrëveshje Koncessioni është nënshkuar nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve këtu, në datën, muajin dhe vitin e shkuar më sipër.

**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Nga: _____
Emri: _____
Funksioni: _____

ÖSTERREICHISCHE ELEKTRIZITÄTSÉIRTSCHAFTS -AKTIENGESELLSCHAFT

Nga: _____
Emri: _____
Funksioni: _____

**SHTOJCA A
MARRËVESHJA E SHITJES SË ENRGJISË**

SHTOJCA B
KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE

Numri i Kërkесës	Titulli i Kërkесës	Përshkrimi i Verbund
1	Numri Maksimal i Stacioneve të Energjisë	Dy stacione energjie
2	Kapaciteti Minimal i Instaluar	48.2 MW (shih Nenin 7.2.19)
3	Vendndodhja e Objekteve të Energjisë	Centrali elektrik, kanalet rrjedhëse dhe të gjitha objektet e tjera ndodhen në bregun e majtë të lumit Drin.
4	Niveli Normal i Rezervuarit të Spatharës	Niveli normal i ujit në rezervuarin e Spatharës do të jetë 23m MND, i cili mund të rritet deri në 27 m MND, në veçanti në rastin kur HEC Vau i Dejës punon me kapacitet të plotë.
5	Portat e Shkarkimit	Niveli i rezervuarit të Spatharës mund të rritet duke instaluar porta të lëvizshme shkarkimi.
6	Niveli Maksimal i Rezervuarit të Spatharës	Niveli maksimal i ujit në rezervuarin e Spatharës asnjëherë nuk do të lejohet të kalojë 27 Mmnd në mënyrë që të shmangen përmbytjet e tokave përreth dhe vënia në rezik e urës.
7	Tipi i Elementëve të Turbinave	StrafloMatrix
8	Grafiku i Zbatimit	Periudha totale nga Fillimi i Fazës së Ndërtimit deri në Datën e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut nuk do të kalojë dyzet (40) muaj.

SHTOJCA C
FORMAT E GARANCISË SË KONTRATËS
GARANCIA E NDËRTIMIT

[Emri i Ofertuesit]
Letra e Garancisë Nr.: []

[Data]

Përderisa ju keni lidhur me klientët tanë [] ("Koncessionarin") një marrëveshje koncesioni që lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti hidrocentrali të ri në Ashta, në Republikën e Shqipërisë ("Marrëveshja e Koncesionit"):

Ne, [] ("Banka"), me anë të kësaj letre marrim përsipër në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme t'ju paguajmë çdo shumë deri në vlerën e 16,000,000 Euro (gjashtëmbëdhjetë milion) ("Shuma Maksimale"), në lidhje me detyrimet e Koncessionarit sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përputhje me sa më poshtë:

(A) Ne do t'ju paguajmë menjëherë pas kërkesës suaj me shkrim dhe pavarësisht çdo kundërshtimi nga Koncessionari ose ndonjë palë tjetër, këtë shumë ose shumat sipas kërkesës suaj deri në Shumën Maksimale;

(B) Të gjitha pagesat e bëra pas kërkesës suaj do të jenë të plota, duke mos u bërë ndonjë zbritje nga pagesa, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, për pagimin e ndonjë takse, detyrimi, tatimi, pagesë të detyrueshme, tarife, zbritje ose pagesa të mbajtura të çfarëdolloj natyre dhe të vendosura nga cilido;

(C) Angazhimet e marra në këtë garanci përbëjnë detyrimet tona të drejtpërdrejta dhe thelbësore dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme. Nuk do të përjashtohemi nga ndonjë ose nga të gjitha këto detyrime për asnjë arsy të çfarëdolloj natyre ose shkaku, të tillë si ndryshimi në kushtet e kontratës ose zgjatjes së saj ose ndryshimit në qëllimin ose natyrën e punës që do të kryhet, ose ndonjë mosveprim ose veprim i kryer nga ju ose nga ndonjë palë e tretë e cila do të na përjashtonte ose shkarkonte nga detyrimi dhe përgjegjësitet e shprehura në këtë garanci;

(D) Kjo garanci do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi dhe me pasoja deri në mbarim të datës _____ muaji _____ i vitit _____ [dmth, një (1) vit nga data e lëshimit]; dhe

(E) Kjo garanci do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë garanci do të zgjidhet nga gjykata kompetente Shqiptare.

Banka

[Nënshkruesit e Autorizuar]

GARANCIA E SHFRYTËZIMIT DHE MIRËMBAJTJES

[Emri i Ofertuesit]
Letra e Garancisë Nr.: []

[Data]

Përderisa ju u keni lidhur me klientët tanë [] ("Koncessionarin") një marrëveshje koncesioni që lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti hidrocentrali të ri në Ashta, në Republikën e Shqipërisë ("Marrëveshja e Koncesionit"):

Ne, [] ("Banka"), me anë të kësaj letre marrim përsipër në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme t'ju paguajmë çdo shumë deri në vlerën e [] ("Shuma Maksimale"), e cila korrespondon me pesë përqind (5%) të vlerës së planifikuar të Punimeve të Ndërtimit (siç është parashikuar në Marrëveshjen e Koncesionit), në lidhje me detyrimet e Koncessionarit sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përputhje me sa më poshtë:

(A) Ne do t'iu paguajmë menjëherë pas kërkesës suaj me shkrim dhe pavarësisht çdo kundërshtimi nga Koncessionari ose ndonjë palë tjetër, këtë shumë ose shuma sipas kërkesës suaj deri në Shumën Maksimale;

(B) Të gjitha pagesat e bëra pas kërkesës suaj do të jenë të plota, duke mos u bërë ndonjë zbritje nga pagesa, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen për pagimin e ndonjë takse, detyrimi, tatimi, pagesë të detyrueshme, tarife, zbritje ose pagesa të mbajtura të çfarëdolloj natyre dhe të vendosura nga cilido;

(C) Angazhimet e marra në këtë garanci përbëjnë detyrimet tonë të drejtpërdrejta dhe thelbësore dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme. Nuk do të përjashtohemi nga ndonjë ose nga të gjitha këto detyrime për asnjë arsyë të çfarëdolloj natyre ose shkaku, të tillë si ndryshimi në kushtet e kontratës ose zgjatjes së saj ose ndryshimit në qëllimin ose natyrën e punës që do të kryhet, ose ndonjë mosveprim ose veprim i kryer nga ju ose nga ndonjë palë e tretë e cila do të na përjashtonte ose shkarkonte nga detyrimi dhe përgjegjësitë e shprehura në këtë garanci;

(D) Kjo garanci do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi dhe me pasoja deri në mbarim të datës _____ muaji _____ i vitit _____ [dmth, tre (3) vjet nga data e lëshimit]; dhe

(E) Kjo garanci do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë garanci do të zgjidhet nga gjykata kompetente Shqiptare.

Banka

[Nënshkruesit e Autorizuar]
GARANCIA E DOREZIMIT

[Emri i Ofertuesit]

[Data]

Letra e Garancisë Nr.: []

Përderisa ju keni lidhur me klientët tanë [] ("Koncessionarin") një marrëveshje koncesioniqë lidhet me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti hidrocentrali të ri në Ashta, në Republikën e Shqipërisë ("Marrëveshja e Koncesionit"):

Ne, [] ("Banka"), me anë të kësaj letre marrim përsipër në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme t'ju paguajmë çdo shumë deri në vlerën e [] ("Shuma Maksimale"), e cila korrespondon me dy përqind (2%) të vlerës së planifikuar të Punimeve të Ndërtimit (siç është parashikuar në Marrëveshjen e Koncesionit), në lidhje me detyrimet e Koncessionarit sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përputhje me sa më poshtë:

(A) Ne do t'ju paguajmë menjëherë pas kërkesës suaj me shkrim dhe pavarësisht çdo kundërshtimi nga Koncessionari ose ndonjë palë tjetër, këtë shumë ose shumat sipas kërkesës suaj deri në Shumën Maksimale;

(B) Të gjitha pagesat e bëra pas kërkesës suaj do të jenë të plota, duke mos u bërë ndonjë zbritje nga pagesa, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen për pagimin e ndonjë takse, detyrimi, tatimi, pagesë të detyrueshme, tarife, zbritje ose pagesa të mbajtura të çfarëdolloj natyre dhe të vendosura nga cilido;

(C) Angazhimet e marra në këtë garanci përbëjnë detyrimet tonë të drejtpërdrejta dhe thelbësore dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme. Nuk do të përjashtohemi nga ndonjë ose nga të gjitha këto detyrime për asnjë arsyë të çfarëdolloj natyre ose shkaku, të tillë si ndryshimi në kushtet e kontratës ose zgjatjes së saj ose ndryshimit në qëllimin ose natyrën e punës që do të kryhet, ose ndonjë mosveprim ose veprim i kryer nga ju ose nga ndonjë palë e tretë e cila do të na përjashtonte ose shkarkonte nga detyrimi dhe përgjegjësitë e shprehura në këtë garanci;

(D) Kjo garanci do të mbetet e vlefshme dhe në fuqi dhe me pasoja deri në mbarim të datës _____ muaji _____ i vitit _____ [dmth, një (1) vit nga data e lëshimit]; dhe

(E) Kjo garanci do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë garanci do të zgjidhet nga gjykata kompetente Shqiptare.


Banka


[Nënshkruesit e Autorizuar]

SHTOJCA D
HARTA E SHESHIT


[siç është paraqitur në Ofertën Teknike, harta Nr. AL/AS/B/0/0001]

SHTOJCA E
HARTA E SHESHIT ME OBJEKTET EKZISTUESE TË EVIDENTUARA





SILVER BRIDGE
CHIPPING FACILITIES IN STRUCTURE



8065

SHTOJCA F
PROCEDURA TREGUESE E SHPRONËSIMIT

Procedura e mëposhtme e shpronësimit e paraqitur nga Autoriteti Kontraktues është përshkruese, jo detyruese dhe jepet vetëm për qëllime informimi. Koncessionari do të mbështetet vetëm në përpjekjet e veta të kujdeshme dhe të nevojshme dhe/ose në asistencën nga këshilltarët ligjorë shqiptarë në mënyrë që të bëjë ndonjë përcaktim sa i përket natyrës së saktë dhe qëllimit të ndonjë kërkese shpronësimi.

(Në mbështetje të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë, Pronë Private për Interesin Publik", këtej e tutje "Ligji")

• Shpronësimi ushtrohet vetëm për interes publik i cili nuk mund të realizohet ose mbrohet në ndonjë mënyrë tjetër. (Dmth, në këtë rast për realizimin e projekteve dhe investimeve që përfaqësojnë shtrirjen territoriale kombëtare ose lokale ose interesin në energji.)

• Si subjekti privat ashtu edhe pala e interesuar i paraqet një kërkесë për shpronësim Këshillit të Ministrave, i cili më pas me propozimin e ministrit, i cili është kompetent sipas Ligjit, vendos mbi shpronësimin. Kur shpronësimi bëhet pas kërkесës së një individi/entiteti privat ministri kompetent në statusin e përfaqësuesit të pronës shtetërore, është i autorizuar nga Ligji, që mbi bazën e kërkесës paraprake të subjektit, të bëjë transfertën e pronave të shpronësuara në favor të subjektit privat i cili që në fillim ka aplikuar për të, me kusht që të provohet realizimi i ndërtimit ose investimi në interes publik. Nëse subjekti privat nuk kërkon transferimin e pronës ajo mbetet në favor të shtetit.

• Personi i interesuar i paraqet kërkесën ministrisë përgjegjëse për aktivitetin respektiv, me dokumente bashkëlidhur, dokumentet të cilat janë listuar në Nenin 10 të Ligjit.

• Në ministrinë përkatëse të linjës është krijuar një Komision i Posaçëm për shpronësimet. Kur ministria, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm, është e bindur se dokumentet janë përgatitur në bazë të ligjit dhe vendimeve qeveritare, ajo vendos të pranojë kërkесën për shpronësimin dhe njofton personin që ka bërë kërkесën.

• Brenda 10 ditëve nga ky njoftim është parashikuar të lidhet një marrëveshje ndërmjet Ministrisë dhe personit i cli ka bërë kërkесën.

• Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, Ministria fillon procedurat sa i përket pronarëve të pronave të prekura. Ndërkohë publikohet një njoftim publik në një gazetë zyrtare dhe në gazetat kombëtare dhe lokale që gjëzojnë reputacion të mirë. Këto njoftime publikohen një javë rresht.

• Një muaj pas datës së fundit të publikimit, ministria i paraqet Qeverisë propozimin për shpronësim, në mënyrë që të marrë vendimin final.

• Brenda periudhës nga 15 ditë deri në 1 muaj pronari dhe ministria kompetente do të përfundojnë transferimin e akteve të pronësisë.

• Pronat e Shpronësuara duhet të regjistrohen brenda 30 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Ministrave.

• Subjekti në dobi të të cilët është bërë shpronësimi i paraqet ministrisë që është kompetente në bazë të ligjit kërkесën për shpronësim. Kërkesa do të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- Dokumentet zyrtare që vërtetojnë statusin dhe regjistrimin e tij si person juridik.

- Projektimet e nevojshme, të miratuarë sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore mbi interesin publik që lidhet me realizimin e këtyre projekteve.

- Dokumentacionin që lidhet me burimin dhe garancinë e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë ato për shpronësimin ose për shkak të zhvlerësimit.

- Një vlerësim paraprak të objekteve të shpronësimit dhe shumën e kompensimit që parashikohet për çdo pronar privat.

- Licencat dhe lejet e nevojshme të organeve kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet.

Dokumentet zyrtare që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit nga kërkuesi i shpronësimit.

- Një listë të pronarëve të pronave private, për të cilat kërkohet shpronësimi; një listë të pronarëve të pronave private që janë zhvlerësuar për shkak të shpronësimit dhe një listë të palëve të treta të cilat duhet të kompensohen për të drejtat e tyre në pronat private që kërkohet të shpronësohen, bashkë me shpjegimet dhe të dhënrat e nevojshme për secilën prej tyre, me përllogaritjet përkatëse të vlerës së këtyre pronave dhe të drejtave, si dhe adresat dhe rezidencat e fundit të njoitura të pronarëve përkatës dhe personave të tretë.

(Shënim: ekzistojnë rregullore të detajuara mbi përbajtjen dhe standartet që do të ruhen në përpilimin dhe paraqitjen e dokumenteve.)

- Njoftimi Publik – 10 ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë dhe personit që ka bërë kërkesën, Ministria fillon procedurën që lidhet me pronarët e pronave të prekura. Ndërkohë do të botohet një javë rresht një njoftim publik në gazetat zyrtare.

- Përcaktimi i Vlerës së Truallit – mesatarja e çmimit të shitjeve në rajon i cili është i regjistruar në Zyrën e Registrimit të Pronave të Paluajtshme (ZRPP). Vlerësimi do të bëhet mbi bazën e jo më shumë se 3 muajve nga data e kërkesës së zyrës për shpronësim. Nëse nuk ka pasur asnjë kontratë shitjeje në atë periudhë Komisioni i Posacëm fikson çmimin bazuar në rregullat e përshkruara në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.03.2000, “Për Kriteret Teknikë të Vlerësimit dhe të Përllogaritjes së Masës së Shpërbimit të Pasurive Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik”. Çmimi i vendosur sipas këtij vendimi mund të kundërshtohet dhe pronarët kanë të drejtë të kërkojnë ripërcaktimin nga gjykata të kompensimit – megjithatë kjo nuk çon në ndërprerjen e procedurave të shpronësimit.

SHTOJCA G KOMISIONIMI DHE PROCEDURAT TESTUESE

1. Të përgjithshme

Në mënyrë që të garantohet se janë arritur parametrat teknikë, standartet e cilësisë dhe Kapaciteti i Propozuar, gjatë fazave të ndryshme të Fazës së Ndërtimit do të kryhen një sërë testimesh:

1.1 Ndërtimi civil

Kjo Shtoje është përpiluar në mënyrë të veçantë për sa i përket procedurave të komisionimit, funksionimit dhe testuese për Objektin Elektromekanik dhe në këtë Shtoje nuk është përfshirë asnjë procedurë e veçantë sa i përket ndërtimit civil.

Gjatë Fazës së Ndërtimit Koncessionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë pa kufizim çdo raport testimi) lidhur me komisionimin dhe testimini e punëve civile të cilat Koncessionari i ka marrë nga kontraktori i tij gjatë procedurës së komisionimit dhe testuese sa i përket këtyre punëve civile. Brenda dhjetë (10) Ditë Pune pas marrjes së këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Koncessionarin me shkrim, nëse ai kundërshton të pranojë ndonjë rezultat që përbahet në këtë dokumentacion. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e kundërshton këtë, çdo pranim me shkrim i dërguar nga Autoriteti Kontraktues te Koncessionari në përputhje me këtë Shtoje, në veçanti pranimi se është kryer Përfundimi Thelbësor, do të konsiderohet se përfshin ndërtimin civil.

1.2 Testet Fillestare në Objektin Elektromekanik

- Testet Para Komisionimit (testet pa ngarkesë)
- Testet e Komisionimit (testet me ngarkesë)

1.3 Testet e Funksionimit

- Test Kapaciteti

Koncessionari do të paraqesë një program të plotë Testimi të Funksionimit të hollësishëm para se të kryej këtë test, në përputhje me Praktikat e Industrisë së Mirë, i cili do të përbajë:

- Një tregues të datës, orës dhe kohëzgjatjes së testeve
- Procedurën e detauar të testeve

- Kriterin e suksesit ose dështimit të testeve
- Sistemin e dokumentimit të rezultateve të testeve

Para dhe gjatë periudhës së testimeve, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë të gjithë informacionin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Koncessionari për të lehtësuar zhvillimin e procedurave testuese.

1.4 Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues

Nëse kërkohet nga secila nga palët dhe në bazë të një njoftimi të arsyeshëm, Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues do të marrë pjesë në testimet sipas Nenit 1.2 dhe 1.3 më sipër (me shpenzimet e Palës që e ka kërkuar këtë).

2 Testet Fillore dhe Përfundimi Mekanik

2.1 Testet Para Komisionimit (Testet pa ngarkesë)

2.1.1 Të përgjithshme

Testet para komisionimit, gjatë dhe pas përfundimit të montimit (referuar gjithashtu si testet pa ngarkesë) do të përfshijnë inspektimet dhe testet e duhura për të treguar se çdo element i punimeve është montuar në mënyrë të saktë dhe mund të kalohet pa ndonjë rrezik në fazën tjetër të testeve të komisionimit.

Koncessionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues tre (3) kopje të raportit përfundimtar për të gjitha testet para komisionimit.

2.1.2 Kontrolli i Sistemeve Mekanike

Koncessionari do të kryejë testet e mëposhtme:

- (a) Rrotullimin mekanik (manual) të çdo elementi të gjeneratorit të turbinave ("TG-Unit")
- (b) Portat e Tubacioneve të shkarkimit, duke përfshirë sistemet hidraulike
- (c) Funksionimi i sistemit të nxehjes-ventilimit-ajrit të kondicionuar (HVAC) dhe sistemit të paralajmërimit të zjarrit.

2.1.3 Pajisjet Elektrike

2.1.3.1 Testet e Pajisjeve me Tension të Ulët (TU)

Para se sistemet elektrike të ngarkohen me energji, Koncessionari do të kryejë testet elektrike, veçanrisht duke përfshirë sa më poshtë:

- (a) Kontrolli i të gjitha lidhjet fundore elektrike.
- (b) Testi Megger i përcuesve, ushqyesve dhe kabllove; për pajisjet 480 Volt.
- (c) Kontroll i ndërrprerjes së qarkut, i funksionimit mekanik, shtrëngimit të kokave lidhëse, rezistencës së kontaktit dhe siguresave të instakluara; duke regjistruar në mënyrë të saktë pikat e vendosjes së automateve.
- (d) Kontroll i funksionimit të burmave ndërzëse të motorit, kontaktit të qarkut, i shtrëngimit të kokave lidhëse; duke instaluar dhe regjistruar nivelin në amper të të gjitha mbingarkesave termike.
- (e) Të gjitha funksionet e releve mbrojtëse dhe qarqeve komanduese do të kontrollohen nga testimeti e releve me automat duke simuluar rryma në automate me injektim dytësor.

2.1.3.2 Testet e Pajisjeve me Tension të Mesëm (TM)

Si kusht për interkoneksionin me rrjetin e energjisë elektrike, do të kryhen testet e mëposhtme:

- (a) Testet funksionale të të gjitha pajisjeve të kontrollit elektrike dhe të pajisjeve mbrojtëse. Testimi i releve do të kryhet me praninë e përfaqësuesve të OST sh.a.
- (b) Vendasja e releve mbrojtëse.
- (c) Testet e poleve për të gjithë transformatorët e fuqisë ("TF") dhe transformatorët e rrymës ("TR")

2.1.3.3 Testet e Pajisjeve me Tension të Lartë (TL)

Si kusht për interkonjeksionin me rrjetin e energjisë elektrike, do të kryhen testet e mëposhtme:

- (a) Vendasja e releve mbrojtëse.
- (b) Testet e poleve për të gjithë TF-të dhe TR-të

- (c) Kontrolli i montimit të plotë dhe të saktë të të gjitha pajisjeve 110 kV;
- (d) Kontrolli i tokëzimit të duhur të të gjitha pajisjeve 110 kV;
- (e) Verifikimi paraprak i qarqeve të kontrollit, të mbrojtjes, të lidhjes, sinjalizimit dhe të automatëve në prani të përfaqësuesve të OST sh.a.;
- (f) Matja paraprake e rezistencave izoluese;
- (g) Kontrolli i drejtimit të duhur të fazave të sekundës.
- (h) Kontrolli elektrik i duhur i kabllove të të gjitha qarqeve komanduese, matëse dhe të gjenerimit.

2.1.3.4 Transformatorët e Fuqisë

Për të siguruar një procedurë korrekte instalimi dhe për të konfirmuar se e gjithë pajisja e dërguar është përputhur si duhet, gjatë dhe pas përfundimit të montimit, do të kryhen të paktën testet e mëposhtme:

- (a) Kontrolli i montimit të duhur dhe të plotë;
- (b) Kontrolli i kushteve të duhura të izolatorëve prej porcelani, valvulave dhe sipërfaqeve të jashtme;
- (c) Kontrolli i lidhjeve të duhura të sistemit të tokëzimit;
- (d) Kontrolli i lidhjeve shtrënguese të Transformatorëve me anë të çelësit rrrotullues;
- (e) Testi i mbajtjes së tensionit në transformatorët me vaj;
- (f) Kontrolli i drejtimit të duhur të sekundës së fazave;
- (g) Kontrolli paraprak i qarqeve dhe instalimeve elektrike mbrojtëse;
- (h) Matja paraprake e rezistencave izolues me anë të Testit Megger;
- (i) Kontrolli i funksionimit të ventilatorëve.

2.1.3.5 Kontrolli dhe Mbrotja

Duhet të kryhen të paktën inspektimet dhe testet e mëposhtme:

- (a) Kontrolli i instalimit të duhur dhe të plotë të të gjitha dhomave të kontrollit
- (b) Kontrolli i instalimit të duhur dhe të plotë të dhomës së kontrollit të pajisjes Hidro Mekanike
- (c) Kontrolli i të gjitha lidhjeve elektrike dhe interkonjeksioneve me të gjitha pajisjet
- (d) Kontrolli i lidhjeve elektrike dhe interkonjeksioneve me furnizuesin e energjisë dhe sistemet e tokëzimit

2.2 Testet e Komisionimit (Testet me ngarkesë)

Testet e Komisionimit do të kryhen si kusht paraprirës i Përfundimit Mekanik. Do të kryhen një sërë testesh të hollësishme komisionimi (të quajtura gjithashtu testet me ngarkesë) në Objektin Elektromekanik për të demonstruar funksionimin e harmonizuar të të gjithë komponentëve, duke përfshirë interkonjeksionin me rrjetin elektrik të përdorimit, si dhe administrimin e rasteve të veçanta gjatë funksionimit, siç është mos-mbajtja e ngarkesës.

Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues procedurën e propozuar testuese para komisionimit. Koncesionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues tre (3) kopje të raportit përfundimtar të të gjitha testeve komisionuese.

2.2.1 Pajisjet Elektrike

2.2.1.1 Testet e Pajisjeve me Tension të Ulët (TU)

Janë parashikuar testet e mëposhtme:

- (a) Test i tensionit dhe i frekuencës së trymës
- (b) Testi i funksionimit dhe operimit të të gjitha pajisjeve
- (c) Matja e rezistencës së qarqeve kryesor

2.2.1.2 Testet e Pajisjeve në Tension të Mesëm (TM)

Janë parashikuar testet e mëposhtme:

- (a) Test i tensionit dhe frekuencës së rrymës me nivel tensioni 80% të provave me
- (b) Testet e Funksionimit të të gjitha pajisjeve
- (c) Matja e rezistencës së qarqeve kryesore

2.2.1.3 Testet e Pajisjeve në Tension të Lartë (TL)

Për lidhjen me sistemin e energjisë elektrike do të kryhen testet e mëposhtme:

1. *Ndërprerësi i Qarkut*

- (a) Inspektimi i kushteve të përgjithshme;
- (b) Testet Mekanike të funksionimit;
- (c) Testet kohore të kontakteve kryesore dhe të çelësave ndihmës;
- (d) Testet Përfundimtare të funksionimit elektrik;
- (e) Kontrolli i mbylljes dhe hapjes në tension të reduktuar;
- (f) Testet e rrjedhjes së gazit;
- (g) Matja e rezistencës së qarkut kryesor;
- (h) Testet e izolatorëve.

2. *Stakuesit*

- (a) Inspektimi i kushteve të përgjithshme;
- (b) Testet e mbylljes dhe hapjes manuale dhe elektro/mekanike;
- (c) Testet e mbylljes dhe hapjes në tension të reduktuar;
- (d) Kontrolli i kohës së funksionimit;
- (e) Kontrolli dhe verifikimet e lidhjeve.

3. *Transformatori i Rrymës*

- (a) Inspektimi i kushteve të përgjithshme;
- (b) Matja e ngarkesës dhe rezistenca e mbështjellsave sekondarë;

4. *Transformatori i tensionit*

- (a) Inspektimi i kushteve të përgjithshme;
- (b) Testet e rezistencës së tokëzimit dhe ndërmjet mbështjesave parësorë dhe sekondarë;
- (c) Teste pa ngarkesa me aplikim tensioni normal në fundorët elektrike sekondarë për të

paktën 30 minuta;

- (d) Matja e ngarkesës;

5. *Bllokusit e mbingarkesës (automatet)*

- (a) Inspektimi i kushteve të përgjithshme;
- (b) Kontrolli i tokëzimit në rrjetin kryesor të tokëzimit;
- (c) Kontrolli i matësit të mbingarkesë dhe kontrollet e verifikimet e tjera të nevojshme;

6. *Fuqia në tensioni ulët, kabllot e kontrollit dhe të sinjalizimit;*

(a) Kontrollimi i kabllove dhe i telave të rrymës të të gjitha qarqeve të kontrollit, të matjes dhe të fuqiqës;

- (b) Matja e rezistencës së izolatorëve me testin Megger 1000 V.

2.2.1.4 *Transformatorët e Fuqisë*

Do të kryhen testet e mëposhtme:

- (a) Matja e rezistencës së izolatorëve me testin Megger 2500V;
- (b) Matjet e rezistencës së mbështjellsave;
- (c) Matjet e nivelit të tensionit dhe kontrolli i shfazimit;
- (d) Matja e rrymës pa ngarkesë;
- (e) Testet Funksionale të releseë Buchholz (për transformatorët me vaj);
- (f) Testet funksionale të termometrave dhe detektorëve;
- (g) Kontrolli i instalimit të plotë të linjave elektrike; i kontrolli lokal, individual dhe në distancë dhe i sinjalizimit;
- (h) Testet e tensionit të të gjithë qarqeve me tension të ulët;
- (i) Matja e karakteristikave fizike, kimike dhe elektrike të transformatorëve me vaj pas mbushjes së plotë;

(j) Testet e rritjes së temperaturës gjatë shfrytëzimit të vazhdueshëm me parametra të caktuara, duke përfshirë matjet e rritjes së temperaturës së të gjitha pjesëve të rëndësishme të transformatorit, të vajit dhe të ujit ftohës;

2.2.1.5 *Kontrolli dhe Mbrojtja*

Do të kryhen të paktën inspektimet dhe testet e mëposhtme:

- (a) Kontrolli i izolimit të duhur dhe të plotë të pajisjeve;

- (b) kontrolli i lidhjes së plotë dhe të saktë me sistemin e tokëzimit;
- (c) kontrolli i shtrirjes së duhur dhe mbulimit të kabllove, duke përfshirë rrjetin (LAN) e stacionit, rrjetin (LAN) të procesit dhe i monitorimit të kabllove të rrjetit të komunikimit;
- (d) Testet e rezistencës së tensionit në të gjitha qarqet me tension të ulët;
- (e) Testet mbrojtëse të releve;
- (f) Testet Funksionale të pajisjeve të kontrollit, duke përfshirë:
 - i. Testet e moduleve *input/output* të funksionimit
 - ii. Kontrolli i funksionimit të stacioni kryesoreve qendrore
 - iii. Kontrolli i funksionimit të procesit të rrjetit të zonës lokale ("LAN") dhe komunikimi me pajisjet e inteligjencës elektronike ("IEDs");
 - iv. Kontrolli i të gjitha treguesve, i procedurave operuese në të gjitha stacionet e kontrolluesve llogjik të programuar (PLC)
 - v. Kontrolli i të gjitha pajisjeve të sistemeve të kontrollit qendror (kompjuterat dhe pajisjet tjera)
 - vi. Kontrolli i kabllove çift pambështjellëse ("UTP") dhe i komunimit vizual të stacionit LAN (të gjitha njësität e LAN);
 - vii. Kontrolli i të gjitha treguesve, procedurave operuese dhe stacioneve të operatorëve;
 - viii. Kontrolli i pranimit të duhur të komandave të kontrollit të dhëna në nivel hidrocentrali.

2.3 Përfundimi Mekanik

Koncessionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues Njoftimin e Përfundimit Mekanik jo më pak se dhjetë (10) Ditë Pune para datës në të cilën Koncessionarit pret të ndodhë Përfundimi Mekanik. Në një datë të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, por brenda dhjetë (10) Ditë Pune të marrjes nga Autoriteti Kontraktues të këtij Njoftimi për Përfundimin Mekanik, Autoriteti Kontraktues dhe Koncessionari do të përfundojnë inspektimin e përbashkët të punimeve.

Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të inspektojë çdo pjesë të pajisjeve dhe sistemeve të Koncessionarit pas përfundimit të testeve respektive të para-komisionimit dhe ato të komisionimit.

Cdo defekt te punimet ose në pajisjet e Koncessionarit të cilat dallohen gjatë këtij inspektimi dhe nga palët është rënë bashkërisht dakord se janë defekte, ato do të listohen në Listën e Zërave të Anomalive.

Në rastin kur Autoriteti Kontraktues nuk mund të marrë pjesë në inspektim, Koncessionari pas bërjes së përpjekjeve të arsyeshme për të riprogramuar një datë menjëherë pas datës së programuar fillimisht, mund ta kryejë inspektimin edhe në mungesë të Autoritetit Kontraktues.

2.4 Pranimi me Shkrim i Përfundimit Mekanik

Breda pesë (5) Ditë Pune pas përfundimit të inspektimit në përputhje me Nenin [2.3] më sipër, Autoriteti Kontraktues do të dërgojë, ose pranimin e tij me shkrim se është arritur Përfundimi Mekanik, ose lëshojë një Njoftim për Mospërmbushje duke përshkruar çdo mospërmbushje për të arritur Përfundimin Mekanik. Koncessionari do të korrigojë menjëherë çdo mospërmbushje për të arritur Përfundimin Mekanik.

Në rastin kur Autoriteti Kontraktues nuk arrin (i) të caktojë një datë për inspektimin e përbashkët, ose (ii) të dërgojë pranimin e tij me shkrim për Përfundimin Mekanik ose (iii) të dërgojë një Njoftim për Mospërmbushje brenda një periudhe prej pesë (5) Ditë Pune të cituar më sipër, Autoriteti Kontraktues do të konsiderohet se ka pranuar që Përfundimi Mekanik është arritur që në datën e Njoftimit nga ana e Koncessionarit për Përfundimin Mekanik.

Me arritjen e Përfundimit Mekanik, mund të fillojnë Testet e Funksionimit.

3 Testet e Funksionimit dhe Përfundimi Thelbësor

3.1 Testet e Funksionimit – Gatishmëria për testim

Në çdo kohë pas Përfundimit Mekanik, Koncessionari në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues, do të kryejë Testet e Funksionimit për qëllime të përcaktimit të Përfundimit Thelbësor ille do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për gatishmërinë në kryerjen e këtyre Testeve të Funksionimit ("Njoftimi i Gatishmërisë") të paktën pesë (5) Ditë Pune para datës së këtyre Testeve të Funksionimit.

Testi i Funksionimit që lidhet me Hidrocentralin do të përfshijë Testet e Kapacitetit për secilin nga Hidrocentralet Ashta 1 dhe Ashta 2.

Përfundimi me sukses i Testeve të Kapacitetit, siç është përshkruar në bazë të Nenit 3.2 më poshtë, është një kusht paraprak për të arritur Përfundimin Thelbësor.

Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të lejuar fillimin në kohë të Testit të Funksionimit, por mund të kërkojë një shtyrje të Testit të Funksionimit për një periudhë prej dhjetë (10) Ditë Pune pas datës së Njoftimit të Gatishmërisë nga Koncessionari. Koncessionari do të ketë të drejtë të fillojë Testet e Funksionimit dhjetë (10) Ditë Pune pas Njoftimit të Gatishmërisë pavarësisht nëse është i pranishëm ndonjë përfaqësues i Autoritetit Kontraktues në këtë Test Funksional.

3.2 Testi i Kapacitetit

Testi i kapacitetit do të provojë se Hidrocentrali do të arrijë Kapacitetin e Propozuar dhe që secili nga Hidrocentralet Ashta 1 dhe Ashta 2 arrin kapacitetin e tij përkatës të propozuar siç është paraqitur më poshtë:

19.7 MW në pikën e caktuar prej 5.3 m për Hidrocentralin Ashta 1 dhe

28.5 MW në pikën caktuar prej 7.7 m për Hidrocentralin Ashta 2

Duke matur prodhimin neto të energjisë elektrike neto në nënstacionin gjenerues me kabell hyrës (feeder) 7.2 kV (shih diagramën bashkëlidhur me një linjë – është parshikuar një gjenerator me transformator rritës për 15 njësi TG) dhe duke illogaritur prodhimin total neto të energjisë elektrike të Hidrocentralit duke përdorur prodhimin e matur neto të energjisë elektrike (“Testi i Kapacitetit”).

Për këtë matje, duhet të instalohen TR dhe TF të precizion i lartë në kabellin hyrës (feeder). Koncessionari dhe Autoriteti Kontraktues do të bien dakord bashkërisht për përzgjedhjen e kabellit hyrës për këtë matje para prodhimit të nënstacionit gjenerues përkatës prej 7.2 kV, me qëllim që të mundësohet në atë njësi instalimi në kohë i TR dhe TF me precizioni i lartë.

Secili nga Hidrocentralet Ashta 1 dhe Ashta 2 do të konsiderohet se është komisionuar për të arritur Përfundimin Thelbësor kur të jenë përfunduar me sukses testet përkatëse të përshkruara më sipër.

Çdo mosmarrëveshje lidhur me Kapacitetin e Instaluar do t'i paraqitet një Eksperti Teknik dhe Ekonomik në përputhje me Nenin 13.2 të kësaj Marrëveshjeje.

Pika më e lartë do të matet duke përdorur disa matës të nivelit të ujit në pika të ndryshme kanalit të hyrjes dhe kanalit të daljes të të dy hidrocentraleve (pjesë e pajisjeve testuese).

Procedura e testimit dhe vlerësimi do të përputhet me përcaktimet e botimit më të fundit të IEC 60041.

3.3 Testet e Funksionimit – Procedurat Testuese dhe Raportimi

Procedura për kryerjen e testeve, duke përfshirë parametrat e kalibrimit dhe ato të matjes do të bëhen nga Koncessionari dhe do t'i paraqiten për shqyrtim Autoritetit Kontraktues para fillimit të testimit. Brenda dhjetë (10) Ditë Pune pas marrjes së projektit të procedurës së testimit, Autoriteti Kontraktues do t'i japë Koncessionarit komentet dhe sugjerimet lidhur me të (nëse ka). Nëse nuk ndodh asnjë prej tyre, procedura e testimit do të konsiderohet e miratuar.

Të gjitha të dhënat e matura do të shënohen dhe ruhen në sistemin e ruajtjes së të dhënave.

Dokumentat e printuara të të dhënave të testit të funksionimi do t'i jepen Autoritetit Kontraktues nga Koncessionari menjëherë pas përfundimit të testeve të funksionimit. Analizat e rezultateve të testeve do të paraqiten si pjesë e raportit përfundimtar të testimeve. Koncessionari do t'i japë Autoritetit Kontraktues tre (3) kopje të raportit përfundimtar të testimeve sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, duke përfshirë informacionin mbi testimet dhe ritestimet e pasuksesshme.

3.4 Testi i Funksionimit – Ritestimi dhe Pezullimi i Testimit

Në çdo kohë gjatë ose menjëherë pas përfundimit të Testit të Funksionimit, Autoriteti Kontraktues do të këshillojë me shkrim Koncessionarin për ndonjë mangësi në Objektin Elektromekanik të shqyrtuar nga Autoriteti Kontraktues gjatë këtyre testimeve. Koncessionari, me shpenzimet e tij, do të korrigojë këto defekte dhe do të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues për këtë korrigjim dhe për datën e ritestimit. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përsërisë secilin

nga testet e përshkruara në këtë Nen. Në rast se përsëritet Testi i Funksionimit, do të përdoren rezultatet më të favorshme të testimt për të vendosur rezultatet përfundimtare të testimt. Përsëritja e Testit të Funksionimit nuk kërkon përsëritjen e ndonjë testi tjetër. Çdo ri-kryerje e Testit të Funksionimit do të kryhet para Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut.

Defektet e pajisjeve, kontrolleve dhe instrumenteve jo-thelbësore nuk do të ndalojnë fillimin e një testi ose as do të kërkojnë pezullimin e testit, nëse Koncessionari mund të demonstrojë në mënyrë të arsyeshme se defektet ose mos-disponimi i këtyre pajisjeve, kontrolleve ose instrumentave nuk do të kërkojë mbylljen e Objektit Elektromekanik gjatë shfrytëzimit normal.

3.5 Testi i Funksionimit – Devijim Thelbësor nga Kapaciteti i Propozuar

(i) Nëse pas përfundimit të Testit të Funksionimi, Kapaciteti i Instaluar është më i ulët se Kapaciteti i Propozuar me pesë përqind (5%) ose më pak, Koncessionari do të ketë të drejtë të negociojë me Autoritetin Kontraktues një reduktim të arsyeshëm dhe proporcional me ofertën e tij financiare, dhe do të shmangë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncessionit (me kusht që çdo mosmarrëveshje ose një reduktim tillë do të zgjidhet përfundimisht nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik, vendimi i të cilit do të jetë i detyrueshëm).

(ii) Nëse pas përfundimit të Testit të Funksionimit, Kapaciteti i Instaluar është më i ulët se Kapaciteti i Propozuar me më shumë se pesë përqind (5%), Koncessionari do të ketë të drejtë të zgjidhë Marrëveshjen mbi bazën e Rasti të Mospërmbushjes nga Koncessionari, përvèç rastit që parashikohet në pikën (iii) më poshtë.

(iii) Nëse në rastin e (ii) ulja e Kapacitetit i detyrohet ose rezulton nga një informacion thelbësisht fals, i pasaktë, i paplotë ose çorientues në Dhomën e të Dhënavë, dhe nëse Kapaciteti i Instaluar është

(a) më pak se 40 MW, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të zgjidhë Marrëveshjen, ose

(b) 40 MW ose më shumë, Koncessionari do të ketë të drejtë të negociojë me Autoritetin Kontraktues një reduktim të arsyeshme dhe proporcional të ofertës së tij financiare, dhe do të shmangë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncessionit (me kusht që çdo mosmarrëveshje ose një reduktim tillë do të zgjidhet përfundimisht nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik, vendimi i të cilit do të jetë i detyrueshëm).

3.6 Testi i Funksionimit – Testi i Fuqisë

E gjithë energjia e prodhuar gjatë testimt do të jetë në pronësi të Koncessionarit.

3.7 Përfundimi Thelbësor – Njoftimi

Koncessionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues Njoftimin e Përfundimit Thelbësor menjëherë pas arritjes së kërkesave për Përfundimin Thelbësor. Ky Njoftim do të përfshijë rezultatet e Testit të Funksionimit.

3.8 Përfundimi Thelbësor – Pranimi me Shkrim

Brenda dhjetë (10) Ditës së Njoftimit për Përfundimin Thelbësor, Autoriteti Kontraktues do të dërgojë ose pranimin e tij me shkrim se është arritur Përfundimi Thelbësor ose do t'i japë Koncessionarit Njoftimin e Mospërmbushjes, duke përshkruar çdo mospërmbushje për të arritur Përfundimin Thelbësor. Koncessionari do të korrigojë menjëherë çdo mospërmbushje të tillë për të arritur Përfundimin Thelbësor.

Me pranimin nga Autoriteti Kontraktues, Përfundimi Thelbësor do të ndodhë në datën e dërgimit nga Koncessionari te Autoriteti Kontraktues të Njoftimit për Përfundimin Thelbësor. Në rast se Autoriteti Kontraktues as e dërgon pranimin e tij me shkrim se është arritur Përfundimi Thelbësor, as i jep Koncessionarit Njoftimin e Mospërmbushjes brenda periudhës së parashikuar prej dhjetë (10) Ditës së Njoftimit për Përfundimi Thelbësor do të konsiderohet se ka ndodhur në datën e Njoftimit për Përfundimit Thelbësor nga Koncessionari.

4 Përfundimi Final

4.1 Përfundimi Final – Procesi

Duke filluar që nga data e Përfundimit Thelbësor të Hidrocentralit Ashta 1 dhe Ashta 2, Koncessionari do ta shfrytëzojë Hidrocentralin për një periudhë të vazhdueshme prej tre (3) vjetësh pa Ndërprije të Detyruar të Energjisë (sic është përcaktuar në Marrëveshjen e Shitjes së Energjisë

dhe në përputhje me kushtet e saj), periudhë e cila do të shërbejë si një periudhë testimi të qëndrueshmërisë.

Me kalimin e periudhës së sipërpërmendur prej tre (3) muajsh, dhe nëse Koncesionari vendos se ka ndodhur Përfundimi Final, ai do t'i japë Autoritetit Kontraktues Njoftimin e Përfundimit Final dhe do t'i sigurojë Autoritetit Kontraktues Garancinë e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes. Brenda dhjetë (10) Ditë Pune pas kësaj, Autoriteti Kontraktues ose do t'i dërgojë Koncesionarit pranimin e tij me shkrim se është arritur Përfundimi Final, ose do t'i japë Njoftimin e Mospërbmbushjes duke përshkuar çdo mospërbmbushje për arritjen e Përfundimit Final. Kur jepet një Njoftim për Mospërbmbushje, Koncesionari do të ndreqë me shpejtësi mospërbmbushjen(et) e identifikuara për të arritur Përfundimin Final dhe do të përsërisë procesin e njoftimit të parashikuar më sipër.

Me pranimin nga Autoriteti Kontraktues, Përfundimi Final do të konsiderohet se ka ndodhur në datën e dërgimit të Njoftimit të Përfundimit Final te Autoriteti Kontraktues. Në rast se Autoriteti Kontraktues as e dërgon me shkrim pranimin e tij dhe as jep një Njoftim Mospërbmbushjeje, Përfundimi Final do të konsiderohet se ka ndodhur në datën e Njoftimit të Përfundimit Final.

4.2 Mosarritja e Përfundimit Final

Nëse Përfundimi Final nuk ka ndodhur brenda gjashtë (6) muajve pas Datës së Përfundimit të Punimeve sipas Grafikut, përveç kur është rënë dakord ndryshe, Koncesionari do të paguajë kostot e llogaritura të Zérave të pambaruara të Listës së Anomalive.

SHTOJCA H

LISTA TREGUESE E AUTORIZIMEVE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT

(i) objekt i nënparagrafit (ii) të këtij shënimisë, Autorizimet e specifikuara më poshtë janë licencat dhe lejet kryesore të kërkuaara nga Ligji për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një hidrocentrali. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues këshillon Koncesszionarin se gjatë Fazës së Ndërtimit, mund të kërkohen në bazë të Ligjit, Autorizime të tjera apo ndryshe të dobishme për Projektin, psh., për përdorimin e materialeve të dëmtuara (nëse këto materiale mund të përdoren); licencat dhe lejet e inspektorëve të punës dhe anëtarëve të tjerë të stafit, etj.;

(ii) kjo listë e përpiluar nga Autoriteti Kontraktues është përshkruese, jo detyruese dhe jepet vetëm për qëllime informimi. Koncessionari do të mbështetet vetëm në përpjekjet e veta të kujdeshshme dhe të nevojshme dhe/ose në asistencën nga këshilltarët ligjorë shqiptarë në mënyrë që të bëjë ndonjë përcaktim sa i përket përcaktimit të saktë të natyrës dhe qëllimit të çdo Autorizimi të kërkuar nga Ligji për qëllime të Projektit.

1. Procedura e Aplikimit për Koncession

Për ndërtimin e një hidrocentrali, në rastin e një propozimi të vetë-iniciuar, kërkuesi duhet t'i paraqesë Ministrinë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Projektin, i cili duhet të përmbajë:
 - i. Studimin e Fizibilitetit lidhur me zgjidhjen teknike për një shfrytëzim maksimal të potentialit ujor;
 - ii. Preventivin e detajuar të kostove;
 - iii. Grafikun e Zbatimit të Projektit;
 - iv. Pajisjet dhe makineritë që do të përdoren;
 - v. Studimin dhe mjetet e lidhjes me sistemin;
 - vi. Projektimet;
2. Studimin Hidrologjik;
3. Studimin Gjeologjik;
4. Plan-Biznesin;
5. Raportin e Ndikimit në Mjedis;
6. Informacion nga Këshilli i Basenit Ujor të zonës ku do të zbatohet koncesioni prioritetin dhe për sasinë e ujit që mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike;
7. Licencat përkatëse të specialistëve që kanë kryer studimet dhe vlerësimin e studimeve;

8. Dokumentet ligjore të regjistrimit të shoqërisë;

Pas përfundimit të procedurave të tenderit, dhënies dhe nënshkrimit të marrëveshjes së koncesionit, duhet të plotësohen procedurat dhe dokumentet e mëposhtme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit.

2. Leja e Koncesionit e lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit

Leja e koncesionit për përdorimin e ujit jezet nga Këshilli Kombëtar i Ujit, bazuar në Ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 "Mbi Rezervat Ujore" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 15.04.2005. Kjo leje është lëshuar tashmë.

3. Licenca nga Enti Rregulator i Energjisë (ERE) për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e një hidrocentrali dhe prodhimin e energjisë

Sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë", Enti Rregulator i Energjisë lëshon licenca për aktivitetet e mëposhtme:

- i. ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike;
- ii. transmetimin e energjisë elektrike;
- iii. shpërndarjen e energjisë elektrike;
- iv. furnizimin ose tregtimin e energjisë elektrike në çfarëdo forme;
- v. eksportin e energjisë elektrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe
- vi. importin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për çdo aktivitet objekt licencimi, të kryera nga i njëjti person do të lëshohen licenca të veçanta.

ERE i jep licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike vetëm një personi për një zonë të caktuar shërbimi.

Shoqëritë e licencuara për shpërndarjen e energjisë elektrike do të realizojnë furnizimin me energji elektrike të klienteve dhe/ose furnizimin në rastin e klientëve të mandatuar tariforë dhe furnizuesit e kualifikuar do të realizojnë furnizimin e klientëve me statusin e klientit të kualifikuar.

Afat minimal për t'u pajisur me licencë nga ERE është 3 muaj.

4. Leja e Sheshit të Ndërtimit

Bërrja e kërkesës për t'u pajisur me miratimin e sheshit të ndërtimit dhe studimin e tij urbanistik është e detyrueshme për çdo person fizik ose juridik që ka qëllim të ndërtojë një objekt ndërtimi, mbi sipërfaqe ose nëntokë.

Kërkesa i paraqitet Drejtorisë së Urbanistikës në Këshillin Bashkiak, ose në zyrën e urbanistikës në bashki ose komunë. Vendndodhja e shesheve të ndërtimit dhe kushteve të tyre urbanistike janë paraqitur në Planet e Përgjithshme Rregulluese ose në studimet e pjesshme urbanistike. Kërkesa për miratimin e vendndodhjes funksionale dhe kushtet urbanistike të sheshit bëhet vetëm nga pronari i tokës. Për sheshet e ndërtimit që janë pronë publike, mund të paraqitet më shumë se një kërkesë. Këshilli i Zonës, Këshilli Bashkiak dhe Këshilli i Komunës shqyrtojnë kérkesat, në mënyrën e ofertave konkurruese dhe zgjedhin atë që përbush më mirë kushtet financiare, ekonomike, sociale, urbanistike, arkitekturore dhe mjetisore.

Nëse organet lokale të qeverisjes kanë interes në ndërtimet mbi pronën publike ata do të fillojnë procedurat e tenderit.

Cilido që ka qëllim të aplikojë për një leje sheshi ndërtimi duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin Tip kërkeze Nr. 1, dhe 6 (për prerjen e drurëve) dhe Nr. 8 (për prishjen e ndërtimeve ekzistuese), nëse është e nevojshme;
2. Certifikatën e pronësisë shoqëruar me hartat treguese;
3. Gen-Planin e tokës;
4. Azhornime të tjera nga organet dhe ndërmarrjet përkatëse (furnizimi me ujë, kanalizimi, qirave të zeza, telekomi, etj);
5. Studimin urbanistik pjesor të zonës së ndërtimit, i cili duhet të përgatitet nga një arkitekt i licencuar;

6. Planvendosjen e objektit;
7. Projekt-idenë e objektit;
8. Raportin Shpjegues mbi studimin dhe projektin;
9. Sistemet e jashtme, sheshet, zonat e gjelbërtë, vendparkimet, rrugët dhe skemat e lëvizjes së këmbësorëve;
10. Fotomontazhin e objektit mbi foton e gjendjes ekzistuese;
11. Marrëveshjet me pronarët e pronave fqinje, duke detauar numrin e pronave të pronarëve fqinjë.
12. Lejen nga Institucioni i Monumenteve të Kulturës, lidhur me zonat që janë nën mbrojtje nga Institucioni;
13. Vërtetimin nga Institut Gjeologjik (për ndërtimet mbi 3 kate) dhe nga Institut Sizmik (për ndërtimet mbi 8 kate);
14. Dokumentin fotografik të zonës;
15. Deklaratën noteriale të pronarit për personat e pastrehë qiramarrës në pronat private. Afati minimal për t'u pajisur me lejen e sheshit të ndërtimit është 3 muaj.

5. Leja e Ndërtimit

Cilido që synon të ndërtojë në territorin shqiptar duhet të pajiset gjithashtu me një leje ndërtimit. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik i cili është licencuar si ndërtues. Sipas *Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*, zbatimi i Punimeve të Ndërtimit do të kryhet nga ndërtuesit e licencuar sipas ligjit. Licencimi i ndërtuesve është parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 13.12.1993 "Për ushtrimin e veprimitarive në ndërtim dhe projektim të shoqërive". Sipas këtij vendimi çdo shoqëri që synon të kryejë aktivitete në fushën e ndërtimit dhe projektimit duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin e Licencave profesionale, në Ministrinë e Punëve Publike.

Nuk lejohet transferimi ose kalimi i lejes së ndërtimit.

Shoqëria do të aplikojë për lejen e ndërtimi brenda 6 muajsh pasi ka marrë lejen e sheshit të ndërtimit dhe kjo do të miratohet brenda 45 ditësh.

Shoqëria, para se të pajiset me lejen e ndërtimit duhet të paguajë 1% të vlerës së investimit, bazuar në vlerën e përllogaritur të projektit. Nëse ndërtimi do të bëhet në prona publike, në momentin e lëshimit të lejes së ndërtimit, shoqëria do të paguajë 50% të vlerës së truallit dhe kur të jetë përfunduar struktura e skeletit të katit të parë shoqëria do të paguajë pjesën e mabetur të shumës.

Ndërtimet në zonat me rëndësi turistike janë përcaktuar në planet urbanistike rajonale dhe në strategjitet kombëtare për zhvillimin e turizmit.

Dokumentet që duhet të paraqiten për t'u pajisur me leje ndërtimi janë si më poshtë:

1. Leja e miratuar e sheshit të ndërtimit;

2. Kontrata e noterizuar ndërmjet pronarit të tokës dhe shoqërisë ndërtuese dhe licencat e noterizuara të shoqërisë së ndërtimit;

3. Projekti teknik mbi studimin e projektit;

4. Kopje të noterizuara të licencave të projektuesve;

5. Të dhënat Gjeologjike dhe Inxhinierike për sheshin e ndërtimit;

6. Të dhënat inxhinierike dhe sizmike për sheshin e ndërtimit;

7. Projekti i Plotë;

8. Llogaritjet bazë të projektit;

9. Planimetria e Sistemimeve të Jashtme;

10. Grafiku i Punimeve;

11. Preventivi;

12. Çertifikata nga Inspektoriat i Mjedisit Urban;

13. Çertifikata nga Ndërmarrja e Tregjeve Taksave në Bashkinë e Tiranës.

6. Lejet Mjedisore

Sipas ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", personat juridike janë të detyruar të pajisen me miratimet e nevojshme për aktivitetet që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis. Miratimi i kërkesës bëhet me paraqitjen e deklaratës mjedisore, lejes mjedisore, me pëlqimin ose autorizimin, sipas rasteve të specifikuara në ligj.

Deklarata mjedisore, leja mjedisore, pëlqimi dhe autorizimi janë dokumente zyrtare, të cilët parashikojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat do të zhvillohet veprimitaria, për parandalimin dhe pakësimin e pasojave të saj në mjedis. Pas shqyrimit të dokumentacionit dhe këshillimit me palët e interesuara për projektet, strategjitet dhe planet e zhvillimit, Ministri i Mjedisit shpall qëndrimin e tij/saj zyrtar me deklaratën mjedisore.

Deklarata mjedisore përmban arsyetimin teknik dhe mbështetjen ligjore, jep argumentet përkatëse dhe masat që duhen marrë për të shmangur dhe pakësuar ndikimet negative në mjedis.

Shfrytëzimi i pasurive minerare dhe burimeve natyrore, si dhe çdo veprimitari tjetër që ndikon në mjedis, përfundimisht përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mjedisit.

Personat juridikë që kryejnë aktivitete të cilat ndikojnë në mjedis, në mënyrë që të pajisen me Lejen Mjedisore (LM) duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën e personit juridik për t'u pajisur me LM;
2. Përshkrimin e projektit ose aktivitetit, duke përfshirë:
 - a. Karakteristikat e Projektit:
 - Përshkrimin e proceseve kryesore, teknologjinë, kapacitetin, lëndët e para, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;
 - Grafikun e Punimeve për ndërtimin dhe shfrytëzimin;
 - Aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (rrugë të reja, sigurimi i ujit të pijshëm, etj.);
 - b. Vendndodhjen e projektit
 - planimetrinë me kufijtë e projektit;
 - Hartën dhe fotografitë që tregojnë vendndodhjen e projektit;
 - Planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.
 - c. Ndikimet e Mundshme në mjedis
 - Ndikimet në shëndetin e njerëzve, në florë dhe faunë, në tokë, ujë dhe ajër, në klimë dhe peizazh, në trashëgiminë kulturore dhe historike;
 - Natyra e ndikimeve (direkte, indirekte, të përhershme, të përkohshme, pozitive, negative);
 - Masat për zbutjen e ndikimeve në mjedis;
 - Ndikimet me natyrë ndërkufitarë.
3. Vendimin e gjykatës për regjistrimin e kërkuesit si person juridik.
4. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të hartuar nga persona fizikë e juridikë të certifikuar e të zgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore.
5. Certifikatat e pronësisë ose kontratat për shfrytëzimin e pronave që ndodhen aty ku do të kryhet aktiviteti;
6. Vërtetimet nga organet kompetente shtetërore për shfrytëzimin e territorit;
7. Raportin e hollësishëm për ndikimet e projektit në mjedis.

Periudha kohore minimale për t'u pajisur me deklaratën mjedisore dhe lejen mjedisore është nga 3 deri në 6 muaj me një periudhë maksimale prej 9 muajsh në rastin kur merret një ekspertizë për të ndibmuar në studimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

7. Oponence Teknikë e Projektit nga Qeveria

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 22.3.2007, të gjitha projektet për ndërtimin hidrocentralit me koncesion do t'i nënshtrohen një oponence teknike nga një grup ekspertësh të shquar në fushën hidro-teknologjike, inxhinierike, ligjore, në ekonomi, gjëologji, etj. Emërimi i anëtarëve të grupit dhe mënyrës së funksionimit të tij do të rregullohet me Vendim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energetikës.

Ekspertët do të bëjë vlerësimin e projekteve duke pasur parasysh shfrytëzimin optimal të burimeve ujore dhe do të kryejnë kontrollin teknik të këtij projekti sa i përket kërkesave të *Ligjt nr. 8093, datë 1.3.1996 "Për Rezervat Ujore"* dhe *Ligjt nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*. Pas përfundimit të oponencës, ekspertët do të hartojnë një raport, i cili do të shqyrtohet dhe miratohet me shumicë votash nga Këshilli Drejtues i Agjensisë Kombëtare të Burimeve Ujore (AKBU). Materiali i oponencës, së bashku me vendimin e AKBU janë pjesë thelbësore e dokumentacionin që i dërgohet Autoritetit Kontraktues për vazhdimin e procedurave.

SHTOJCA I **TERMAT TREGUESE TË REFERENCËS PËR STUDIMIN E VLERËSIMIT TË** **NDIKIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR TË PROJEKTIT ASHTA**

Këto TR të përpiluara nga Autoriteti Kontraktues janë përshkruese, jo detyruese dhe jepen vetëm për qëllime informimi. Koncessionari do të mbështetet vetëm në përpjekjet e veta të kujdeshshme dhe të nevojshme dhe/ose në asistencën e këshilltarëve ligjorë shqiptarë në mënyrë që të bëjë ndonjë përcaktim sa i përket përcaktimit të saktë të natyrës dhe qëllimit të çdo kërkesë sociale dhe mjedisore lidhur me Projektin.

1.1 Objektivat e Studimit

Studimi VNSM duhet të jetë një Vlerësim i hollësishëm i NDIKIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR të HEC-it të propozuar në Ashtë dhe duhet të përgatitet një raport që përmban rezultatet e plota të vlerësimit.

Duhet të përgatitet Plani i Administrimit Mjedisor për të përcaktuar dhe llogaritur kostot e zbutjes së ndikimit në mjedis, monitorimin dhe masat institucionale që do të merren gjatë fazave të zbatimit dhe shfrytëzimit të Projektit.

Duhet të përgatitet gjithashtu një Plan i veçantë i Shpërnguljes dhe Kompensimit për të trajtuar çështjet e ngritura nga njerëzit e shpërngulur nga toka, i cili do të jetë i nevojshëm për zhvillimin e projektit.

1.2 Vlerësimi i NDIKIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR

Duhet të studiohet në detaje, ndikimi i skemës së propozuar Ashta në mjediset fizike, biologjike, social-ekonomike dhe kulturore, në përputhje me legjislacionin Shqiptar, standartet e Bashkimit Evropian dhe në përputhje me kërkesat e agjensive financuese (i referohet Udhëzimeve të Përgjithshme mbi Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë si dhe Standarteve të Zbatimit për Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore të Korporatës NDERKOMBËTARE FINANCIARE OSE PARIMEVE TË EKUATORIT). Vlerësimi mjedisor do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- shqyrtimin e studimeve të mëparshme;
- shqyrtimin e strategjive, kuadrit ligjor dhe administrativ;
- përshkrimin e projektit të propozuar;
- përgatitjen e një Plani Publik Konsultimi dhe Dhënieje Informacioni;
- studimet bazë për përshkrimin e kushteve social-ekonomike dhe mjedisore në zonën e influencuar nga projekti;
- analizën e detajuar social-ekonomike të zonave tokësore të përfshira në projekt;
- vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore;
- vlerësimin e masave zbutëse ose kompensuese;
- përgatitjen e Planit të Administrimit Social dhe Mjedisor; dhe
- përgatitjen e Planit të Shpërnguljes dhe Kompensimit.

Kërkesat kryesore të elementeve të ndryshëm të VNSM janë dhënë më poshtë.

1.2.1 Shqyrtimi i skicave të mëparshme të projekteve të planifikuar

Para fillimit të vlerësimit të plotë të ndikimit në mjedis të HEC-it të propozuar Ashta, duhet të përgatitet një shqyrtim përshtkuar i skicave të mëparshme të projekteve të propozuara nga iniciatorë të ndryshëm. Kjo detyrë do të sigurojë një historik të projektive të ndryshme të propozuara dhe do të japë një pamje të qartë të evolucionit të projektit në HEC-in Ashta të propozuar tashmë. Puna do të bazohet në një shqyrtim të raporteve të mëparshme dhe të informacionit ekzistues. Të paktën, ky shqyrtim duhet të marrë në konsideratë skemën CWE, ndryshimet e propozuar nga Lahmeyer dhe projektimin e krijuar nga SLII për hidrocentralin Ashta.

Ky shqyrtim duhet të fokusohet në ndryshimet e propozuara, ndikimin e këtyre ndryshimeve në prodhimin e elektricitetit, kostot e projektit dhe çështjet sociale dhe mjedisore ose përfitimet e çdo projektimi.

1.2.2 Strategjia, kuadri ligjor dhe administrativ

Ligji Shqiptar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i miratuar në 2003 ka parashikuar dispozita për të gjitha hapat e nevojshëm për të zbatuar procedurën e VNM: paraqitjen e kërkesës, shqyrtimin fillestar, përzgjedhjen dhe klasifikimin, konsultimin, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organeve të tjera, vendim-marrjen, pjesëmarrjen e publikut, etj.

Shtojca 1 e këtij Ligji liston aktivitetet të cilat duhet t'i nënshtrohen një procesi të detajuar të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Hidrocentralet përfshihen në këtë kategori.

Vendimi nr. 268, datë 24-04-2003 që lidhet me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis specifikon se specialistët e mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për auditimin mjedisor në Shqipëri duhet të çertifikohen nga Ministri i Mjedisit.

Në mënyrë që të garantohet përputhshmëria e projektit me standartet sociale dhe mjedisore kombëtare dhe, sipas rastit, ato ndërkombëtare, duhet të ndërmerrret një shqyrtim i detajuar i kuadrit ligjor dhe administrativ shqiptar brenda të cilit kryhet VNM. Ky shqyrtim duhet të marrë në konsideratë kuadrin legislativ dhe administrativ të tillë si (por pa u kufizuar në):

❖ Legjislationi mjedisor

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji për Burimet Ujore (1996);
- Ligji për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare (1999);
- Ligji për Administrimin e Burimeve Natyrore (1996; i rishikuar në 2000) (INWEB 2007);

○ Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal (2000);
○ Ligji për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës (2001);
○ Ligji për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Dheut (humusit) (2001);

- Ligji për Zonat e Mbrojtura (2002);
- Ligji për Trajtimin e Kimikateve;
- Ligji për Trajtimin e Mbetjeve Ujore;

Stëqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare mjedisore. Marrëveshjet ndërkombëtare janë pasqyruar në legjislatin kombëtar nëpërmjet miratimit të ligjeve specifike të tillë si:

- Ligji Nr. 8216/1997, i cili parashikon aderimin në Konventën e Bazelit;
- Ligji nr. 8463/1999, në Protokollin e Vienës dhe Montrealit;
- Ligji nr. 8556/1999, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar vetëtirëzimin;

- Ligji Nr. 8672/2000, etj.
- ❖ Marrëveshje të tjera Mjedisore Multilaterale në Shqipëri
- Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar (Konventa ESPOO) 1991;
 - Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Burimeve Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Konventa e Ujit) 1994;
 - Konventa për Rëndësinë Ndërkombëtare të Kënetave veçanërisht si habitat për shpendët e ujit (Konventa RAMSAR) 1996;
 - Konventa Aarhus 2001;
 - Ligji për Mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitarë (ligenet e Ohrit, Prespës dhe Shkodrës; 2003);
 - Etj.

Së fundi, përderisa Plani më i fundit i Veprimit Kombëtar Mjedisor (1993, azhornuar në 2002) kishte identifikuar si një nga priorititetet e vendit zbatimin e mekanizmave mjedisorë të niveleve Evropiane si një nga kushtet për anëtarësimin e ardhshëm në Bashkimin Evropian, (BE), duhet të shqyrtohen dhe listohen standartet e zbatueshme të BE-së.

Në lidhje me rregullat profesionale të shëndetit dhe sigurisë, ligjet kryesore të Republikës së Shqipërisë janë:

- Ligji nr. 7961 Kodi i Punës (12 korrik 1995);
- Ligji nr. 7986 (13 Shtator 1995);
- Etj.

1.2.3 Përshkrimi i projektit

Duhet të jepen elementët e mëposhtëm të projektit:

- konteksti gjeografik, fizik, social dhe i përkohshëm i projektit;
- përligjia e projektit duke përfshirë, kush do përfitojë nga elektriciteti i prodhuar dhe cilat do të janë përfitimet e Shqipërisë;
- përbërësit kryesorë të projektit të propozuar duke përfshirë, por jo domosdoshmërisht duke u kufizuar në:

a. punimet devijuese (ato punime janë kryer tashmë por mund të jetë i nevojshëm modifikimi i tyre për projektin);

- b. punimet gjërryese në rezervuarin e Spatharës (nëse ka);
- c. strukturat për hyrjen në brendësi;
- d. kanalet rrjedhëse;
- e. kanale shkarkimi në raste emergjencash;
- f. centralin elektrik;
- g. kanalet shkarkuese;
- h. nëninstacionin;
- i. linjën e transmetimit në nën-stacion;

i. kërkesat që nuk lidhen me sheshin si akomodimi i punëtorëve, rrugët hyrëse, furnizimet me ujë dhe energji, burimet e lëndëve të para duke përfshirë vendet e gërmimeve, sheshet e guroreve dhe pajisjet e shëndetit, etj.;

ii. grafikun e ndërtimit, metodat e ndërtimit, kriteret dhe karakteristikat e funksionimit duke përfshirë kërkesat që lidhen me energjinë dhe stafin si dhe nevojat e mirëmbajtjes në një afat të gjatë.

Përshkrimi do të identifikojë zonat tokësore të cilat do të përfshihen në mënyrë të përhershme në projekt dhe si pasojë do të formojnë bazën e Planit e posaçëm të Shpërnguljes dhe Kompenzimit. Duhet të identifikohen gjithashtu tokat që nevojiten në mënyrë të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit.

1.2.4 Konsultimi publik dhe plani i dhënes së informacionit (KPDHI)

Projekti i HEC-it Ashta në Bushat ka pasur tashmë një histori të gjatë që nga fillimi i zhvillimit të tij në vitet '70 dhe ka grumbulluar një bagazh disi negativ në perceptimin e publikut për projektin nga NGO-të dhe nga palët e tjera të interesuara në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky perceptim negativ e ka burimin kryesish në ndikimet në mëdës të projektit fillimisht të propozuara nga CWE në ekosistemin e Liqenit të Shkodrës, lumenjve Drin dhe Buna dhe mungesës së perceptuar të transparencës në procesin e marrjes së vendimit për zhvillimin e projektit.

Takimet dhe aktivitetet janë organizuar nga shoqëria civile, me mbështetjen e donatorëve dhe organizatave ndërkontinentale. Çështjet kryesore që u ngritën në këto aktivitete përfshijnë:

- Ekosistemin e Liqenit të Shkodrës (pakësimin e nivelit të ujit);
- Çështjen e turizmit (tharjen e Lumin Drin në fund të Kështjellës së Shkodrës);
- Rritjen e rrezikut të përmbytjeve në zonën e Shkodrës;
- Pakësimin e prodhimit të HEC-it të Vaut të Dejës;
- Perceptimin e transparencës në procesin e marrjes së vendimit;
- Ndikimin në sistemin e Vaditjes;
- Humbjen e tokës kryesore bujqësore.

Është parashikuar se KPDHI do të jetë kryesish nën kontrollin e Inisiatorit. Ai duhet të marrë në konsideratë kontekstun specifik të projektit dhe të sigurohet se nuk ka asnjë ngatërruesë ndërmjet projektit të vjetër të HEC-it të Bushatit dhe Projektit të ri të propozuar të HEC-it të Ashtës.

KPDHI do të mbulojë të gjithë komponentët e projektit duke përfshirë kanalin rrjedhës dhe kanalin shkarkues, centralin elektrik dhe linjën e energjisë si dhe pajisjet ndihmëse që nevojiten gjatë ndërtimit. Grupi i projektit të VNSM do ta asistojë Inisiatorin gjatë procesit të VNSM për arsyen se KPDHI duhet të shtrihet përgjatë gjithë vazhdimësisë së projektit, jo vetëm gjatë VNSM. Si pasojë, pritet që grupi i projektit të VNSM do të marrë pjesë në takime, seminare ose forma të tjera të aktivitatave konsultative, në mënyrë që të mbledhë informacionin mbi kontekstin social dhe mëdisor lokal, të sigurojë informacionin teknik dhe asistojë Inisiatorin kur të jetë e nevojshme.

Sinteza e aktivitatave konsultative të mbajtura nga iniziatori para dhe gjatë VNSM duhet të bëhet pjesë e raportit të VNSM. Kjo sintezë do të paraqesë:

- Natyrën e aktivitatave të mbajtura (datën, numrin e pjesëmarrësve, vendin);
- Kopje të materialevë informative të prezantuara;
- Listën e çështjeve të diskutuara, pyetjeve ose problemeve të ngritura nga pjesëmarrësit.

1.2.5 Kushtet bazë sociale dhe mëdisorë

Do të përgatitet një përshtakim i mëdositë aktuale sociale dhe biofizike në zonën e influencës së projektit nga studimet bazë të sheshevë specifike dhe studimet rajonale në sferat fizike, biologjike dhe social-ekonomike. Fushat e studimit përfshijnë fushën e plotë të ndikimit të parashikuar dhe është përkufizuar si:

- * fusha e projektit: sheshi i ndërtimit dhe rrithinat më afér punimeve, duke përfshirë strukturat, linjën e energjisë dhe pajisjet e celësave elektrikë, kampin e ndërtimit, gropat e gurore, dhe ato të dheut, zonat e hedhjes së mbeturinave dhe rrugët hyrëse;
- * fusha në pjesën e poshtme të sheshit të projektit, ku mund të parashikohet se ç'ketë pasoja në regjimin e rrjedhjeve dhe mëdisin e bregut të lumit.
- * vendet me shtrirje përtetë projektit, ku do të ketë si pasoja direkte ashtu indirekte, kryesish social-ekonomike dhe duke përfshirë, për shembull, pasojat e zhvillimit të projektit dhe masat e propozuara të zbutjes së pasojave në shëndetin publik dhe rolin e gra kezave të tjetra lokale, ndikimin e akomodimit të punëtorëve të ndërtimit dhe çështjen e zhvendosjes së tij të shpërndarur;
- * zona ku mëdiset ekzistuese dhe të ardhshme mund të kenë pasoja në zonat e rëndësishme e projektit. Për shembull, aktivitetet e përdorimit të tokës në bazenin të jashtëzakonisë së projekteve do të influencojnë ritmet e sedimentarizmit dhe do të ndikojë në formacionin e pjesës së projekteve.

Studimet bazë kanë qëllim të sigurojnë një masë matjeje për gjendjen ekzistuese të mjedisit kundrejt të cilit mund të monitorohen ndryshime të ardhshme për shkak të projektit. Përshkrimi bazë do të mbulojë të gjitha karakteristikat kryesore mjedisore si në sferën natyrore ashtu edhe në atë social-ekonomike.

1.2.5.1 Komponentët socialë të mjedisit

Aspektet social-ekonomike do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë:

- Përdorimi i tokës, posedimi i saj dhe pronësia;
- Posedimi dhe aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave;
- Agrikultura;
- Peshkimi;
- Turizmi;
- Aktivitetet argëtuese;
- Shfrytëzimi i minierave;
- Prodhimi i energjisë.
- Infrastruktura;
- Rrjetet transportuese:
- Rrugët;
- Hekurudhat;

Furnizimi me ujë;

Higjiena;

Komunikimi.

- Grupimet etnike, fetare dhe gjuhësore;
- Aktivitetet argëtuese dhe aktivitetet në kohën e lirë;
- Trashëgimia kulturore të tilla si varrezat dhe elementët arkeologjikë;
- Shpërndarja e popullsisë dhe modelet e zgjedhjes së vendbanimit;
- Karakteristikat demografike;
- Gjendja dhe Shqetësimet e Shëndetit, veçanërisht lidhur me ujin dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme;
- Edukimi dhe nivelet e arsimimit (veçanërisht te gratë);
- Shërbimet sociale;
- Peisazhi dhe pikat e interesit nga ana vizuale.

1.2.5.2 Komponentët fizikë dhe biologjikë të mjedisit

Për mjedisin natyror, në çështjet e rëndësishme do të përfshihen:

- Klimologjia dhe tendencat;
- Fiziografia, gjeologjia dhe sismologjia;
- Gjendja e erozionit;
- Pedologjia dhe vlera e dheut për bujqësinë;
- Hidrologjia dhe pasojat e projektit në pjesën e poshtme të regjimit të rrjedhjes së digës së Spatharës dhe në mënyrë më specifike për Lumin e Gjiadrit;
- Konteksti hidro-gjeologjik (duhet të kryhet një tipizim i furnizimit me ujë të puseve dhe burimeve të tjera në mënyrë që të identifikohet ndonjë ndryshim në sasinë ose cilësinë pas zbatimit të projektit. Vazhdimi i tij duhet të përfshihet në planin e monitorimit);
- Sasia e futjes së ujit dhe shkarkimi i ujit të mbetur;
- Cilësia e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Bimësia tokësore me një vëmendje të veçantë për moçalet e pyllëzuar të ishullit mbi lumin Drin që mund të preken;

- Ihtiofauna duke përfshirë speciet shtegtuese dhe jo-shtegtuese;
- Ekologjia ujore;
- Zogjtë e ujit;
- Bimësia dhe fauna tokësore;
- Sheshet e ndjeshme me vlerë të lartë ekologjike;

- Zonat e mbrojtura;
- Burimet ekzistuese të emëtimit të zhurmës dhe ajrit.

Në këtë fazë do të identifikohen gjithashtu programet e ruajtjes dhe çdo plan veprimi kombëtar ose lokal përmbrnjën e mjedisit.

1.2.6 Vlerësimi i ndikimeve të mundshme sociale dhe mjedisore

Duhet të bëhet një vlerësim dhe përcaktim i detajuar i ndikimeve pozitive dhe negative, direkte dhe indirekte, të menjëherëshme dhe afatgjata, të përhershme dhe të përkohshme të projektit, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe gjatë fazës së shfrytëzimit. NDIKIMET DO TË VLERËSOHEN NË KRITERE CILËSORE DHE SASIORE, NË BAZË TË NATYRËS SË TYRE TË PANDARË DHE MUNDËSISË SË SIGURIMIT TË TË DHËNAVE TË DUHURA PËR TË BËRË TË MUNDUR MARRJEN PËRSIPËR TË ANALIZAVE PARASHIKUESE.

Duhet të prezantohet metodologja e vlerësimit të ndikimit dhe duhet të shprehet qartë vlerësimi i ndikimit të çdo përbërësi të veçantë.

Do të vlerësohet shtrirja e gjërë e ndikimeve të rëndësishme të mundshme në mjedisin natyror dhe në atë human, së bashku me implikimet strategjike dhe social-ekonomike të pasojave, duke përfshirë çështjet e mëposhtme të cilat janë identifikuar tashmë:

1.2.6.1 Komponentët socialë të mjedisit

- Kërkosat ligjore specifike për projektin;

Mjedisi:

Përvetësimi i tokës;

Çështjet e shpërnguljës.

- Zotërimi i tokës (identifikimi i tokës së nevojshme për projektin, statusi i saj aktual, ndikimi i pronarëve të tokës që duhet të heqin dore nga toka)
- Nevoja për shpërngulje të detyruar;
- Përdorimi i tokës (modifikimet dhe kufizimet e paraqitura nga projekt i një përdorimin aktual të tokës)
- Agrikultura;

NDIKIMI I PROJEKTIT NË FERMAT QË DO T'U HIQET NJË PJESE TOKE PËR DOBI TË PROJEKTIT (SHFRYTËZUESHMËRIA E KËTYRE FERMAVE);

NDIKIMI I PROJEKTIT NË THARJEN DHE SISTEMIN E VADITJES SË TOKAVE-FERMA;

Vlerësimi i çdo humbjeje në prodhim.

- Peshkimi (tregtar, argëtues ose mjet jetese);
- Rrjetet e transportit;
- Aktivitetet e shfrytëzimit të minierave për materialet kokrrizore;
- Furnizimi me ujë (puset dhe ujrat sipërfaqësore);
- Aktivitetet argëtuese dhe turizmi;
- Zhurma dhe dridhjet;
- Peisazhi dhe ndikimi viziv i projektit;
- Trashëgimia kulturore (më specifiksht nevoja për të lëvizur një varrezë) dhe mbrojtja e artefakteve arkeologjike;

- Shëndeti dhe siguria e komunitetit (cilësia dhe mundësia e sigurimit të ujit, siguria e trafikut, parandalimi i sëmundjeve, përgatitja në raste emergjencash dhe planet reaguese);
- Aspektet social-ekonomike (hapja e vendeve të punës, rënie ekonomike, etj.)
- Prodhimi i energjisë;
- NDIKIMI KUMULATIV SOCIAL DHE EKONOMIK.

1.2.6.2 Komponentët fizikë dhe biologjikë të mjedisit

- Pasojat e ndryshimeve klimaterike në projekt;
- Cilësia e ajrit gjatë ndërtimit (pluhuri) dhe gjatë shfrytëzimit (zëvendësimi i burimeve të tjera e energjisë si qymyri ose lëndët e rënda djegëse);
- Emëtimet e gazrave që ndikojnë në efektin serrë (përshtatshmëria e mundshme Mekanizmave të Zhvillimit të Pastër të protokollit të Kiotos);

- Sizmologjia;
- Ndikimi i sheshit në projekt;
- Ndikimi i komponentëve (si gurorja) në infrastruktura të tjera si Diga e Zadesë.
- Hidrologjia;
- Pjesa e poshtme e digës së Spatharës;

Pjesa e poshtme e daljes së kanalit shkarkues në periudhë rrjedhjesh të pakëta dhe rrjedhjesh të shumta;

- Sedimentologjia dhe erozioni:
- Ndikimet e lidhura me aktivitetin e gjerryerjes në rezervuarin e Spatharës nëse ka;
- Erozioni në pjesën e poshtme të kanalit shkarkues dhe kanali të shkarkimit në raste emergjencash;

Efekti i përdorimit të tokës ujëmbledhëse në sedimentarizimin e rezervuarit të Spatharës dhe kanalin rrjedhës (veçanërisht në bazenin ujëmbledhës të Gjadrit).

- Hidrologjia dhe tharja;
- Cilësia e ujit (uji sipërfaqësor dhe nëntokësor);
- Bimësia e kënetave (një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet moçaleve të pyllëzuar që do të thahen ndërmjet digës së Spatharës dhe fundit të kanalit shkarkues);
- Ihtiofauna (duhet t'i vihet theksi pengesave në zonat e shtegtit të peshqve dhe ato të vendosjes së vezëve nga peshqit);
- Këmbëngulje për të vëzhguar një rrjedhje ekologjike në pjesën e poshtme të Spatharës dhe nëse është kështu çfarë rrjedhje duhet propozuar dhe në çfarë periudhe të vitit;
- Shpendët e ujit;
- Fauna tokësore;
- Zona e mbrojtur.

Vlerësimi do të përfshijë çështjen e pasigurisë dhe rrezikun e shoqëruar me parashikimin e ndikimeve të veçanta dhe do të identifikojë të dhëna shtesë ose kërkesa monitoruese të nevojshme për të konfirmuar shkallën dhe rëndësinë e këtyre pasojave.

1.2.7 Masat për zbutjen e ndikimeve

Do të identifikohen masat zbutëse me kosto të ulët për të pakësuar ose shhangur ndikimet e dëmshme, ose për të nxitur ndikimet dobisjellëse. Kjo do të përfshijë modifikimet në planin e projekteve si dhe paraqitjen e masave të përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit brenda rrëthinateve të projekteve. E para do të zhvillohet paralelisht me grupin e planeve inxhinierike dhe do të fokusohet në modifikimet e duhura teknike ose inxhinierike në planet e skemave ose në funksionim. Masat e përgjithshme mbrojtëse do të inkorporohen në Planin e Administrimit të Mjedisit, siç është përshkruar më poshtë.

Do të vlerësohet niveli në të cilin masat e ndryshme zbutëse do të pakësojnë shkallën e ndikimeve që lindin nga skema dhe do të identifikohen ndikimet e pashhangshme të mbetjeve.

Në rastin kur dëmtimi mjedorë është si i pashhangshëm ashtu edhe i pakthyeshëm, do të rekomandohen masat kompensuese ose përmirësimet e mjedisit, të tilla si krijimi i zonave të përkohshme për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë, ose përgatitja e zonave të mbrojtura për të ruajtur habitatet e bimëve dhe kafshëve të egra.

1.2.8 Vlerësimi i ndikimit kumulativ social dhe mjedorë

Duhet të identifikohen projektet që parashikohen në një të ardhme të afërt dhe duhet të vlerësohen ndikimet e tyre sociale dhe mjedisore në ndërthurje me ndikimet e HEC-it Ashta.

1.3 Plani i Administrimit Social dhe Mjedorë

1.3.1.1 Plani i Monitorimit Social dhe Mjedorë

Do të përgatitet një plan monitorimi mjedorë, i cili do të specifikojë kërkesat monitoruese të nevojshme për të verifikuar manjitudën dhe shkallën e ndikimeve të parashikuara, për të zbuluar ndonjë ndikim tjetër të dëmshëm që në një fazë të hershme dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave zbutëse. Do të jepen detaje specifike të përgatitjeve të nevojshme për monitorimin para, gjatë dhe pas ndërtimit, duke përfshirë një grafik që tregon kohën e fillimit, kohëzgjatjen dhe

shpeshtësinë e monitorimit, vendndodhjen e stacionit të vëzhgimit të mostrave, parametrat e monitorimit, kufirin e zbulimit që duhet të arrihet dhe metodën e analizimit, nëse ka, agjensitë përgjegjëse, kapitalin e përllogaritur dhe kostot e veprimitarës, si dhe kërkesat lidhur me raportimin dhe bërjen publike.

1.3.1.2 Plani i Veprimit Social dhe Mjedisor

Do të përgatitet një plan veprimi social dhe mjedisor (PVSM), i cili do të rekomandojë masa zbutëse të realizueshme dhe me kosto te ulët për të elemuinuar ose pakësuar ndikimet shumë të dëmshme mjedisore dhe sociale në nivele të pranueshme dhe masat e zhvillimit të kapaciteteve institucionale që do të merren gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit. PVSM do të detajojë veprimet e nevojshme dhe sigurojë llogaritjet buxhetore të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit në fushat e mëposhtme:

- Masat e shëndetit dhe sigurisë në punë për aksidentet rrugore që lidhen me projektin ose çështje të tjera të shëndetit publik;
 - Kontrolli i ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit;
 - Administrimi i mbetjeve;
 - Kontrolli i erozionit dhe pluhurit;
 - Heqja e dherave;
 - Furnizimi me ujë dhe higjiena;
 - Furnizimi me energji;
 - Çështjet e sigurisë;
 - Çështjet e punësimit dhe mirëqenies;
 - Mbrotja e bimësise dhe kafshëve të egra dhe mbrotja ekologjike;
 - Mbrotja e shesheve arkeologjike ose kulturore;
 - Fusha të tjera kritike të identifikuara gjatë studimit.

Në këtë plan do të përfshihen agjensitë përgjegjëse për masat e ndryshme dhe grafiku për zbatimin e tyre. Plani do të paraqesë një pikë lidhëse me një draft-plan shpërnguljeje dhe kompensimi, i cili do të dalë si dokument i veçantë.

PVSM do të shqyrtojë gjithash tu masat përgatitore për zbatimin e masave zbutëse dhe monitoruese, duke përfshire natyrën, funksionin dhe kapacitetin e agjensive mjedisore në të dyja nivelet atë lokal dhe kombëtar. Do të jepen rekomandime, nëse është e nevojshme, për zgjerimin dhe zhvillimin e kapacitetit të njësive mjedisore, trajnimin e stafit për të mundësuar zbatimin e masave të nevojshme.

1.4 Plani i Shpërnguljes dhe Kompensimit

Shënim i udhëzues 5 mbi Përvetësimin e Tokës dhe Shpërnguljen e Detyrueshme (KFN, 2006) paraqet një specifikim të qartë të kërkesave lidhur me përgatitjen e një Plani Shpërnguljeje. Këto kërkesa duhet të përdoren si bazë për Termat e Referencës për këtë element të studimit. Në këtë kontekst "shpërngulje e detyrueshme" përdoret për të mbuluar humbjen e pavullnetshme të banesës, aseteve prodhuese, aksesin në asetet prodhuese duke përfshirë burimet natyrore, humbjen e ardhurave ose mjetave të jetesës dhe masat për zbutjen e ndikimeve të shpërnguljes. Prandaj përfshin të gjithë elementët si të kompensimit ashtu edhe shpërnguljes.

Studimi themelor i detaujtar social-ekonomik do të përdoret si bazë për vlerësimin kompensimit dhe konsultimet specifike të shoqëruara me to dhe që lidhen me Planin. Përvetësimi i planit do të kërkojë inventarin e veçantë të detaujtar të posedimeve të privatave dhe tokës, përfshirë zonat e mbjella ose për kullotje, kaositetin e tokës dhe vlerën e rëndësishme të famës individuale të cilat do të shpërndulen si pasojë e kërkesave që burojnë nga këtia element kryesor i projekut dhe kërkesat dytësore lidhur me tokën, si për shembull për hyrëse. Në këtë mënyrë, do të përfshihen gjithash tu interesat ekzistuese për peshkim, përmes tij, të përbërja dhe bollëku i specieve të peshqve mund të ndryshojë përmes tij, si dhe zbatimi i tij.

1.4 Raportimi

Raporti VNSM që do të përgatitet duhet të paraqesë detaje të plota të procesit dhe rezultateve të VNSM. Formati dhe përbajtja e studimit do të ndjekë hapat e procesit VNSM të përshkruara më poshtë dhe do të përfshijë:

- i. Një përbledhje tërësore jo-teknike, që thekson konkluzionet kryesore, fushat e konfliktit dhe kundërshtive, çështjet që do të zgjidhen dhe veprimet që do të ndërmerren;
- ii. Një Nen në hyrje që paraqet iniciatorin;
- iii. Qëllimin e projektit dhe përligjien e tij;
- iv. Një rishikim të strategjisë, kuadrit ligjor dhe administrativ;
- v. Një përshkrim të projektit të propozuar dhe vendeve alternative për komponentët e projektit (nëse ka) të tilla si: rrugët hyrëse, guroret, gropat e dheut, kampi i punëtorëve, etj.;
- vi. Një përshkrim të mjediseve ekzistuese natyrore, social-ekonomike dhe kulturore në fushën e influencuar nga projekti;
- vii. Vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore, duke përfshirë metodat dhe teknikat e përdorura si dhe çështjet e rrezikut dhe pasigurisë;
- viii. Një vlerësim të masave zbutëse dhe ndikimeve të mbetjeve;
- ix. Një Plan të Administrimit Social dhe Mjedisor duke përfshirë:
 - Planin e Monitorimit, përfshirë grafikun dhe kostot;
 - Planin e Veprimit Social dhe Mjedisor, duke rekomanduar masat zbutëse dhe kërkesat institucionale që përfshijnë trajnimet.
- x. Referencat;
- xi. Shtojcat, duke përfshirë:
 - Prosesverbale të të gjitha konsultimeve, duke përfshirë komunikimet ndërmjet agjensive ose OJQ;
 - Listën e anëtarëve të grupit të NSM;
 - Tabelat e të dhënave që i referohen tekstit kryesor dhe dokumenteve e papublikuara të referencave;
 - Hartat dhe figurat;
- xii. Planin e Shpërnguljes dhe Kompensimit si një dokument të veçantë.

SHTOJCA J

KUFIJTË KOHORË TREGUES PËR PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Kufijtë e mëposhtëm kohorë të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues janë përshkrues, jo detyrues dhe jepen vetëm për qëllime informimi. Koncessionari do të mbështetet vetëm në përpjekjet e veta të kujdeshshme dhe të nevojshme dhe/ose në asistencën nga këshilltarët ligjorë shqiptarë në mënyrë që të bëjë ndonjë përcaktim sa i përket përcaktimit të saktë të natyrës dhe qëllimit të ndonjë kërkesë shpronësimi dhe kufijve kohorë që lidhen me to.

Kufijtë kohorë për procedurën e shpronësimit:

1. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të Koncessionarit për miratimin e shpronësimit, duhet të përfundohet një marrëveshje ndërmjet Koncessionarit dhe Autoritetit Kontraktues.
2. Autoriteti Kontraktues, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes do të fillojë procedurat e njoftimit për çdo pronar ose bashkëpronar të pronave dhe publikimin e kërkesës për shpronësim në interes publik.
3. Brenda 15 ditëve nga data e publikimit personat e interesuar kanë të drejtë t'i paraqesin pretendimet e tyre Autoritetit Kontraktues.
4. Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i kërkojë Këshillit të Ministrave të marrë vendimin e shpronësimit një muaj para datës së përfundimit të procedurave dhe kufijve kohorë të njoftimit të pronarëve dhe publikimit të kërkesës për shpronësim.

5. Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit ose kufiri kohor i publikimit, pronari ose personat e interesuar duhet të njoftojnë Autoritetin Kontraktues nëse bien dakord për të transferuar pronësinë, sipas kushteve të përcaktuara nga Minsitri.

6. Brenda 15 ditëve, nga dhënia e përgjigjes nga personat e përmendur më sipër (pika 5), por në çdo rast jo më parë së një muaj nga data e fundit e kufirit kohor të publikimit, duhet të përfundohet transferimi i akteve të pronësisë.

7. Regjistrimi i pronave të shpronësuara duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Ministrave.

8. Nëse Koncessionari që kërkon shpronësimin nuk arrin të fillojë punimet brenda 3 muajve nga data e specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, shpronësimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kufijtë kohorë për marrjen e lejeve:

Leja e kërkuar	Kufiri Kohor Minimal për Pajisjen me Leje
Licenca e ERE-s	3 muaj
Leja e Deklaratës Mjedisore	3-6 muaj (por maksimumi mund të jetë 9 muaj nëse ata kërkojnë ekspertizë për të ndihmuar në vlerësimin e studimit të ndikimit)
Leja e Sheshit të Ndërtimit	3 muaj
Leja e Ndërtimit	Për të duhet të aplikohet brenda 6 muajve nga dhënia e Lejes së Sheshit të Ndërtimit (nëse madhësia e sheshit është mbi 0.1 ha), përndryshe kërkesa për këtë të fundit duhet të përsëritet. 45 ditë për miratimin/refuzimin nga paraqitja e kërkesës.
Leja e Koncessionit të Ujit	Kjo jepet mbi bazën e një koncesioni aktual hidrocentrali dhe nuk parashikohet asnjë periudhë kohore por nuk duhet të zgjasë shumë me kusht që të paraqiten të gjitha dokumentet mbështetëse.
Leja për ndërtimin e një dige/sfrati	2 muaj për miratimin e projektit dhe më pas 45 ditë për miratimin e lejes së ndërtimit.

SHTOJCA K
FORMATI I GATSHËM PËR PLANIN E SHLYERJES SË BORXHIT

Shuma e paraqitur në tabelën e mëposhtme përfaqëson shumën maksimale që do ti paguhet METE në çdo moment kohor gjatë Afatit në lidhje me shumat që kërkohet të paguhen ose ripaguhen nga Koncessionari sipas ndonjë lehtësie në kredi në përputhje me Dokumentet Financiare (duke përfshirë sa i përket çdo zgjidhjeje të parakohshme dhe kostot në rastet e shkeljeve, tarifat ose ndryshe shpenzimet që do të kryhen nga Koncessionari nëse këto shuma duhet të ripaguhen në secilën nga datat përkatëse të treguara më poshtë, ku këto kosto, tarifa dhe shpenzimet do të janë të pajtueshme me kushtet e zakonshme të tregut).

Data	Balancë për t'u kryer me një afat 6 mujor	Data	Balancë për t'u kryer me një afat 6 mujor

